Daut Dauti

Sytë e mësyshit

Editor
Azam Dauti

Recensent
Halil Zendeli

Daut Dauti

SYTË E MËSYSHIT

Shkupi
Shkup, 2O14

TRENI PËR STAMBOLL
DHE TË KEQTË E NËNËS

Treni i parë që kam parë në jetë doemos do të ketë lidhje me sëmundjen e mëvonshme të nënës. Nuk jam mjek, se mjek asnjëherë nuk u bëra, edhe pse babai donte shumë të isha bërë një ditë me mantel të bardhë, . Të isha bërë mjek, të paktën do të dija në ka pasur gjë treni me sëmundjen e nënës. Ose, më saktë, me të keqtë e saj, që një ditë dhe ia mori frymën. Ndonjëherë ndalem dhe fajësoj veten sa i padrejtë duhet të kem qenë ndaj nënës së ndjerë. Jo pse s'ia gjeta asnjëheërë anamnezën e lëngatës së saj. Sepse në kohën kur ajo lëngoi, unë isha vetëm një fëmijë dhe për këtë nuk duhet të kem ndonjë faj. Përcaktimi jetësor bëri që asnjëherë të mos bëja një përshkrim mjekësor, por fundja, këtë nuk ia kisha premtuar asaj, por babait, i cili kishe bërë planet për ne fëmijët, më i madhi të bëhej një agronom, i cili do të dinte më mirë se çdo kush tjetër të kujdesej për arat në katund, kurse më i vogli, ishte herët për ta drejtuar për jetë. Por, unë, megjithatë, mendoj se çështja e nënës s'ishte punë mjeku. Sepse fati i saj vetëm rastësisht pati epilog mjekësor, se rrënjët ishin krejtësisht tjera.

Pra, përcaktimi im "për letrat", diç që asokohe vështirë do ta kuptonte im at, ndoshta më mirë se mjekët më të specializuar, mund të përshkruante,

atë lëngatë, atë dhimbje që s'ishte fizike. Përparësia e letrave që s'janë raporte mjekësore ose receta mund të shkonte në historira edhe më të hershme të jetës së saj. Prandaj, mund të them se vonesa e këtij rrëfimi, pas kaq vitesh prej vdekjes së hershme, nuk ishte nga mungesa e kujdesit. Se, sa i përket kujdesit, ne fëmijët e saj, në të gjallë, si të vegjël, nuk kemi mundur të kujdesemi për të sa ajo për ne. Por, mban, gjithsesi, mban ndonjë kritikë, që si krijues nuk i kam dalur borxhit përveç se me një poezi.

Kurse një rrëfim për të, doemos do ta përmbajë atë pamje pikëllimi që s'më shqitet asnjëherë nga kujtesa. Sepse ishta fëmijë gjashtë vjeç, kur gjithçka nga jeta regjistrohet si në shirit filmi. Dhe në atë "shirit" ka shumë pamje, shumë personazhe, shumë vaj dhe përqafime. Një ndarje të madhe të pakthim. Dhe dhembje të pakufi, doemos. Unë nuk do ta kem ndjerë dhembjen sa ajo. Sidomos si të sajën. Dhembjen do ta ketë ndjerë nëna. Unë nuk dija ç'ndodhte, ajo po. Ajo do të ketë ditur se disa gjera nuk kthehen më. Dhe përsëri ndjenja e fajësisë. Një pikë faji për një harresë të heshtur të asaj dite kur u nis treni nga Shkupi për Stamboll. Ndonëse në anën tjetër shtrohet pyetje: çka mund të bësh më tepër seç mund të bëjnë fëmijët tjerë që kohë pas kohe ta kujtojnë. Ndjenja e fajësisë së krijuesit më shtyn të kërkoj më tepër prej vetes për ta ruajtur kujtimin për nënën dhe për ditën kur nuri

i saj do të ketë marrë teposhtëzën. Kur kishte nisur t'i errësohej, që t'i zymtonte jetën.

Kur kthehem pas dhe kujtoj vitet e para pas vdekjes së saj, ishte një përpjekje gatise e tepruar për të dalë nga hija e kujtimit të saj! Ata që kanë mbetur pa një prind, mozomomakeq, pa të dytë, ka jetuar me peshën e rëndë të të qenurit jetim. Të qenurit jetim, në kohën e fëmijërisë sime, ishte një gjendje e rëndë shpirtërore, si një pabarazi me moshatarët tjerë, por që pabarazia shihej ose përjetohej nga çdo shikim i dhembshëm. Por, para se ne të kishim mbetur jetimë, nëna ishte ajo që e kishte ndjerë veten më jetime se kushdo tjetër. Vetmia e saj ishte bërë fatale, pa shpresë se jeta do të mund të bëjë ndonjë mrekulli, si në ato përallat që shpesh na i tregonte.

Ne jetonim në katund. Atë ditët sikur të gjithë ishim dyndur në qytet. Oborri i një daje të nënës në Gazi Babë, ishte tepër i ngushtë për gjithë ata njerëz që ishin mbledhur. Gra e burra. Farefisë e miq. Ishin bërë bashkë ata që do të udhëtonin larg, dhe ata që i përcillnin. Ku të dija unë atëherë përse kaq rëndësi i jepnin kësaj ndarjeje. As dija se përse duhej dikush të ndahet nga familja dhe të ikë larg. Larg, shumë larg, pasi do të udhëtohej me tren. Kujtesa fikson dhe gjera fare të parëndësishme. I tillë ishte një pjepër i verdhë, i pjekur, me erë të këndshme që e shihja në një cep të oborrit të ngushtë nga gjithë ata njerëz. Një erë që të shtonte oreksin ta haje me një gojë. Pastaj në kujtesë vjen

ngjarja kryesore, ajo pamje te treni. Ishte një stacion ku trenin e pritëm nën do strehë që mua më ngjanin si pojata. Kur erdhi treni, erdhi jo me fishkëllimën e vet, por me lemerinë e vajeve të atyre që shkonin dhe atyre që përcillnin. Ato përqafime të gjata, kur njerëzit nuk donin të shkëputeshin nga përqafimi. Ishte rrëmujë e madhe, shumë njerëz hypën në tren dhe shumë të tjerë mbetën në stacion pasi treni u nis. Kur kujtoj atë ditë, më shumë i ngjante një funerali se përcjellje njerëzish në një udhëtim të largët. Në një funeral, gjithçka pran kur trupi i të ndjerit mbulohet nga dheu, kur njerëzit pajtohen me fatin se kanë përcjellë në rrugën e pakthim dhe kthehen nëpër shtëpitë e tyre. Edhe kur treni shkoi nga stacioni, me ato duar që "valëvitinin" në dritare, me të humbur nga shikimi, pllakosi ajo ftohtësi dheu që mbulon një të ndjerë.

Ajo ditë çoi dajët për Turqi duke mos ditur as psenë. Flitej se pothuajse çdo ditë trenat çojnë udhëtarë në rrugën pa kthim. Dukej sikur të ishte normale dikush të lente tokën e pashitur djerrinë dhe të shkonte.

"A do të shkojmë dhe ne një ditë me këtë tren?", e pyeta babain, duke menduar se këto gjëra vetëm burrat mund t'i dinë.

Hasa në shikimin e rrebtë të tij.

"E sheh atë dushkun në qosh të arës? Sheh sa i madh është, sa i ka degët lartë e kushedi ku i

mbërrijnë rrënjët në tokë. E, po e shkule nga rrënjët, edhe ai thahet!", më tha ai.

Isha shumë i vogël që të kuptoja se kjo ishte një metaforë, megjithqë kisha kuptuar që ata që shkonin larg, i kishin shkulur rrënjët, prandaj dhe dajët "do të thaheshin" atje ku kishin vajtur pasi qenkan shkulur prej këtuhi!

Nuk mora përgjigje, por vyshkjen dhe tharjen e vëreja tek nëna. Ajo nisi të venitej, si ndonjë bimë që i zverdhen gjethet kur i mngon ushqimi nga rrënjët, ose i bie ndonjë sëmundje. Një nga ato sëmundje për të cilën kisha dëgjuar ta përmendnin, i thoshin "murtajë". Kur përmendnin prrallat ku përmendej se diku ka rënë murtaja, pasonte vdekja. Kjo murtajë si duket, që do ta kishte kapluar trupin dhe shpirtin e nënës, vërehej çdo ditë.

Kujtimi më mbresëlënës për nënën nis pikërisht pas asaj ditë kur i përcolli vëllezërit për Stamboll. Dromca - dromca më janë ngulitur ca situata si nëpër mjegull. Më së shumti më kujtohet me një fytyrë të bukur por me një ten të zbehtë, që më vonë do të shndërrohet në shenjë të luftës për jetë. Ajo ishte e zellshme, nga gratë e familjes së madhe që s'i dëgjohej zëri. Kur ishte në maxhe, siç ishin gratë me radhë "në maxhe", gatesat i bënte me një zell të madh. Ishte pedante edhe në veshje, që siç thonë gratë, ishte shumë e shkathtë në qepje, ndonëse nuk kishte makinë qepëse. Mëhalla e Zhugrive, prej nga ishte familja e saj, ishte afër mëhallës së Logrive, i ndante vetëm rruga kryesore

që çonte në dalje të katundit drejt lindjes. Babai im kishte pasur mundësi ta shohë shpesh vajzën Shehadije të Donës dhe ta pëlqejë. Kur familja e kishte kërkuar, babai kishte qenë një vejan i ri! Sepse, fill pas luftës, atij ia kishin kthyer gruan e xhaxhait të vet, Dautit, që kishte rënë në luftë si vullnetar në luftën "për Shipni". Ia kishin kthyer xhaxheshën e re me fëmijë të vogël, ndërkaq edhe ky posa kishte hyrë në moshë madhore. Por, fati i keq e deshi që të dytë të kishin qenë jetëshkurtër, edhe nusja e xhaxhait edhe fëmija. Kështu ai u bë një vejan i rrallë, në moshë fare të re, por kjo nuk qe pengesë për familjen e Shadijes s që t'ia japin për nuse vajzën e re. Familja jonë ishte e njohur në katund dhe në mbarë Dërvenin, por zëri për të mirë i kish dalë edhe djalit më të madh të Ramizit të Sulës Dautit.

Por, nëna nuk pati jetë ëndrrash. Jo me fajin e babait, jo me fajin e familjes. Një të keq kishte nisur të brumohet në jetën e saj, ai i keq që i ishte shfaqur ditën kur përcolli vëllezërit për Turqi dhe do ta brejë një kohë përbrenda. Ishe bërë shumë e ndjeshme, më saktë, e lëndueshme, jo vetëm nga kjo situatë, por dhe nga çdo situatë tjetër që do të vijë pastaj. Nuk mund të pajtohej me faktin që kishte qenë një hasmëri e vëllait të vogël me një katundar, të cilin për pak do ta kishte vrarë. Ndoshta kishin rënë nën ndikimin e shpërnguljeve të mëdha asokohe nga Kosova e viset tjera me shqiptarë për Turqi, nga një presion politik e

policor, që kishin mbjellë frikë e pasiguri te shqiptarët dhe te myslimanët. Ishte ajo ndjenjë e shumë myslimanëve se këtu "nuk ka vend për ne nën shka!", apo se i joshte vendi i dovletit të dikurshëm si i premtuar për myslimanët...Sidoqë të jetë, vëllezërit e saj kishin vendosur të shkonin gjurmëve të dy motrave më të mëdha, Nazifes dhe Arifes, të cilat disa vjet më parë ishin shpërngulur me familjet e tyre në Turqi. Kësisoj familja e saj ishte shpërndarë në dy kontinente: dy motra e dy vëllezër në Turqi dhe një vëlla e tri motra këtu. Prandaj dhe atë ditë kur i përcollëm nga stacioni i i trenave nga Shkupi, sikur të kishte rënë mortja.

Një sy i keq i kishte marrë mësysh familjen! Po, po, një sy i keq, qyshse asnjëri nuk gjeti prehje në vend të vet. Kjo puna e shpërnguljes, ose më shumë siç e kujtonte ajo, "e shkuljes", kishte nisë që atë ditë kur pas dimrit të acartë të para 7 vjetësh ishin shpërngulë dy motrat, Nazifja dhe Arifja me burrat dhe fëmijët e tyre të vegjël. Ishte sikur të trazohej një buklë nga vendi i vet me gjithë të vegjëlit. Atëherë ndoshta kishte nisur t'i hynte i keqi në bark por nuk do ta kishte vërejtur. Por, i keqi u bë më i madh kur nga të keqtë që motrat ikën përtej Edrenesë, dha shpirt një motër e saj, poashtu e sapomartuar. Jo, nuk lëngoi nga ndonjë sëmundje e rrallë që nuk ka shërim, siç thoshin, por nga dhembja për motrat. I kishte hyrë asaj në kokë se kjo shkuarje e tyre, do të thoshte largim i përjetshëm, për të mos u parë më kurrë. Të keqtë e

saj në shpirt mund të ketë nisur që ditën kur motrat ikën, por kjo nuk ishte vërejtur aq, kurse ditën kur u shpërngulën edhe dy vëllezërit, nisja të venitja e vërtetë. Ashtu ra ajo, i hypi një zbehtësi, një këputje që e vunë në shtrat të lëngatës dhe nuk ndihmuan as doktorë e as hajmalitë që i shkruanin aty-këtu nëpër gra, duke kujtuar se dikush i ka bërë sehir, ashtu siç dinë të flasin graria, jo se dikush tjetër e paska dashur dhe i ka futë zhivën, o të bëhet gruaja e tij, o e askujt. Por, jo, kur nëna përcolli edhe dy vëllezërit, kuptoi se të keqtë e motrës së tretë, e kishte marrë ajo. E shihja nënën të dëneste shpesh ose ofshante për vëllezërit dhe motrat. "Ah, Sami, ah Qemal, si më latë vetëm". Për motrat Nazife e Arife më pak ndjente dhembje, se ato edhe ashtu ishin larguar prej katundi për në derë të huaj që kur u martuan në katunde tjera. Por ikja e dy vëllezërve sikur ia këputi krahët. Në katund i kishte mbetur vëllau më i madh, Hamiti, por kjo nuk ia shuante mallin për vëllezërit. Aq më tepër që pasi shkuan në Stamboll, disa vite me radhë, nuk dihej asgjë për ta, pasi asnjë letër nuk vinte prej tyre. Kjo edhe më shumë e shtonte pikëllimin e nënës, edhe më shumë i mblidhej i keqtë në lug të zemrës. "Kushedi a kanë gjetë strehtë", mendonte.

Lajmet për vëllezërit i erdhën pas disa vitesh. Në një kuti të vogël kishin futur llokume me arra, një grusht leblebi me rrush të thatë dhe do sheqerka të larme kuq-e bardhë nga Stambolli, ia kishin dërguar vëllezërit me të falat se janë shëndoshë e

mirë, se kanë ndërtuar shtëpi, se fëmijët kanë nisur të rriten, se një ditë kur të vijë koha, do të kthehen në fshat për ta vizituar. I lau me lot këto peshqeshe të dërguara prej vëllezërve, por as kjo nuk bëri që ajo të rehatohej. I keqi në zemrën e saj tashmë e grryente përbrenda, sepse nuk kishin thënë kot se e mira vjen fije fije, ndërsa e keqja, lëmsha-lëmsha.

Një e keqe tjetër që e lëndoi si nënë, ishte vdekja e një fëmije pa i mbushur dy vjet. Ai ishte një fëmijë lazdran, me emrin Bajram, që ishte i treti, dhe nëse mund të thuhet, ia kishte këputur nurin e nënës, sepse ashtu siç kishte nisë t'i bjerë një zbehtësi lëkurës së saj, ashtu dukej dhe vëllau ynë i vogël që në lindje. Nuk e di nga çka lëngoi, një mëngjes në të zgjuar, në dhomën ku flenim të gjithë, para syve tanë dha jetë. Një zbrazëti që ndjemë tek nëna do të kishte qenë shumëfish më e madhe.

Kam dëgjuar shumë gra, që i keqi i tretë i madh i saj, kisha qenë, djali i dytë. E ndjeja dhe vetë sa ishte e pikëlluar tek më shihte me këmbë të lënduar, sikur të ishte fjala për ndonjë sëmundje të pashëruar! Doemos që mosdija do ta ketë bërë të vetën, ndoshta në një moment do t'i jetë dukur se nuk ka zgjidhje. Por, e shihja se vuan shumë. Ajo lëngatë e këmbës dhe për mua ka mbetur enigmë: në moshë parashkollore në lakun e këmbës së majtë më qe paraqitur një plagë me gjak e qelb që zgjati një kohë të gjatë, me muaj. Dhe sot e kësaj dite e kam shenjën e asaj plage te laku, nën gjurin e

këmbës së majtë. Ishte ndonjë sëmundje që shfaqet te fëmijët që nuk e di pse atëherë nuk kërkuan ndihmë mjekësore! Por, edhe më e çuditshme është se dalëngadalë, duke dalë qelbi nga plaga, ajo u mbyll. U shërua vetvetiu. Mirëpo, "kaloi" te këmba e djathtë! Nuk mbaj mend në qe ndonjë lëndim, apo vetvetiu u paraqit sëmundja. Gjuri më ënjtej duke m'u bërë pengesë për ta mbledhur këmbën deri në fund. Përsëri nuk e di pse edhe kësaj radhe nuk kërkuam menjëherë ndihmë në spital. Ndoshta nga shpresa se ajo plagë do të nxirrte vetë qelbin siç bëri këmba e majtë. Nga ana tjetër, pasi lëndimi zgjati me muaj, s'kishte tjetër qare pos spitalit. Por, nëna ime kishte frikë se po të shtrihesha në spital, do të largohesha prej saj! Jo ndoshta aq se do të largohesha prej saj, sa prej frike se duke qenë i vogël, nuk do të kishte kush të kujdeset atje siç mund ta bëjë një nënë. Mu për këtë kishim provuar lloj-lloj ilaçërash popullorë që nuk dhanë kurrfarë fryti. Më kujtohet që ndër ato ilaçe më të çuditshme, ishte një pluhur si kafeja, por kishte një si shije të thartë. E provova edhe atë një kohë, por nuk u shërua këmba. Kësaj radhe sëmundja nuk e kishte ndërmend të tërhiqet si te këmba e majtë. E shihja nënën si vuan, ndërkaq më vonë, ashtu siç dinë të flitet në grari përmes thashethemeve, pata dëgjuar se unë paskam qenë shkaktari kryesor që shkoi ajo aq e re.

Po në të vërtetë, prapa të gjitha këtyre të këqijave, në fund, qëndronte një lëngatë konkrete.

S'di a për shkak të keqeve, apo siç dinë të shfaqen lëngatat, papritmas dhe nga asgjëja, ajo qe sëmurë nga një formë e rëndë e verdhëzës. Ç'nuk bëri babai duke e çuar nëpër doktorë, duke provuar çdo ilaç të mjekëve a ilaçe popullore, por ajo vinte dita ditës duke u shuar. Në dritën e zbehtë të llampave të atëhershme të vajgurit, fytyra e saj dukej edhe më e zbehtë. Dëgjoja tek ofshante, jo për vetën, por për ne fëmijët: "Si do t'ju lë nëna jetimë kështu të vegjël!". Kush mund të ndjente ç'dhembje të madhe ndjente tek e shihte veten se po shuhej ngadalë, e duke parafytyruar fëmijët e saj pa prehërin dhe përqafimin e saj.

Ajo në moshë 33 vjeçare, vdiq kur unë isha në klasë të dytë, vëllau i vogël, ende s'kishte filluar në shkollë, kurse vëllai i madh ishte në klasë të shtatë.

Pas një viti, në fund të klasës së tretë, në vitin 1971, nga mjekët në Shkup mora udhëzim për në spitalin e eshtrave në Ohër. Shërimi i gjurit, ku qe mbledhur ujë, zgjati pothuajse një vit. Kaq e thjeshtë kishte qenë zgjidhja e problemit, sa vite të humbura kot. Ndoshta dhe me fajin e nënës që kishte pasë frikë të më ndante nga vetja kaq të vogël, sikur fëmijët tjerë që kishin ndonjë hall si unë të ishin të ndonjë soji tjetër. Por, ndjenja që të kem qenë njëri nga shkaqet e vuajtjeve të saj, gjithsesi më ka bërë që të ndjehem fajtor, pasi problemi me këmbën do të ishte tejkaluar edhe në të gjallë të saj.

Pas vdekjes së saj, nga të gjitha të këqijat që i qenë mbledhur, nga malli për motrat dhe vëllezërit e shpërngulur në Turqi, nga fëmija që i vdiq pa i mbushur dy vjet, nga lëngata ime e çuditshme e këmbës dhe nga verdhëza fatale, ndodhën gjërat që ndoshta do t'ia kishin shëruar te keqin. Sepse vetëm një vit pasi iku dhe mori të gjitha lëngatat e saj, unë u shtriva në spital dhe shërova këmbën dhe nuk do të ngelja i çalë siç kishte pasur frikë tek shikonte gjurin e fryrë. Katër vjet pas vdekjes së saj, nga Turqia i erdhën vëllezërit për herë të parë, për t'u çmallë me motrën që tashmë ishte në varr.

Vetëm dy motrat më të mëdha, për të cilat kishte pasur të drejtë kur ishte frikuar se me ikjen e tyre nuk do të kthehen, asnjeherë nuk u kthyen në vendlindje, as në të gjallë të motrës së tyre Shehadije, e as pas.

SY DRENUSHE

(Tregimi për një dashuri gjimnazi)

Mezi gjeta vend në një nga rreshtat e mesëm të sallës së Teatrit. Përherë nxitoja në këso ngjarjesh të arrij para të tjerëve, që të zë një ulëse para se të bëhej kallaballëk, sepse ndjej përherë siklet të hyj duke shkelur këmbët ose prekur gjunjtë e të tjerëve që i kanë zënë vendet me kohë. Kësaj radhe isha vonuar ca dhe mezi gjeta një ulëse, gjithnjë duke pasur kujdes që mos hutohem dhe të kaloj pranë ndonjë të njohuri pa e përshëndetur.

Në publik u gjet edhe një femër që ma tërhoqi vëmendjen, e që ishte ulur në rendin para meje. Unë kisha kohë që kisha zënë vend kur ajo u ul nja katër ulëse larg meje, djathtas. Ishte habitës fakti që qysh kur u nis drejt ulëses, duke kaluar nëpër këmbët e atyre që tashmë ishin ulur, ma tërhoqi vëmendjen. Në momentin e parë ishte e pashpjegueshme përse, e pastaj u binda se asgjë nuk qe e rastit. Ajo ishte një fytyrë e njohur, por s'e kisha parë sa një shekull. M'u desh edhe ndonjë çast shtesë, që si në një fokus fotoaparati ta qartësoj kujtesën përse më mbetën sytë në fytyrën e saj, të njohur dhe të harruar.

"Është apo s'është Ajo?"-pyeta veten, por vetëm pas pesë sekondash nuk kisha më dilemë: "Pajtetër të jetë ajo!"

O zot, çfarë shpërputhje në kohë dhe hapësirë!

Në Teatrin Kombëtar mbahej një promovim libri. Një autor, për të cilin kolegët ziliqarë thoshin me qesëndi se don të bëhet shkrimtar në pleqëri, kishte gjetur sponsorë dhe kishte botuar një roman që fliste për disa ngjarje historike për të cilat nuk ishte shkruar aq shumë në të kaluarën. Askush nuk e dinte përse kjo temë kishte mbetur e lënë e palëvruar në letërsinë shqiptare, ndonëse çdo popull tjetër do ta kishte shkruar e stërshkruar atë histori. Autori "i plakur", me gjasë kishte kuptuar ku fshihet lepuri dhe me një reklamim medial të përkrahur nga televizioni lokal i dhëndërrit të vet, ia kishte arritur që të mbledhë njerëz të kulturës nga kryeqyteti, por aty shiheshin dhe njerëz të politikës, të pushtetit dhe të opozitës, që rrallë ndodhte t'i gjeje bashkë. Njëri nga recenzentët, tek fliste para audotorit, romanin e ngriti gjer në qiell me superlativet e sforcuara. Sa kishte të drejtë, asnjëri në sallë nuk e dinte, sepase askush s'do ta kishte lexuar dhe mbetej t'i besonin recensentit, i cili shquhej pikërisht për prezentimet afirmative. Dikush thoshte me dashakeqësi se duke e thirrë shpesh nëpër promovime, as ai nuk kishte kohë për t'i lexuar veprat e autorëve, prandaj prezanimet e tij kishin nisur të ngjajnë si veja vesë. Ndoshta ngase ishte ndër ata, i cili për një kafe dhe uiski në bufenë e teatrit-ku si një snob rrinte me aktorë, shkrimtarë e këngëtarë të operas dhe kishte qejf ta shohin se me kë shoqërohej - ishte në gjendje të të shpallte

shkrimtarin më të rëndësishëm kombëtar të dekadës së fundit, në mos të shekullit, e për një drekë, madje të bënte nobelist! Për librin e shkrimtarit, i cili pasi doli në pension iu rrek romaneve për të rrumbullakësuar përvojën jo të paktë të lexuesit, por për shijen time anemik nga imagjinata krijuese, ashtu siç prisja, asgjë nuk kuptova për vlerën e romanit. Nga fjalët e recenzentit, gjithsesi nuk ishte vështirë të kuptoje se tema ishte për të qenë: fliste për dashurinë e një shqiptari dhe një çifuteje nga Lufta e Dytë Botërore. Ishte ajo tema për të cilën as historianë e as letrarë nuk e kishin rrahur: se si shumë çifutë ishin shpëtuar nga shqiptarët, në kohën kur ishte shpallur edhe këtu në Ballkan gjahu i nazistëve ndaj tyre.

Unë pas fjalëve që dëgjova nga recensenti, gjithsesi do ta lexoja romanin dhe sikur të mos ia vlente pesë pare. Kurreshtja ime do të ishte më e madhe se sa bindja ime e ndërdijshme se nga autori plak nuk mund të dilte një vepër e mirë. Por, gjersa shumica e të pranishmëve në publik dëgjonin me vëmendje folësit që hypnin e zbritnin nga bina, unë kohë pas kohe hidhja shikimin kah Ajo. Më shumë më tërhiqte prania e saj, se sa fjalët kurtoaze që ishin larg vlerësimit të vërtetë. Mu për këtë, mua më ishte bërë objekt vrojtimi Ajo, e cila sikur të kishte zbritur nga qielli, aq e papritur në këtë ambient, aq sfiduese, ndonëse Unë nuk isha Ai, që

rrëfimi të bëhej natyrshëm i plotë në një situatë të vonuar, tepër të vonuar!

Prandaj, prisja me padurim që të përfundojë promovimi i këtij libri dhe të bëja përpjekje ta takoja. Por, kur udhëheqësi i programit mbylli promovimin dhe na ftoi të zbresim poshtë në holin e teatrit për një koktej modest dhe të marrin nga autori librin me nënshkrim, Ajo më kishte ikur nga shikimi. Aq beftas siç e kisha vërejtur, ashtu dhe ishte tretur nga shikimi. Si një çast frymëmarrjeje. Duke u shtyrë me njerëz, nxitoja të dal prej sallës mos e gjeja në turmë. Madje dola dhe jashtë teatrit të shoh mos ndoshta ka dalur në rrugë, por meqë asnjë femër nuk më ngjante me të, u ktheva brenda, i bindur se s'ka ku t'më ikë!

Parandjenja nuk më mashtroi. E pashë në radhë, me romanin në dorë, për të marrë "autograf" nga autori. U ndala mënjanë dhe e vështroja tash nën dritë të plotë. Ajo, po, po, Ajo është. Ajo është, tashmë isha i bindur qind për qind. Por, çuditesha si dhe nga u gjet ajo në qytetin tonë pas kaq vjetësh. Njëzet vjet, tridhjetë, apo sa kishte që s'e kisha parë. Matematika që e bëra shpejt e shpejt ishte e thjeshtë: 27 vjet. Dhe, 10 vjet pas ikjes së Shokut. Unë e kisha patjetër ta takoj dhe t'ia them atë që ajo asnjëherë nuk ka mundur të dijë dhe për këtë Ajo doemos nuk është e vetëdijshme për atë zbrazëti shpirtërore.

-Mirëmbrëma!-e përshëndeta.

-Mirëmbrëma-u përgjigj ajo e befasuar dhe pa ndonjë zell për të folur me një të panjohur. Sytë nën xhamat e syzeve sikur donin t'më pyesnin "Nga njihemi?!". Por këtë pyetje nuk ma bëri, e ruajti në habinë e ndruajtur në vete. Mund të ketë kujtuar, ashtu siç kanë përvojë femrat, që afrimi im të jetë edhe një përpjekje e një mashkulli të panjour për flirt.

I tregova se kush jam. Që të sigurohem se nuk gaboj, porse dhe t'i tregoj asaj se nuk i jam drejtuar personit të gabuar, e kisha patjetër t'ia shtroj pyetjen: "Ju jeni Shqipja? Shqipe Kreshta, apo jo?"

Tash edhe më shumë prej xhamave të syzeve të saja shpërthente befasia. Një kohë mbeti të hamendej në heshtje ç't'më përgjigjej. Pastaj erdhi pyetja që e prisja prej saj.

-Po, Shqipja jam...Por, nuk më kujtohet se ndonjëherë do të jemi takuar, të jemi njohur, të kemi pasur ndonjë shkas për këtë!

Foli ajo me një druajtje e cila në njërën anë dëshiron sa më parë ta ndërpresë bisedën me një të panjohur. Porse te ajo megjithatë kurreshtja tash ishte më e madhe për të ditur përse dikushi i ishte drejtuar. Në mos tjetër, një përpjekje flirti mund të ishte përgjigja më e lehtë, por më banale për të. Edhe ajo do të parandjente se nuk ishte punë flirti kjo paraqitje e një burri të panjohur një femre, ndonëse do të ishte e pritshme edhe kjo, duke pasur parasysh që ajo në këtë ngjarje kulturore kishte ardhur vetëm, e nga ana tjetër, edhe unë për

rastësi isha vetëm, sepse ime shoqe, në muajin e tetë të shtatzanisë nuk parapëlqente të dilte në ngjarje kulturore.

-Me gjasë, doni t'më thoni diçka?-pyeti ajo sikur të dinte qëllimin tim.

-Para se t'ju them çfarëdoqoftë, unë ju kisha lutur që t'më lejoni t'ju thërras në emër. Edhe mua më flisni në njëjës...E dini, për mua jeni ajo gjimnazistja e dikurshme, prej së cilës nuk keni ndryshuar fort...Për hir të magjisë së kujtimit, dua t'ju thërras në emër!

-Mund të më thërrisni pra në emër, nuk vuaj nga këto gjera..., por po më hutoni ngapak kur përmendni kujtimet. Ne, gjithsesi, nuk kemi pasur çaste të përbashkëta që do të shndërroheshin në kujtime!

Nuk e analizova hollë e hollë në pati qortim në fjalët e saj. Nuk kishte rëndësi nëse habia e saj ndryshonte nga çasti në çast, pasi midis rreshtash mund të kishte ndonjë pickim të vogël fjalësh. Pasi mendoi pak, ajo vazhdoi me kureshtjen e saj: "The se më mban mend nga gjimnazi? Për çudi, nuk më kujtohesh...ndoshta ngase në këtë moment kjo gjë më erdhi papritur. Ka shumë fytyra që mbaj mend nga ajo kohë dhe jo vetëm nga gjenerata ime. Mos më keqkupto, por se si fytyra jote nuk më del me ndonjë domethënie nga ajo kohë!".

-Nuk të fajësoj, koha ka bërë të vetën. Po të kishte mundësi të ktheje kohën si një shirit filmi, do të më shihje diku prapa teje, shpesh, shumë shpesh,

shumë afër teje, ti me shoqet tua, unë me shokë të mi...

-Aha,...por duhet të mos kishim qenë një gjeneratë. Ndonëse kanë kaluar kaq vite, mund të kujtoj nxënësit e gjeneratës, e ti sigurisht nuk je ndër ta.

-Kuptohet, unë nuk jam gjenerata jote. Kur ti ishe maturante, unë isha viti i dytë...Por, ajo që dua të dish, dua të të rehatoj se nuk jam Unë i rëndësishëm në këtë që dua të të them...

-Hë, më shton dhe më shumë kureshtjen!...

Ajo dukej gjithë kohën e ndrojtur nga fjalët e një të panjohuri që ia përmendi emrin. Dukej se çdo gjë merrte me dyshim çka i flisja e sidomos shihja që e lodhte mendjen se ku do të dilja. Në fund unë ia zgjidha dilemën me një hamendësim edhe më të madh për të.

-Dëgjo, unë kam shumëçka të të them, por dhe kam diçka për të të dhënë...Nuk di në do ketë ndonjë domethënie për ty, por ama sonte të kisha lutur, të ndash një gjysmë ore, jo sonte, ndoshta nesër, pasnesër..., për një kafe muhabeti.

Ajo mbeti një kohë të mendojë nga propozimi i të panjohurit.

-Unë kam ardhur për ca ditë për vizitë të afërmëve dhe do të ikë...Dëgjova në TV për këtë promovim dhe dola më tepër në mos do të takoj miqtë e dikurshëm...Por pothuajse nuk pashë kënd. Dhe, ja, më shfaqeni ju, një i panjohur që më flet për

gjera të panjohura. Tash dhe kërkoni takim të sërishëm...

U nadal pastaj, lëshoi një frymëmarrje të thellë. "Por, një gjysmë ore, si thua, dhe mund të ndaj nëse je i sigurt se do ta përmbushë këtë hutesë timen dhe kurreshtjen...."

Ia dhashë telefonin që t'më lajmërohet kur të gjejë kohë. Në një moment kujtova se kjo ishte një taktikë fine e saj për t'më hequr qafes. Ku kërkon femra telefonin e një mashkulli të panjohur? Është e kundërta ajo që i sjell takimet. Por unë nuk kisha mundësi tjetër pos t'i nënshtrohesha vullnetit të saj. Në do më thërrasë, mirë, në jo, prapë mirë. Nëse s'do të thërrasë, do të mbetej ajo e zbrazët për një enigmë të pazgjidhur çfarë kisha për t'i thënë dhe për t'i dhënë. Po t'më thërrasë, do të ndjeja një lehtësim për përmbushjen e një amaneti.

Të nesërmen më kaloi dita si më kaloi, kur kah mbrëmja më cingëroi telefoni. "Jam Shqipja, në ora 20 takohemi te "Irish pub" te bregu i lumit".

Pesë minuta para tetë, unë isha atje. Të mos ndodhte që ajo t'më priste mua. Ajo ishte e saktë, erdhi pesë minuta më vonë. U ul përballë meje, me sytë përshkrimin e të cilave e kisha lexuar shumë vite më parë. Sytë e drenushës.

-Sa i saktë do të kishte qenë autori kur ju ka përshkruar ju!- i thashë Shqipe Kreshtës pas shkëmbimit të përshëndetjeve.

-Më fal, nuk të kuptova!-ma ktheu ajo e befasuar.

-Më fal dhe ti, porse unë kërkova të takohem me ty ngase dua të të zbuloj se ti, Shqipe Kreshta, mund të mos kishe ditur gjithë këtyre viteve, se je heroinë letrare!

Kushedi se ç'iu soll në kokë në atë moment. Ndërkohë mbërriti kamarieri dhe ishte një çast i volitshëm për të marrë veten nga habia. Porositëm pijet, e pasi iku kamarieri, vuri buzën në gaz:

-Vërtet! Unë, heroinë letrare? Me se e kam merituar këtë?

-Shih, këtë që po ta them, sigurisht mund të mos ketë vlerën që duhej ta kishte në një kohë tjetër, por unë e kam ndjerë si një barrë të rëndë në shpirt, madje kam dashur me vite që të të kërkoj për ta zbarkuar këtë barrë...Ishte një sihariq i madh kur të njoha në mesin e asaj turme njerëzish.

-Po, pra, për këtë jemi këtu, po dëgjoj. Dua të dëgjoj si u bëra unë heroinë letrare, ka ndonjë rrëfim këtu. Po supozoj që autori...

-Po, autori nuk jam unë...

-Gjithë kohën këtë do ta më thuash, e di, po dëgjoj. Autori pra është dikush tjetër.

-Ne kemi qenë dy gjenerata pas teje, këtë tashmë e di. Në klasën time kam pasur një shok të ngushtë, me të cilin jemi rritur bashkë, kemi ndarë të mirën e të keqen...dhe kemi ndarë, atë që ka rëndësi për këtë takim, edhe fshehtësitë tona.

-Hë...

-Ky shoku im, Durimi, gjithnjë më fliste për dashurinë e tij...E kishte obsesion një vajzë që e dashuronte...

-Dhe Ajo vajzë, don të më thuash, jam Unë?!- pyeti ajo, me bindjen sikur të kishte hyrë në skemën e rrëfimit.

-Po, ti ishe Ajo.

Një heshtje e shkurtër nuk kishe befasi.

-E kam njohur unë këtë shokun tënd?

-Mbase do t'u jenë takuar shikimet atëherë, kur ti s'do t'ia kishe ditur domethënien. Ndoshta në autobus, në oborr të shkollës, ndoshta rrugës...

-Nuk më kujtohet...

-Ke të drejtë. Kanë kaluar shumë vite, si do ta kujtoje adhuruesin tënd të fshehtë?...Ti s'do ta kishe ndjerë asnjëherë praninë e tij, ai ashtu dashuronte. Ai jetonte me ty, natë e ditë. Në mendjen e tij, në letrat e tij që e shoqëronin netëve të gjata pa gjumë, ishe gjithnjë me të.

Gjersa i flisja, gjakftohtësia e mëparashme po kalonte në një trazim shpirti, këtë e ndjeja dhe unë.

-Nuk kuptoj, vërtetë, nuk po kuptoj, një dashuri obesison, e mbrujtur brenda vetes, dashuri e pa shfaqur asnjëherë...Duket pak dhe absurde kjo!

-Jo, ishte dashuri e çiltër. Durimin e kam njohur si merrte frymë...Ishte njeri i veçantë. Kërkonte kuptimin e jetës, kuptimin e dashurisë. Kërkonte Izoltën e Tristanit në vetën e tij. Femrën shembullore çfarë e kishte portretuar në kokë. Të gjithë ne kërkojmë një femër që e kemi portretuar

në kokë dhe femra që ai e kishte idealizuar ishe ti, Shqipe Kreshta. Një femër të cilën ia vlen ta kërkosh, për të cilën ia vlen të jetosh, të vraposh pas saj edhe kur e di që ndoshta s'do ta gjesh. Një femër-ide, një femër-muzë.

-Larg jemi ne femrat nga këto fiks-idera, apo jo? Kushedi si na shikojnë meshkujt që na adhurojnë...!

-Një femër e tillë më gjason në një ideal të pa arritshëm...E ëndërruar. Sa herë më kishte folur për Izoltën dhe Tristanin, ishte magjepsur nga ajo dashuri, saqë shpesh kur fliste, më dukej se fliste për veten dhe dashurinë e tij... Ëndrra e Durimit ishte femra me sy të drenushës, e butë, e ëmbël, e çiltër, e virgjër shpirtërisht, e bukur që ta shikoje gjithë jetën pranë, e të mos ngopeshe asnjëherë.

-Femër me sy të dreshushës...!?

-Po, pikërisht ashtu...për të mos thënë, me sytë e e përmalluar, ndoshta të mednuar dhe të tretur diku përtej reales, si sytë e Mona Lizës! Më fal që marr lirinë e t'i jap të drejtë Durimit. Nuk ka qenë larg portretimit të vërtetë. Ndonëse atëherë të kam parë, asnjëherë s'të kam shikuar me sytë e Durimit, por që sytë u gjasojnë syve të drenushës, këtë mund ta them tash që ju shikoj nga afër.

Ndjeja një lloj sikleti te ajo kur dëgjonte gjithë këto.

-Nuk m'u përgjigje në pyetjen e mëparshme...Adhurim kaq i madh, aq i madh sa më bën dhe mua me faj, si bën të mos e ketë shfaqur?-më pyeti Shqipja.

-S'ke pse të fajësosh veten...E di se shumë herë ka dashur të ta shfaqë dashurinë e tij. E di sa herë ka dashur të bëjë hapin vendimtar, ka ardhur gjer në atë moment dhe është kthyer prapa qëllimit të tij!

-Ka pasur frikë?

-Mund dhe ashtu të thuhet. Por jo aso frike çfarë mund të ndjejë mashkulli që e adhuron femrën, pra frikës se mos ajo do ta refuzojë. Mendoj se ishte një frikë tjetërfare. Një frikë të të mos humbë.

-Mundohem të kuptoj logjikën, por s'ia dal dot të kuptoj...Gjersa s'ma ka shfaqur dashurinë, më ka humbur më lehtë!

-Vështirë është për ta kuptuar logjikën e të dashuruarit të tij, vërtet, ndonjëherë dhe unë që e kam njohur, e kam pasë vështirë. Por, të të pyes tash, çka do të bëje ti po ta ksihte shfaqur dashurinë e tij haptas asokohe?

-Do të kisha menduar...Do të kisha kërkuar atë gjënë që do të na lidhte.

-E sheh, pra...Sigurisht që njëra mundësi ka qenë që pasi të ishit njohur, të vazhdonit në lidhje të vërtetë...Më duket se kjo do të largonte Durimin prej teje!

Shqipja kushedi për të satën herë shprehte habinë. "Një dashuri e çuditshme", do të shpehej më shumë për vete.

-E çuditshme, padyshim...Vërtet jam i bindur që ti duhej të ishte një muzë e pa arrirë e

adhuruesit. Durimi kishte talent për të shkruar, të cilit si çdo artisti, frymëzimin ia jepte muza e tij. Muza, ajo ishe ti, i jepte frymëzim për tregimet dhe poezitë e tij të bukura që i shkruante në një frymë. Ia kisha zili kur m'i jepte t'i lexoj, sepse tek krahasoja me veten, me përpëlitjet letrare të një djaloshari, sado dhe unë i dashuruar aso kohe, më dukej vetja amator kundrejt tij. I lexoja dhe unë vargjet e tij ku shkruante për sydrenushën me shikim të virgjër e të çiltër. Shkruante për sydrenushën që ikte prej tij nëpër pyllin e pafund, pas së cilës vraponte dhe vazhdimisht e linte t'i ikte sahere që do të dukej se do ta arrinte...

-Sikur ta kisha njohur, sikur të ishim takuar...

-Nuk di nëse do të ndryshonte gjë. Në shikim të parë do të dukej se ai ishte i ndrojtur të të paraqitet ty. Do të ishte jo tipike për një lidhje gjimnazistësh që djaloshi t'i shfaqë dashuri një femre më në moshë se ai. Një çilimi, kundrejt një femre të pjekur, apo jo? Nuk ishte ai aq i ndrojtur sa të kishte frikë nga një femër...Ai nuk kishte fare aso frike, gjë që e dëshmojnë aventurat me femra të tjera, të cilat asnjëherë nuk i kishte përzemër. Ti ishte ndryshe. Ishe gjithnjë në mendjen e tij, as rinoheshe, as plakeshe, ndonëse kalonin vitet.

E shikoja Shqipen kohë pas kohe tek dëgjonte rrëfimin për Durimin. Analizoja fytyrën krejtësish natyrale, pa pikë ngjyrërash artificiale, siç thoshte ndonjëherë Durimi për makiazhin e femrave. E urrente makijazhin, sepse sipas tij nuk e bënin

fytyrën më të bukur, por e zhynin shpirtit e femrës. Ishte rastësi që dy netë që shihja Shqipen të mos shihja makijazh, të paktën sa për një freskim të fytyrës! Në këto çaste riktheva mbrëmjen e parë të martesës me Dritën, kur ndonëse kishim fjetur dhe më herët, i kisha thënë se nuk dua t'i dhuroj puthje në të kuqtë e buzëve të saj, atë të kuq që nuset e sjellin me "bollëk" për t'u dalluar nga të gjitha gratë që në dasma bëjnë rivistë mode, kush për t'u dalluar me fustanin, kush me flokët e rregulluara te floktaret më të njohura apo me grimin. Unë kaherë në dasma qëndroja larg grave se më dëbonin bojërat e panatyrshmërisë, çfarë unë ndjeja një neveri jotipike për një burrë. Të mos tregoj se që të mos i lëndoj, kisha pasur raste që për një të puthur do t'i kisha mbyllur sytë dhe isha larguar me mendje nga femra që kisha në krahë, për të mos ndjerë shijen e të kuqit të buzëve. Kisha një luftë në vete, ishte një flijesë e imja për të mos lënduar femrën që ishte zbukuruar për takim...Dhe tash kur Shqipja Kreshta qëndronte përballë, sikur hyja në kokën e Durimit dhe e shikoja gatise me sytë e tij: femrën – heroinë të faqeve të librave me poezi e tregime ku frymonte në një botë tjetër ku nuk kishte maska e karaktere të fshehura.

- Unë tash mund ta kuptoj Durimin përse të qëndroi aq afër por kurrë nuk e bëri hapin e fundit në përpjekjen për të të pushtuar, siç do të kishte bërë çdo mashkull i kësaj bote!

-Shkaku?-pyeti ajo kurreshtare.

-Më duket se ai jetoi me frikën se nuk do të ishe e tillë për t'u flijuar, në një anë. E në anën tjetër, jetoi me frikën se ai nuk do të ishte i denjë për një femër çfarë ai të konsideronte. Një kundërthënie në vetëvete do të ketë bërë që të mbeteshe një muzë që së largu e frymëzon për jetë dhe krijimet e tij letrare.

-Ta kisha njohur Durimin...sigurisht dhe unë do ndjeja mburrjen e pazakontë të femrës së adhuruar...

-Mbase...Nuk dyshoj se do të ishe ndjerë si heroinat letrare të veprave të përbotshme, ku jeta e tyre ose e heroit – adhurues, nuk ka fund të gëzuar!...Në këtë rrëfim që lidh Autorin që e ndjek Heroinën, ishte Durimi ai që nuk i bëri ballë sfidës së jetës.Sikur të ishte shkruar nga një dorë e tretë që edhe po të kishte pasur një mundësi më e vogël për t'u takuar, kjo të mos ndodhte. Të mbetej kështu motivi i pengut të dashurisë së himinizuar...Një ditë Durimi u largua papritur...

-U largua? Ku vajti?

-Po, u nda nga jeta. Ra në shtrat nga një prej atyre lëngatave që njerëzit e kanë betejën e humbur...Në një nga ato vizitat e mia pranë shtratit, m'i dha këto fashiklla me veprat e tij. Më bëri borxhli, më tha të të gjej nën tokë e mbi tokë që t't'i japë ty. Më tha: gjithë jetën jetova me Shqipen, nuk është e drejtë, duhet dhe ajo të ndjejë frymën time, të jetojë dhe ajo me mua...Unë arrita t'i botoj disa nga këto vepra, tash që m'u dha rasti t'i jap ty, do të

ndjej një lehtësim me amanetin e përmbushur të shokut. Mbase vetë do të dish çka të bësh me to më tutje.

Shqipe Kreshta nuk ishte prej guri. Mund të ndjeja trazimin e saj për faktin që paska pasur një adhurues që asnjëherë nuk i ishte shfaqur. Ndjeja trazimin e një femre jetën e së cilës nuk e dija. Vetëm mund të supozoja që në këto çaste ajo krahasonte dy jetët e saj: jetën që do ta kishte bërë me Durimin, po t'i ishte shfaqur dhe jetën që kishte bërë pas largimit nga qyteti, pa ditur që kishte qenë dikush që e kishte adhuruar si askush tjetër

Në këtë natë të zbulimit të një fakti të pa njohur për Shqipen, për mua ishte zbulimi tjetër se ajo kishte kaluar jetën duke pritur dhe ende priste atë që shumë femra ëndërrojnë -Princin në kalë të bardhë-për t'i rrëmbyer dhe çuar në pavdekësi!

"Sikur të na kishin marrë mësysh sytë e lig!"-tha ajo në ndarje.

DIKUSH TJETËR NË MES

(Rrëfim për një dashuri të sinqertë rinore)

Saherë që Dili mundohej të zgjidhë një detyrë matematikore, mbetej gjithnjë i habitur si mund një trup gjeometrik t'i shkaktojë aq kokëdhembje. Jo që nuk i kuptonte, përkundrazi, ai matematikën dikur e kishte pasur, pa teprime, lëndë të preferuar, por habitej megjithatë, se si vetëm nga ato tri vija që bashkoheshin në mes veti, mund të nxirreshin gjithë ato formula që po nuk ushtroje rregullisht, ta bënin lëmsh lëndën. Ai vetë e kapi lëndën me seriozitet që nga fillimi, jo si shumë shokë të tij që e humbën hapin duke mos e marrë me përkushtim, dhe u qe bërë gogol! Çuditej kur dëgjonte nga nxënësit tjerë se biologjia, filozofia, gjeografia, a historia janë lëndë më të lehta. Vinte gishtin në kokë se përse të tjerët frikoheshin aq shumë nga numrat, formulat, ekuacionet me një ose me më shumë të panjohura, që s'kërkonim më shumë se pak logjikë të shëndoshë. Këtu nuk duhet të mbash mend sa të larta janë malet e Kilimanxharos, sa peshq ka Peruja, apo sa është sipërfaqa e Rusisë, e sa i gjatë është Muri Kinez, s'duhet mbajtur mend as ç'ka thënë Aristoteli apo Herakliti, sepse matematikën duhet kuptuar, ndërkaq lëndët tjera duhet mësuar. Për të e para ishte më e lehtë se e dyta. Mjerisht, shumica e shokëve të tij e kishin

kuptuar gabimisht lidhjen e matematikës me jetën. Mendonin se pasi ta kryejnë shkollën, mjaftonin të dinë shumëzimin dhe mbledhje-zbritjen, kjo për ta ishte matematika e jetës!

Por, përderisa mëshironte të gjithë ata që iknin prej matematikës si djalli prej temjanit, ai kujtoi antagonizmat e jetës me analogjinë e numrave. Në jetë, e sidomos në dashuri, ah, në dashuri, një e një nuk bëjnë dy! Kujtoi Bulen për ta vënë në qendër si një ekuacion me shumë të panjohura!

Gjersa ishte i tretur në mendime, sytë e tij u ndeshën me ata të Bules, duke i krijuar gjithë atë pështjellim numrash në kokë! Saherë që shikonte në ndonjë pikë, duke dashur të ikë diku larg me mend, atij i shfaqej si në ekran kinemaje fytyra e gjallëruar e saj. Gjithnjë ajo i shfaqej e tillë, e buzëqeshur, e hareshme, sikur nga buzët e saj ishte burimi i gjithë buzëqeshjeve të botës dhe shendit si dhunti moshe. Ajo nuk ishte e tillë vetëm në përfytyrimin e tij, por kështu e mbante mend që nga fillorja, ndonëse kjo fytyrë engjëllore, kishte krijuar dhe shumë sherre ndër djelmërinë, për çka dhe kishin plasur sherre midis moshatarëve. Kujtoi bile një zënkë të dy djemve për Bulen atëherë dhe qeshi me veten. Qeshi sepse njëri prej tyre që kishte hyrë t'i ndajë bandillët gjaknxehtë, kishte qenë pikërisht ai! Sigurisht që do të kishte qenë më e logjikshme që ai t'ua thente hundët të dyve, e jo t'i ndante. Ndonëse atëherë i kishte vluar diçka në bark, sikur acidi në reaksion kimik me metal, por si një djalosh me

edukatë, kishte zgjedhur rrugën e pajtimit. Nuk kërcente si gjel në çdo shamatë, por as nuk do ta parapëlqente të dilte me hundët përshesh para syve të të tjerëve.

"Sa të marrë kishin qenë", mendoi Dili duke kujtuar sherrin e shokëve, në çastin kur i buzëqeshi Bules, e cila atë moment hyri në klasë duke ngrënë gjevrek që e kishte blerë te byrektorja "Vanila".

Pastaj sikur iu mor goja nga prania e saj. I përpiu ata sy të saj dhe ato mollëza si lule qershie. Buzët e Bules, seç i shkuan sytë aty, aq të lëngshme si qershi, që i jepnin pamjen e gojëzave lulore, prandaj i përgjasuan në lulet e pranverës që sapo kishin nisur të çelin e të kundërmojnë në qytet. Jo fort shtatlartë, por me tipare të dalluara vajze që i ka të mbushura të tetëmbëdhjetat, me gjoksin e gufuar, me një fytyrë ku shquheshin sytë e një sute të butë, një lëkurë e hajthme pa shenja të veçanta, përveç se kur ndonjëherë turpërohej, i shfaqej një si njollë e kuqe.

Kaherë kishte kërkuar në këtë turpërim të saj shenja se ajo ndjente diçka për të. Diçka që mendonte të zhvillohej në dashuri që gjithçka midis tyre të merrte kuptim.

....

Por, jeta e Dilit të dashuruar ishte larg rehatisë. Ai nuk gjente prehje shpirtërore nga gjerat që nuk mund të shpërfilleshin. Simpatia e tij ndaj Bules ishte njëri kah i marrëdhënies që kishte me të. Do të ishte shumë më i plotë sikur një kah tjetër të

afrohej, dhe të mos kalonin paralelisht në caqe të ndryshme, po të bashkoheshin. Kjo do të ishte mrekullia që mungonte në këtë mes. Po thellë në vete, me vite kishte një brengë që s'ia thoshte kujt. S'ia thoshte as Bules, e as atij që duhej thënë, shokut të ngushtë Fatbiut, sepse as ai i thoshte gjë për të sqaruar. Nuk fliste as Bulja për të treguar "pozicionin" e vet në këtë rrëfim, se ndoshta as ajo s'e kishte gjetur veten. Megjithatë, një treshe e padefinuar, me të fshehtat që secili i mbante për vete, përbënin një rrëfim matematikor si ato ekuacionet me më shumë të panjohura.

Po, Dili, Bulja dhe Fatbiu, ishin shumë vjet bashkë, si ato harmonitë e trupave qiellorë ku largësia e pandryshuar midis bën që ato të funksionojnë, madje dhe nga ligjet e natyrës që mbetja në distancë mban gjallë ekzistencën e tyre.

Dili ishte ai që erdhi nga fshati në qytet mu në klasën e Fatbiut. Një i ardhur në mjedis të ri, mund të bënte shok të ngushtë vetëm dikë si vetëvetja. Jo vetëm pse qëlloi t'i kenë shtëpitë afër në një mëhallë, por edhe pse u bënë rivalë në mësime, në një garë të heshtur midis dy nxënësish të mirë. Më të mirët në klasë.

Me Fatbiun kishin shumë ngjashmëri karakteresh, por dhe dallime që i bënin megjithatë të ndryshëm nga njëri tjetri. Që Fatbiu nuk e kishte butësinë e Dilit, kjo ishte gjë që ishte vërejtur që në fillim të njohjes së tyre. Shpesh dinte të reagojë me gjak të nxehtë, ndërkaq Dili situatat i kalonte

ndryshe. Dallonin dhe për nga komunikimi. Qëkur Dili erdhi në qytet, gjuha letrare ishte bërë obsesion, me dallim nga Fatbiu, prej të cilit priste kujdes më të madh për gjuhën, i cili jo vetëm që ishte më fjalaman, por dhe tërësisht i ndikuar nga zhargoni i mëhallës. Ndonjëherë dukej se edhe qëndrimin ndaj dashurisë e kishte si një djalosh mëhalle, pavarësisht se po ta pyeste dikush ç'don të thotë kjo, nuk do të dinte ta definonte! Ajo që Dilit i kishte bërë përshtypje kur erdhi në Shkup, kur me mish e shpirt donte të shkëputej nga e folmja e katundit, kur bëhej rob i letrarishtes, ndonjëherë duke dalë dhe qesharak, në qytet gjeti një gjuhë të shthurur, as katundare, as letrare, një përzierje e çuditshme ku nuk e shihje ndikimin e asnjërës të folme! Kështu fliste edhe Fatbiu. E kishte pagëzuar gjuhë të deformuar letrare! Kurse në aspektin përmbajtësor, gjuha e Fatbiut dallohej nga ajo e Dilit, sepse shquhej me "fluturime" të shpeshta hiperbolash për t'u bërë më interesant në shoqëri.

Mu për këtë në shoqëri shpesh ishte në qendër të vëmendjes. Për moshën e tij kishte dhe trupin me proporcione të harmonizuara, s'kishte çka t'i merrje ose të ndryshoje. Si ato statujat antike. Një Apolon, thuajse. Kishte fytyrë ku shquheshin sytë si të ishin më thellë në "gropëzat" e veta, flokët korb që shpesh e krahasonim me një këngëtar të popullarizuar sarajevas, nofulla dhe eshtrat e fytyrës mbuloheshin mirë me muskujt e faqeve pa i lënë vija. Fjalaman në njërën anë, dhe i pashëm në

anën tjetër, ishte përherë cak i shikimeve të vajzave të klasës. Sigurisht që nëse dikush nga meshkujt e shkollës do të ishte më i adhuruari ndër vashat që nisnin drithërimet e para të dashurisë, ai ishte pa konkurrencë kandidat numër një për bandill. Dili ishte ca më ndryshe, atij i mungonte "diçka", aq pak, e aq shumë pasi nuk e kishte. Kishte të tillë që atë kohë shprehnin haptas simpatinë për dikë, dhe më shumë të tjerë që fshehtësinë e shpirtit do ta ruanin për vete. Por, në cilin grup binte Fatbiu? Ajo që shfaqej së jashtmi, ndoshta nuk korrespondonte me atë që flinte brenda në shpirtin e tij. Sepse, ndjenjat e tij përbënin një enigmë kur aq shumë u ka rezistuar shikimeve lozonjare të vashave. Ç'do më tepër, kur as Bukit, bukuroshes së gjeneratës, s'ia varte veshin, edhe pse ajo haptas shfaqte simpatitë për të.

Dili kishte dëgjuar prej tij se i pëlqejnë "të gjitha vajzat e bukura". Por, po ta kishte pyetur Dilin, përgjigja e tij do të kishte qenë në njëjës: "vajzën që do të ma rrëmbente zemrën". Këtë dallim "konceptual" dy shokët nga fillorja e kishin marrë me vete edhe në gjimnaz. Një herë Fatbiu i kishte thënë Dilit: "Asnjëra nga vajzat e klasës nuk janë çfarë më pëlqejnë mua! Madje as Bulja që më dukej aq e bukur në fillore!".

Në të vërtetë, Bulja në jetën e tyre kishte hyrë në vitin e fundit të tetëvjeçares, kur e sollën nga një klasë tjetër. Ajo nuk iu bë vetëm rivale në mësime me zellin dhe talentin e saj, por beftas shkaktoi një

rrëmujë edhe në shoqërinë e tyre, duke i bërë rivalë në dashurinë për të. Te Fatbiu ndoshta përkohësisht, e te Dili përjetësisht. Të paktën kështu dukej atëherë kur ajo hyri në jetën e tyre. Në rrugëtimin e tyre drejt zemrës së Bules, detajet kishin shumë rëndësi. Të dytë ishin treguar të frenueshëm ndaj saj, por sprovat gjithsesi do të vinin. Në pritjen e vitit të ri që e kishin organizuar në shkollë, kur muzika dhe ahengu nuk kishin të ndalur, Fatbiu luajti për herë të parë me vajzën që kishe hyrë në mes shokësh. Që Fatbiu vallëzoi i pari me Bulen dhe nuk ishte ndonjë sprovë e rëndë për Dilin, por fakti që ishte Bulja ajo që e ftoi për tango atë, ishte beteja e parë e humbur e tij që s'i shqitej nga mendja. Një inat ndaj tyre dhe një turp, e kishte bërë që të skuqej si spec, gjë që nuk do të kishte mbetur pa u vërejtur.

Nga druri i dhjetorit qe shkëputur gjethi i zverdhur. Jo, ky qe gjethi që ra në tokë prej zemrës së tij, u mundua kështu të sajojë një metaforë që e para i ra ndërmend. Jo nga xhelozia, por nga një ndjenjë e thellë e mërzisë. Dukej tashmë qartë, ajo kishte rënë në dashuri me të, ndërsa ndjenjat e fshehta të Dilit nuk do t'i ketë hetuar. Por gjerat ndryshonin si në film. Në gjimnaz Fatbiu sikur u tërhoq nga fushëbeteja(ndoshta ai as që kishte ndonjë ndjenjë, por këtë nuk e ndante me shokun e ngushtë), ndërsa Bulja, që shorti deshi të jetë në një klasë tjetër, u duk se u largua ca prej të dyve. Me Bulen nuk takoheshin si më parë çdo ditë në klasë.

....

Heroi i parë i këtij tregimi, medoemos, nëse i radhisim sipas ndjenjave të forta ndaj heroinës së tregimit, është Dili. Ndoshta ai mbante mend më shumë detaje nga gjithë historia. Ndoshta te ai ka pasë më shumë vuajtje se sa të gjitha vuajtjet e personazheve të tjerë për heroinën, por megjithatë, si autor i këtij tregimi, nuk kam të drejtë t'i peshoj ndjenjat e tyre. Le të gjykojnë lexuesit kush më shumë e meritoi dashurinë e heroinës. Është çështje relative mbase, përse dikush meriton epitetin e heroinës së një tregimi, ndërkaq aq shumë vuajtje pa të drejtë u shkakton heronjve...Prandaj dhe ky rrëfim dashurie mund të duket i mërzitshëm për shumëkë, por jo dhe për Dilin, për shkak të ndjenjave të tij që asnjëherë nuk u zbehën për Bulen. Ç'do më shumë se faktin që pikërisht për të kishte nisur dhe të thurë vargje. Se shumë shpejt harroi numrat e formulat matematikore dhe kaloi në poezi. U bë poet, jo aq sa për vrojtimet e tij ndaj botës, sa për shkak të Bules. Një herë profesori i gjuhës sikur ia kishte definuar këtë: është një moshë kur shumëkush bëhet poet! E poet pa vuajtje dashurie, nuk ka, ndaj dhe Dili e kuptonte si dhunti që kishte aq shumë vuajtje në përsiatjet e tij letrare. Ndërkaq heroina e vargjeve të veta, nuk ishte si çdo vajzë tjetër e mëhallës ose qytetit. Kishte diçka më tepër, diçka tjetërfare që as mundohej ta zbulonte.

Meqenëse kujtonte shumë imtësira, Dili nuk e kishte problem të kujtonte edhe çastin kur hyri Ajo

në jetën e tij. Një ditë në shkollë pat ardhur redaktori i revistës për fëmijë "Gëzimi", Fazli Bujku, për të ndarë shpërblimet nga konkursi letrar. Pati fat që atë vit të botonte një vjershë në revistën për fëmijë. Një vjershë kushtuar një vietnamezi të vogël, i etur për liri...Ajo vjershë i pëlqeu mjaft arsimtarit të gjuhës, Adnan Agalliut dhe ja, rasti që të tregohej para publikut, para shkollës. Në ndarjen e shpërblimeve të "Gëzimit" doli para nxënësve të shkollës. Shokët i jepnin zemër. Në binë hipi edhe një vashë me do flokë të gjata gjer mbi supe, me një fustanellë të bukur me lule, dhe një xhemper që nuk ia mbante mend ngjyrën...dhe ajo recitoi një vjershë, por Dilit më shumë i kishte bërë përshtypje ajo vetë, se sa vjersha e saj. Në të vërtetë, duke vështruar fytyrën e saj, ai s'kishte dëgjuar asnjë varg të vjershës që recitoi. Fytyra e kësaj vashe, iu ngulit në kokë, ndonëse nuk arriti t'ia dëgjojë si e pati emrin. Pastaj u interesua dhe për emrin, në ç'klasë mësonte dhe çfarë nxënëseje ishte. Ishte Bule I. Në ato tri vitet e para të shkollës në qytet(pas ardhjes nga fshati, ku i kishte bërë klasët e ulëta), nuk do të kishte besuar, se ajo vashë që i kishte bërë përshtypje nga recitimi, se një ditë ajo do të vijë mu në klasën e tyre. Sikur fati të kishte dëgjuar zërin e tij të brendshëm.

Deri atëherë Dili kishte pasur një jetë "emocionale" të vrullshme. I lindnin dashuri njëra pas tjetrës. Pati ndodhur që vlonte përbrenda nga ndjenjat e forta të dashurisë, porse gjithçka mbante

në vete, si diçka të çmuar, duke menduar se se është turp t'i tregoje dikujt se je i dashuruar. Atë kohë e adhuronte shumë muzikën popullore. Ishte një këngë që edhe sot e dëgjonte me ëndje, që kishte diçka melankolike në të, rënqethëse, "Po t'përbej, pashë perëndinë". Qëkur e kishte dëgjuar përmes valëve të radios, vargjet e saj e patën bërë për vete dhe mezi priste ta dëgjojë sërish, sepse nuk e kishte pllakën e gramafonit me këtë këngë(për çudi, as emrin e këngëtares nuk e kishte dëgjuar)...E, atë këngë, në orët e muzikës, e këndonte një shoqe, Gjyle I. dhe për çudi, ajo sikur t'ia kishte vjedhur zërin këngëtares së vërtetë. Ra kjo këngë plot melankoli, që ai të fillojë ta dashurojë këtë shoqe të klasës, e cila me aq mall e këndonte! Dy vite me radhë vuajti për të..., ndërsa viti i tretë pas ardhjes në qytet, solli me vete një dashuri të re. Kësaj hare me një nxënëse të një klase më të lartë. Quhej Afshe A. E deshi rasti që të jenë bashkë në ekipin e shkollës në një garë diturie midis shkollave të qytetit. Që nga njohja e parë me të, sikur kishte gjetur "të vërtetën". Sa i marrë do të kishte qenë atëherë! Pikërisht për këtë shpesh mendonte: "A thua një ditë, në një moshë tjetër, do të dukej qesharake kur t'i kujtonte dashuriçkat e rinisë?". Me ndrojtjet e moshës shtalb, a nuk ishte e tepërt një fillorist të luante lojëra dashurie? Por ai, qe i dashuruar marrëzisht pas Afsha A.-së. E përcillte me shikim kudo që e shihte. I dukej se vajzë më të virtytshme se ajo nuk kishte. Edhe ajo ngjante me

të, ndrojtur, e turpshme si ai. Eh si skuqej nga turpi kur e shihte se e vështronte atë me sy tjerë, ose kur përshëndeteshin kalimthi. Ajo iku nga shkolla kur mbaroi të tetën. Sikur humbi gjithçka me të.

Gjersa Afsha ikte me gjeneratën e semimaturantëve, për të shembej bota që nuk do ta ketë më fytyrën e saj për ta kërkuar e për t'u prehur. Pas pushimeve të verës, erdhi klasa e tetë, kur nga shpërndarja e një klase tjetër, për shkak të mungesës së hapësirave në shkollë, disa nxënës i sollën në klasën e tyre. Në mesin e tyre dhe Bule I.-në. Që në takimin e parë e bëri për vete. Tek të gjitha vajzat që ishte dashuruar, bukuria nuk kishte qenë gjëja kryesore që e kishin tërhequr, por virtytet e tyre. E tillë ishte edhe Bulja. Ardhja e saj krijoi një treshe nxënësish më të mirë: Dili, Fatbiu, Bulja. Por, sikur gara në mësime nxiti dhe garën e dy shokëve për zemrën e saj! Ishin këto çaste të reja në jetën e Dilit, por a e lë krimbi pa e sëmbuar mollën e kuqe, ashtu edhe kësaj radhe, me të njëjtat pretendime, heshtazi dhe fshehurazi qe futur në lojë edhe Fatbiu. Mundoheshin të kapnin çdo fjalë, çdo lëvizje, çdo gjest të saj, ndërkaq ajo, meqë bankat qëlluan afër, shpesh kthente kokën pas ku gjendeshin ata dy. Sa herë kthente kokën prapa, secili maste shikimin, cilin do ta kishte pikasur më tepër! Për të qenë më e komplikuar, simpatinë e saj sikur dalëngadalë e fitoi Fatbiu, ose të paktën kështu i dukej Dilit. Fati e deshi të jetë ashtu, që dy shokë të ngushtë, të ndajmë bashkë gjithçka, si

notat e mira dhe suksesin në mësime, dhe tash të dashuroheshin në të njëjtën vajzë. Ah, jo, jo, kjo duhej të ishte vetëm përshtypje, sepse për këtë temë nuk flisnin asnjëherë njëri me tjetrin. Si të rrëfeheshim kur në praninë e saj nuk e dinim ku e kanë kokën!

A thua ajo me të vërtetë pat rënë në dashuri me Fatbiun, të cilit atëherë i vardisej shpesh një tjetër vajzë, Bukuria. Fatbiu ishte më simpatiku, dhe s'ishte çudi që i silleshin vajzat. Kur Dili lexonte ndonjë hartim të bukur, e shikonin me admirim shumë vajza, por ai do të donte që Bulja të ishte ajo që do të magjepsej prej tij. I dukej sikur ajo qëndronte indiferente, duke u ndjerë krejtësisht i parëndësishëm.

Dhe pasuan pastaj ato ngjarje të cilat përcjellin vitin e fundit të shkollimit. Ai kaloi saora. Ndodhi edhe ajo ballo e paharruar gjatë festës së vitit të ri. Atë ditë e kishin stolisur klasën enkas për vitin e ri, dhe disa orë muzika nuk kishte pushuar nga manjetofoni. Patën luajtur të gjithë, edhe Dili, por disi veças prej tjerëve. Dhe kur kishte vallëzim tango në çift, luanin vetëm më të guximshmit. Gjylerja, Gjylfidanja, dy shoqe të afërta, e ftonin për të luajtur, por ai nuk lëvizte vendit! Qëndronte anash dhe i thelluar në mendime, herë shikonte në dritare motin që kishte nisë të vrahet, e herë vallëzuesit, e herë urrente vetveten për mungesë guximi. Kur, ja, nga banka ku qe ulur(bankat ishin renditur rreth-e qark klasës, për të bërë vend ne

mes për valltarët), u shfaq Fatbiu. Nuk i bënë sytë: Bulja e kishte ftuar për vallëzim! I shikoi i befasuar por me shumë admirim, gjersa një valë e nxehtë djersësh i përshkoi trupin. "Çift ideal!", ishte mendimi që iu vërtit në kokë. Sepse vërtetë ata qenë çifti më ideal i asaj dite festive.

Në shtator të atij viti, kur kaluan në shkollë të mesme, vërtetë nuk e mblodhi më klasën e fillores sërish bashkë dhe prishi "treshen". Ngjante që të bëheshin përsëri bashkë vetëm kur takoheshin korridorit me Bulen ose kur kthehesin në shtëpi me autobus. Dili që analizonte çdo përshëndetje, çdo gjest të saj, vërente një lloj ftohje**.**

Por, edhe ajo vetë, e fshihte dashurinë si gjarpëri këmbët. A e dashuronte më Fatbiun, apo dikë tjetër, i duket krejt njësoj. Ai vazhdonte të strehohet te përsiatjet e tij poetike për të shëruar plagët e dashurisë së pakthyer. Por kur gjërat zgjaten pa një zgjidhje, e papritura erdhi kur në rrethana të reja, Bulen sërish e hodhën në klasën e Dilit dhe Fatbiut. Por, kësaj rradhe treshja u bë katërshe! Se në jetën e saj kishte hyrë një shok i tretë, Suri. Shikimet e tyre të përflakura dhe fjalët shpotitëse që ia lëshonin njëri tjetrit, ishin ai flirt i lehtë e i tërthortë gjersa nuk ia thoshin troç njëri tjetrit. Suri ishte ndër shokët më korrektë të klasës. Për të ajo kishte shfaqur interesim kohë pas kohe edhe kur ishte në klasë tjetër, ndërkaq tash në një klasë, edhe më shumë u afruan. Por, e deshi puna që këta dy, për mungesë të një fjale të

drejtpërdrejtë, dashurinë e tyre e lanë të vjerë me vite. Kur vazhduam studimet, pak nga pak ishin larguar nga njëri tjetri, por Dili, që kishte mbajtur gjithë kohën llogari sa për ndjenjat e veta edhe për të mos lënduar kënd, deshi të bëjë një punë sizifi, t'i bashkojë dy dashnorët e pashpallur, gjersa ndërkohë në maturë kishte ndjerë drithërima për një vajzushë nga një klasë tjetër, e cila vetë i kishte shpallur dashurinë. Aq papritmas erdhi ajo, saqë u harruan gjithë të kaluarat. Por, dashuria ndaj saj do të ishte një pistë tjetër rrëfimi, prandaj ta përfundojmë me heronjtë e mëparshëm. Ndonëse asnjëherë nuk kishte pushuar së dashuruari, Dili ishte pajtuar me fatin, por altruizmi nuk e lente pa bërë përpjekje për dy të dashuruarit tjerë, Bulen dhe Surin, të cilëve u ishte lidhur një nyje në fyt dhe kurrë s'ia thanë njëri tjetrit fjalën magjike. Ndonëse i dashuruari kryesor në këtë histori të ngatërruar ishte Dili, ai u kaplua nga një ndjenjë altruizmi, harroi xhelozinë që mund të kishte për shkak se hyri një i tretë në mes, deshi të bëjë mësitni për ta! Ai e dinte më mirë se gjithkush tjetër çka don të thotë kur mungon një fjalë e duhur në kohë të duhur, sepse ai vetë kurrë s'e kishte thënë. Por, sikundër që në këtë rrëfim koha kishte qenë faktori kryesor që personazhet i kishte lënë në një ecje paralele, edhe kësaj radhe ishte pikërisht faktori kohë që vendosi epilogun. Sepse, në jetën e Bules, e cila do të ishte lodhur më së prituri që ndonjëri nga të dashuruarit e klasës t'i shpallte

dashuri, kishte hyrë një student i Mjekësisë, me të cilin më vonë edhe u martua. Më vonë, në takimet e gjeneratës ajo vinte vetëm, pa të shoqin, ndoshta për të kujtuar historitë e vjetra emotive që s'patën fund logjik dhe për këtë mbase ndjenjte mallin që s'ia kompensoi asnjëherë harmonia në martesë. Kur vinte në takimet e gjeneratës rrinte pranë Dilit, duke parë një shenjë se diçka kishte pasur mes tyre dikur, diçka që është më e madhe se shoqëri, por që asnjëherë nuk kishte kaluar në dashuri e vërtetë.

Personazhi i tretë, ai që s'kishte qenë asnjëherë prezent, gjithnjë kishte pritur si në pusi dhe në fund ua kishte rrëmbyer dashurinë e tyre rinore së cilës nuk kishin ditur si ta bëjnë për vete.

Si rrëfyes i kësaj historie, më duhet të bëj një distancim nga ngjashmëria me tregimin e Ramiz Kelmendit "Besa dhe Besniku", porse nuk mund të ikë nga rastësia e ngjashmërive, me një përundim logjik se shumë histori jete në situata e mjedise të ndryshme, mund dhe t'i përgjasojnë ndonjë historie të ngjarë ndonjëherë e diku tjetër.

Si përfundim, lexuesit mund të kenë dalë të zhgënjyer nga fitorja jo e të tretit, por të katërtit, porse për të zbërthyer enigmën, vlen një dialog i heronjve të parë.

Dili: Ti e dashuroje një kohë Bulen, pse asnjëherë nuk ia the?

Fatbiu: Unë vërtet një kohë, kam ndjerë diçka që mund të thuhet se është dashuri.

Dili: E përse nuk ia the Bules, e cila dukej se një kohë kishte ndjenja që mund të thuhej se janë dashuri.

Fatbiu: Pikërisht pse ajo më donte, nuk doja ta lëndoj. Sepse unë nuk isha i sigurt për veten. Më duket se më afër dashurisë ishin ndjenjat e tua. Përse ti s'ia the?

Dili: Se nuk desha të hyj mes jush. Si mund të prishja dashurinë midis jush kur ty të kisha shokun e ngushtë.

Fatbiu: Domethënë, gjithë kohën kemi menduar për të mos lënduar shoku – shokun, kurse ajo qe lodhur duke pritur. Mbase kështu dhe më mirë të gjendej larg, larg sprovave.

ERA E ASHPËR

(Tregim i shkruar në gjimnaz)

Jevgu kishte shprehur mllefin në gjuhën e vet dhe unë që pata ndodhur afër shikova kah ai i habitur dhe vërejta se ai ishte një fytyrë thatanik, me mustaqe të zeza, dhe trup mesatar. Në trupin pakashumë me proporcione normale, harmoninë e prishte barku i fryrë, siç mund ta ketë njeriu i ngopur nga shprehia e keqe e të ushqyerit, ose dikush që pi birra pa ia nda. Fytyra e tij ndonëse në këtë të ftohtë, dallonte disa pika djerse të thara, që do t'i kishin dalur gjersa ka ardhur me atë peshë gjer në stacion. Në trup kishte pantollona të kaltëra të punëtorëve e mbi to kishte veshur një pallto me lëkurë të rrejshme, "skaj".

Pastaj jevgu i foli një gruaje pranë tij, e cila me gjasë do të ishte e shoqja. Dhe ashtu me tiparet e saja shihja një grua midis të dyzetave dhe pesëdhjetave, që kishte një dhëmb floriri që shkëlqente në dritën e neonit sa herë që hapte gojën, e në gushë kishte varë një varg florinjsh që gratë e mëhallave të Shkupit i quanin një-lirëshe. Bluza e kuqe dhe një këmishë nën të që i dallohej ngjyrë jeshile, nuk do ta mbronin nga era e thatë dhe e mërzitshme që po frynte këto çaste.

Era që frynte ma shtonte mërzinë në pritjen e autobusit që po vonohej saqë ma kishte sjellë

shpirtin në majë të hundës. Jevgu largohej disa hapa për t'u nxehur, në dallim prej meje që bëja hapa në vend, dhe pastaj kthehej në vendin e vet. Jo, nuk ishte ftohtë, por ishte era që me zor na fuste të ftohtin në palcë. Ngaherë më ngjante sikur një dhimbje dhëmbi kur nuk shtrëngon aq shumë sa të të detyrojë të shkosh ta heqësh te dentisti, por as nuk kalonte.

Jevgu pështyri përtokë. Prapë i foli në gjuhën e tij gruas që duhej të ishte e shoqja. Tani ajo buzëqeshi e ky nuk ndryshoi disponimin gjersa fliste. Gruaja, me gjasë më e durueshme se burri, e dëgjonte me kurreshtje dhe meqë do të ishte mësuar me hujet e tij, s'i mbetej gjë tjetër pos të qeshej, në vend se të përgjigjej.

Ndërkaq nuk ishte puna për të qeshur.

Udhëtarët e parë zbritën nga autobusi që kishte ardhur në stacion pa hetuar, por ky nuk qe ai që prisja.

Jevgu nisi të belatej. Tropaste me këmbë në trotoar për të shprehur nervozizmin e tij. Tek më shkuan sytë te këmbët e tij, vërejta se kishte mbathur do këpucë ushtarake. Në fytyrën e tij të mërzitur tentova të zbuloj shqetësimet që s'i shkakonte vetëm era e thatë.

Kur pret diçka e nuk vjen, të gjithë humbim durimin. Kotësia e pritjes zëvendësohet me kotësinë e nevrikosjes dhe ashtu në mendime të shkon koha. Unë isha mbështetur për njërën shtyllë

të strehës së plastmasës për pritje, dhe qëroja farat e pjekura të kungullit që i bleva në dyqanin e afërm.

Për çudi, në këtë stacion ishim vetëm ne, si një treshe e humbur në pritje, unë në njërën anë, dhe jevgu me të shoqen, të cilët ngaherë grindeshin mes veti. Ishte vonë dhe një orë do të bëhej mesnatë. Në këtë kohë rralloheshin autobusët, sepse dalëngadalë bënin turrin e fundit për të shkuar në garazhë. Padashtas kisha ngulur shikimin në dritën e neonit të shtyllës pranë e pastaj në orën e shtyllës midis dy korsive të rrugës, sa për të humbur ndonjë minutë dhe shikova orën time që vononte dy minuta pas saj.

Ai ishte afruar një hap para meje. Në fytyrën e tij vërejtja një kërcim damarësh nga ana e djathtë faqes së kokës dhe zgavrat e zgjeruara të hundës.

-Edhe ti pret "19-shin"?-pyeti ai me zë të ndrujtur.

-Po-por sikur nuk e ka ndërmend të vijë-iu përgjigja sa për t'iu përgjigjur.

-S'po vjen, s'po vjen, e shoh dhe unë...Por ti pse nuk nevrikosesh?!-ishte pyetja që nuke pritja.

Ç't'i thosha tash? Mos vallë i dukesha i lumtur në këtë pritje në shoqërim të kësaj ere të mërzitshme! Sipas tij, nuk duheshka të pritet autobusi në heshjte pa bërë shamatë.

-Përse të nevrikosem-i them- Jam mësuar mësuar me vonesat. Nuk më bëjnë pështypje, aq më tepër që e di se në këtë kohë ata janë të rrallë.

-Po, po, vonohen në këtë kohë, e di, por më ka ndodhur që në këtë kohë edhe pasi të jenë vonuar, ndonjë shofer i përgjumur as që është ndalë të marrë udhëtarë!-tregoi përvojën e tij.

-Më ka ngjarë edhe mua kjo-i thashë sa për t'i dhënë të drejtë, kurse në vete ndrydhja durimin.

Papritur më shikoi tek haja fara dhe unë i ofrova edhe atij. Së pari refuzoi, por pas insistimit tim, shtriu pëllëmbën ku e zbraza gjysmën e fishekut të farave. Më shikoi habitshëm dhe pastaj u largua ca hapa duke më falënderuar dhe pashë kur i ofroi farat edhe të shoqes.

Koha kalonte me përtesë. Në stacion vazhdonim të jemi vetëm ne tre udhëtarë të vonë. Jevgu u afrua përsëri, tashë ai kishte grushtin përplot gështenja të pa pjekura që i nxori nga një qese najloni. T'i refuzoja, mund ta fyeja, ndonëse s'mund të haja gështenja të papjekura. I mora nja dy gështenja dhe të tjerat i refuzova.

-Merri-tha gruaja-mbushi xhepat. Kur të shkosh në shtëpi i pjek.

-Falemnderit, por më mjaftojnë këto dy kokrra.

Jevgu e shikoi orën e shtyllës në udhëkryq që tregonte 23.20.

-Është e saktë kjo orë, apo edhe ajo është çrregulluar?-pyeti ai.

-E saktë, është, e saktë, ja edhe ora ime tregon aq.

Desha ta pyes se ç'e mirë e kishte lënë kaq vonë në qytet, nga vjen, por s'më hynte në punë gjithaq të dija këto. Por, në vend se unë, më pyeti ai:

-Nga vjen?

-Punë rinie, punë takimesh...-iu përgjigja rretherrotull.

-A-ha, e mora vesh, ke qenë me vashën tënde, sa mirë-dhe shikoi kah gruaja-E sheh, ai vjen nga takimi. Kështu dhe djali ynë do të dalë në takime kur të rritet.

Pastaj shikoi edhe një herë në drejtim timin duke ma hedhur shikimin fund e krye.

-Sa vjeç je, djalo?

-Nëntëmbëdhjetë. Po biri juaj?

-Tash do t'i mbushë pesëmbëdhjetë.

Në zërin e tij ndjeva një indisponim të beftë që poashtu u shfaq edhe në fytyrën e gruas së tij. Ajo nxori një faculetë dhe fshiu një pikë loti para se t'i rrëshqiste për faqe.

Ç'e gjeti kështu këtë çift me të përmendur djalin e tyre. Fundja, djalin e përmendi babai i tij.

Jevgu ngrysi fytyrën. Iu afrua gruas dhe i tha disa fjalë që nuk mund t'i kuptoja edhe pse e degjoja. Por nga fytyra, dukej se ishte diç serioze.

Autobusi ende nuk po vinte.

E mblidhja trupin nën kapotën e leshtë. Sigurisht veshët e pambrojtur m'ishin skuqur nga rrahja e vazhdueshme nga era që po frynte ashpër. Bashkëbiseduesi im futi dorën në një çantë dhe pastaj u përhapën tingujt e një kënge e cila në këtë

moment nuk më kujtohej ku e kisha dëgjuar. Dalëngadalë nisi bashkë me refrenet e saj të më shfaqen dhe fotografi të një filmi të dhimbshëm indian, të shoqëruar pikërisht nga kjo muzikë.

-Dëgjoje këtë këngë...Djali im e ka mësuar përmendësh me tekst e me muzikë. Do të magjepseshe po ta dëgjoje ç'zë ka!

-Sigurisht është me talent djali juaj.

-Sa për talent, nuk bëhet fjalë. Është këngëtar i lindur. Ç'të them më tepër, ma kejtalauar edhe mua.

-Ju kendi kënduar më parë?-shpreha habinë, sepse nuk më dukej ndonjë profil këngëtari.

-Si jo. Në rini shashtriseshin vajzat pas meje. Ja, edhe kjo këtu që qëndron, në atë kohë ka qenë vajzë e pashme, u tranua derisa nuk më mori. Këndoj edhe tash, por kam hyrë në vite, por jevgu nuk mund të mendohet pa këngë apo valle, atë e ka në gjak...E ç'këngëtar ka për t'u bërë im bir, Muharemi, ka për t'ia shkuar!

-Me rëndësi është që edhe të shkollohet, të shkollojë zërin....- i them.

Jevgu rrudhi vetullat. Një hije e rëndë i bie. Heshti, e pastaj murmuriti me ofshamë:

-Të gjitha do të bëhen, vetëm të shpëtojë!

-Të shpëtojë? Ç'i ka ndodhur?

-Është i shtrirë në spital. Me trupin shoshë!

Tash jevgu s'përmbahet dot dhe ndez një cigare. Cigaren që ma ofroi e refuzova duke i thënë se nuk e pi duhanin.

-Eh, tash ndoshta nuk e pi, por do ta pishë një ditë nëse do të kesh ndonjë siklet si unë!

-Si u shtri djali në spital, çka ndodhi?

-Asgjë e veçantë. Ka dashur një vajzë. Ishte e bukur, peri....

U ndal i menduar dhe shtoi më shumë për vete " E ka dashur, por tani nuk e di".

-Atë vajzë-vazhdoi jevgu-e ka dashur edhe një djalë tjetër...

Desha ta vë buzën në gaz se m'u kujtua edhe mua një trekëndsh dashurie, por u përmbajta mos të kujtojë bashkëbiseduesi se po tallem me hallin e djalit të vet. Dëgjova vazhdimin e rrëfimit:

-Pasi të dytë e kanë dashur të njëjtën vajzë, janë rivalizuar mes veti për një kohë të gjatë kush do ta rrëmbejë zemrën e saj. Im bir, që ka një zë të mrekullueshëm këngëtari, shpesh ka shkuar kah shtëpia e vajzës dhe ka kënduar. Por, bandilli tjetër ishte frikësuar se me këngë do ta bëjë për vete vajzën, dhe një ditë ia pret rrugën me thikë në dorë!

-Me thikë!?

-Po, po, ai me hanxhare, djali im duarthatë. Që të dytë kryeneçë, si dy cepër, kacafyten, njëri me grushta tjetri me thikë, gjersa nuk iu hynë në mes të tjerët...Por, djali im kish ngrënë disa thika nëpër trup dhe plandoset për tokë.

Paramendoja skenën e përleshjes dhe motivin e zënkës, sikur të ishte nga faqe romani ose skenë filmi.

-Në spital na thanë se ka derdhur shumë gjak. Iu bënë shumë operacione...E kanë qepur në të katër anët! E kanë harnuar!

-Sigurisht se tash është më mirë?-i jap kurajë.

-Doktorët thonë se ende e ka jetën në rrezik! Ka pësuar lëndime në organet e brendshme... Por ç'marrin vesh doktorët? Do të shërohet ai, do të bëhet më i shëndoshë se ç'ka qenë dhe prapë do t'i këndojë të dashurës te dritarja....

Uturima e një autobusi nisi ta shpojë zhurmën e erës së thatë. I drejtuam sytë dhe vërejtjëm numrin 19 në ballë të autobusit.

HOMO POLITICUS

Është e çuditshme rruga ime e krijuesit. Fati e deshi që të merrem me gazetari, profesionin "më të rrezikshëm" për krijimtarinë. Pse më i rrezikshmi, e dinë të gjithë ata që kafshatën e gojës e fitojnë duke shkarravitur çdo ditë me të vrapuar pas lajmeve.

Gazetaria dhe krijimtaria letrare që nga fillimi kishin nisur të gërshetohen dhe të kushtëzohen në mes veti. Përpjekjet për t'u çliruar nga njëra, ku midis dy alternativave, doja të flijoja azetarinë, kishin qenë të kota. Edhë më i dështuar më kish dalur mundi që në shkrimet për gazetë, të mos fus mjete shprehëse të krijimtarisë letrare.

Gazetaria me krijimet e mia letrare i kishin humbur kufijtë mes vete!

Janë të çuditshme fillet e gëtij gërshetimi. Kur para disa vitesh u shpall konkursi për gazetar, e dija se janë fare reale gjasat për t'u pranuar në gazetën "Lajmsi i mëngjesit". Sepse asokohe pata fatin të isha ndër të rrallët me diplomë të fakultetit të gazetarisë. Por, gjatë pranimit u paraqit një problem jo i vogël. Redaksisë i duhej gazetar për rubrikën e politikës së brendshe, ndërkaq unë kisha synuar rubrikën e kulturës, për të qenë sadopak më e afërt me preokupimet e mia prej letrari. Kryeredaktori, të cilit ia shfaqa dëshirën time, as më refuzoi, as e zgjidhi problemin tim. Nisja ti

sëpari aty ku ka nevojë gazeta, e pastaj janë të mundshme transferet midis rubrikave kur për këtë do të ketë nevojë. Të rrefuzoja, nuk do të ishte ndonjë mençuri në kohën kur të rinj me diploma, prisnin me vite e s'gjenin punë. Të gjithë njerëzit lidhen për nevojat e jetës dhe do të isha i marrë sikur të refuzoja një pagë të mirë çfarë më ofrohej vetëm për shkak se nuk kishte vend në rubrikën time të preferuar. Kryeredaktori ishte vërtet bindës: shumëkush ka filluar në një rubrikë, e ka përfunduar në tjetër, varësisht nga afinitetet e tij. Nëse mendon se ke afinitete për kulturë, në rastin e parë ti do të kalosh në atë rubrikë.

Vitet e para unë nuk e pata të lehtë me luftën përbrenda meje. Ajo luftë ishte reflektuar edhe në shkrimet. Redaktorët shpesh më kishin bërë vërejtje: Ti ke vërtet problem serioz. Në temat politike shkruan me stil letrar. Sa më parë të bindësh se qëndisja me fraza të bukura e shkrimeve tua, do të të hapë mundësinë për t'u bërë komentator serioz, sepse ti ke aftësi vrojtimi, por zbukurimi i teksteve me metafora, është vërtetë një ngarkesë për lexuesin me të cilin komunikon dhe i cili nuk t'i kërkon ato, por fakte dhe gjera konkrete. Temat që i trajton, i kapë dhe i trajton me syrin e mprejtë të një komentatori me përvojë, por ama stolisja e tepruar këtu kalon në shëmti!

Nuk i merrja për të keq vërejtjet, sepse edhe unë shihja se nuk mund të çlirohem nga letrari që flente në mua. Isha rob i mendësisë se pa këto

zbukurime shkrimet janë vërtet të thata, edhe pse vazhdimisht redaktorët më thoshin që ta fus në kokë se prej meje nuk kërkojnë të shkruaj skica, tregime a poezi. Gazetaria është gjë konkrete, nuk e duron letërsinë në vete. Unë mendoja se duhet futur pak bukuri artistike në shkrime. Dëshiroja të ngre nivelin e shkrimeve mbi banalitetin e temave të ditës. Dëshiroja të fus pak ndjeshmëri artistike në problemet politike. Synoja ato pika universale përë çdo kohë e hapësirë. Dëshiroja të gjej lidhjet nga grekët e lashtë e romakët, e gjer te Stalini, Titoja apo Enveri, e deri te Qiroja, Sala, Rugova a Nevzati. Që nga fillet e demokracisë së hershme, nëpër mesjetë e deri te socializmi dhe tash në pluralizëm. Ç'është ai lloz shtytës për sistemet, regjimet, për drejtësinë, për programet politike, gënjeshtrat, fitoret...Sado që të jenë ndryshuar rrethanat, rendet shoqërore, esenca duhej të kishte mbetur po ai për të gjithë kohërat: pushteti, fama, idealet, dështimet, dëshpërimi i masave...Gjithnjë në njërën anë ka qëndruar pushteti, e në anën tjetër masat, që rrallë i kanë gjetur pikat e afrimit, por në një simbiozë të çuditshme, njëra palë s'ka mundur pa tjetrën, edhe pse shpesh i lidh mosbesimi i ndërsjellë. Edhe kur ka pasë harmoni shoqërore, diku në brendinë e asaj pasqyre idilike, ka vepruar urithi që ka gërryer, gërryer... Ai urith që ka luhatur themele sistemesh, regjimesh, diktatorësh por dhe të liderëve që në popull kanë qenë heronjë pozitivë. As kjo kohë s'do të jetë përjashtim. Me heronjtë e mëdhenj dhe të

vegjël, me burokratë e autokratë, biznesmenë e rrogëtarë...Rrogëtar tash jam dhe unë me "pronën intelektuale" siç e quan ligji. Dhe tek do të isha hamendur se si do t'i trajtoj temat, përherë me një dozë të madhe rezerve për gjithë punën e vështirë, s'kisha vërejtur së unë atë e kisha kryer me një mishërim të vërtetë! Për mua temat e politikës më ishin bërë si një ushqim shpirtëror, si buka, pa të cilin s'jetohet.

As vetë s'e di si u zhvillua karriera ime. S'kisha vërejtur sa shpejt e lashë fillestarin prapa, se ndërkohë isha bërë me famë, më dhanë çmimin kombëtar për gazetari. Kur ma ndanë çmimin, në arsyetimin e komisionit patën shkruar: "Gazetari Dalan Kodra kishte sjellë një model të ri të shpehjes në gazetarinë tonë, me një qasje subtile që i kalon kufijtë e shprehjes tradicionale dhe të klishizuar gazetareske...".

Ato dilemat e mia, ajo luftë e brendshme e stileve, kishte rezultuar me "një model të ri"! Kisha plasur së qeshuri nga ky "novatorizëm" imi. Mirëpo, as kënaqësia që sjell një çmim, nuk më kishte bërë gjithaq të lumtur, sepse e ndjeja ende zbrazëtinë në mua. Unë kisha nisur profesionin të bëhem gazetar kulture dhe unë kisha flijuar tashmë këtë qëllim. Zbrazëtia vinte dhe ngase ndjehesha si një bandill që ka tradhtuar të dashurën e parë të zemrës. E kisha lënë fare pasdore letërsinë, preokupimin tim shpirtëror.

Një ditë prej ditësh, më erdhi prej brenda, hyra pa trokitur te dera e kryeredaktorit. Nuk ishte ajo si ato hyrjet e rëndomta çfarë ishte mësuar edhe kryeredaktori gjatë viteve të bashkëpunimit, dhe këtë e vërejti edhe ai.

-Hë, Dalan, ç'e mirë të solli me kaq rrëmbim te unë?

-Prej sot jap dorëheqje!

-Dorëheqje?!-pyeti ai dhe u soll rreth e rrotull në karrigen e tij rrotulluese-Mos ke pirë natën e kaluar dhe ende nuk je kthjellur?!

Donte të më thoshte: prej çka po jep dorëheqje, kur nuk je as redaktor, as zëvendës-kryeredaktor, as kryetar i këshillit të punëtorëve...

-Më konkretisht, nuk dua më të jem komentator politik-ia sqarova që të mos hutohet edhe më tutje.

Kryeredaktorit iu desh pak kohë sa të qetësohej nga befasia. Pasi e pa se unë e kisha me gjithë mend, veproi si çdo shef tjetër a punëdhënës.

-Je i pakënaqur me statusin, me pagën apo të ka bërë presion dikush nga jashtë?

-Asgjë nga këto, por çështja është se nuk dua të vazhdoj më kështu. Unë nuk e ndjej vetën në rregull...

-Sa të shoh unë, je i shëndoshë si kokërr thane. Mos të është shfaqur ndonjë nga këto lëngatat që vijnë me moshën, ndonëse ti edhe nuk je në vitet e mia që të ankohesh?

-Thjeshtë, s'dua më të shkruaj për politikë!

-Hë, aty e ke hallin? Të gjithë u mashtruam kur kaluam në pluralizëm, duke menduar se do të jemi plotësisht të lirë. Po ja, që nuk na doli, domethënë ke presione? Po kjo puna jonë është e nemur, Dalan, në çdo sistem njësoj, askush nuk i duron kritikat, sidomos ato që bëhen publike...

-Jo, është fjala për diçka tjetër...

-Aman se më plase! Thuaj më...

-Nëse ju kujtohet, kur pata ardhur në redaksi, nuk më qe plotësuar dëshira të bëhem gazetar i kulturës, që do të ishte më afër afiniteteve të mia prej krijuesit. Atëherë gazeta kishte nevojë për rubrikën e politikës dhe aty u futa përkohësisht, dhe ja, mbeta gjithë këto vite.

-Po, por mendoj se duke u bërë shumë shpejt komentator politik, ti dëshmove se kishe pasur talent pikërisht për t'i vrojtuar fenomenet si rrallëkush. Lexuesit të kërkojnë, nuk do të jetë mirë për imazhin e gazetës ta braktisësh rubrikën kur kolumnat tua janë ndër më të lexuarat.

-E di, por, vendimi im është i prerë.

U mendua kryeredaktori nga këmbëngulësia ime, ndenji pak me pozën e tij karakteristike kur e kapte mjekrrën, duke kërkuar diçka me sytë përpjetë.

-Nëse është ashtu, do të gjejmë një zgjidhje-më tha pastaj.

Zgjidhja u gjet shumë shpejt. Unë zura vendin e Nderim Ndokës, i cili rreth tre dekada kishte përcjellë teatrin. Me shkuarjen e tij në pension,

ngjarjet në skenat e teatrit do të bëheshin preokupim imi. Kjo ishte ana e mirë e kësaj, ana e keqe ishte se me revolucionin tekniko-teknologjik, pak kush shkonte në teatër dhe më pak do të kishte të tillë që do të lexonin ndonjë shkrim për shfaqje të pa shikuar! Kohë e keqe për t'iu kthyer dashurisë së parë!

Por, me gjithë këto dilema, më në fund, ndjeva lehtësim. Do të ikja përfundimisht nga politika. Do të përcillja shfaqet teatrore, do të shkruaja kritika për to, duke u kthyer kështu në fushë krijimtarie që ishte e afërt me fillet e mia si krijues, e që me vite e kisha lënë pasdore. Kujtoja se kështu do të kem kohë më tepër për t'iu kthyer krijimtarisë. Me të drejtë më kishte qortuar një ditë ish-shoqja nga gjimnazi, Ajkuna: "Mirë, mirë, u bëre emër, por ç'u bë me ato poezitë e bukura që i shkruaje dikur?! Pastaj, ne gjeneratës së gjimnazit na e ke premtuar një roman dhe kaluan gjithë këto vite, e asgjë nga premtimi!". Këto fjalë të Ajkunës, asaj vajzushës që i kishin shkruar vargje shumë gjimnazistë të dashuaruar, të cilët që t'ia merrnin zemrën, kishin provuar të bëhen poetë me zor, i përjetova si një grusht i papritur, që më zgjoi nga një letargji vitesh. Nuk kisha menduar se një takim rasti dhe një vërejtje qëllimmirë, do të më trandte të tërin për t'u menduar ç'kisha bërë ndonjë gjë të bukur gjatë këtyre viteve. Ajkuna kishte të drejtë. Ajo kujtonte poezitë që i shkruaja i frymëzuar nga dashuriçkat

rinore. Në atë kohë, siç na kishte thënë në shaka profesori i gjuhës, shumëkush bëhet poet, por poetët e vërtetë i bën pastaj përvoja e jetës dhe sensi për të vrojtuar botën përreth, me syrin e mprehtë që s'e ka çdo kush, por vetëm ata që kanë vërtetë prirje të dhënë nga perëndia.

Ajkuna më kishte kthyer në realitet. U ndala dhe mendova. Bëra një rekapitulim të kohës që kishte mbetur prapa, nga gjimnazi, fakulteti e gjer te karriera ime e komentatorit të sukesshëm politik. Seç m'u duk se gjithë kohën kisha qenë një shkarravitës letrash pa thellësi, dhe do të më duhej një qortim publik që kisha tradhtuar vetëveten, më kishte rrëmbyer kënaqësia e shkrimeve gazetareske, të cilat megjithatë nuk të japin kënaqësinë e vlerave të përjetshme. I kisha kaluar pesëmbëdhjetë vjet përplot trivialitet ditor. Sikur kisha kaluar nëpër një mokër ose gurë mulliri ku ishte shpërbërë e tërë prirja ime për të bukurën.

"Ç'u bë me ato poezitë e bukura që i shkruaje dikur?!..."-tingëllonin vrazhdë fjalët e shoqes së klasës, sepse e thoshin të vërtetën që s'kisha dashur të ballafaqohem. Fjalët e hidhura do të ndikonin si një cytje për të bërë kthesën në drejtimin e duhur. Do të ngjante një revolucion brenda meje. Unë isha gati të bëj të pamundurën, të kompensoja gjithë kohën e humbur. M'u kthye një energji krijuese e papërshkruar. Nisa t'u kthehem shkrimeve të

vjetra. Habitesha me naivitetin tim të dikurshëm. Dashuri platonike, ndarje e lot, ndjekje yjesh, lutje për kthim. Naivitet dhe çiltëri gatise fëmijërore. Por, në ato shkrime ishte ndalur një hov krijues që po të vazhdonte, sigurisht do të kalonte në nivele të tjera. Në ato letra të zbehta të filleve krijuese kishte rënë heshtja dhe konservimi i temave dhe ideve. Futja në rrjedhën e këputur të krijimtarisë, i ngjante futjes së fundit në lumin uji i të cilit ka qenë i kulluar, porse ndërkohë në atë lum ka pasur shira, vërshime, dhe është turbulluar. Prandaj dhe frika për t'u futur në të ishte baraz me një aventurë shpirti, me një përflakje të trishtë.

Por, zelli me të cilin iu ktheva dashurisë së parë, rezultoi me një boom të papritur. Lindën përnjëherë disa vepra poetike, ca romane, disa drama të cilat u vunë në skenën e Teatrit Kombëtar duke bërë jehonë të madhe te artdashësit. Për mua nisën të shkruajnë në gazeta e revista letrare si për një autor i cili po rishfaq një talent të rrallë anise tash në vitet e shtyra. Nuk i lexoja gjithaq kritikat, me rëndësi ishte se tash vetë isha i kënaqur që kthimi në krijimtari kishte shënuar vlera të mirëfillta, e jo dështim.

Sikur kisha shkelur një rruge magjike, ku përreth janë margaritarët të cilët vetëm duhet t'i zgjasësh duart për t'i marrë e për t'i vënë stoli në vargje ose kapituj romanesh. Tash e shihja se vërtetë kisha pasur fat.

Megjithëqë gjithçka dukej ideale, diku thellë më brente një dyshim. Një ndjenjë subjektive e pakënaqësisë me të shkruarën. Dëshiroja të jetë ajo vetëm një pakënaqësi e autorit, e rëndomtë kur ai dëshiron që në çdo vepër të re ta tejkalojë të mëparshmen. Do të mbetej kështu sikur në disa gazeta e revista letrare të mos paraqiteshin disa mendime interesante. Mendimi më bindës ishte ai i kritikut të njohur Sali Troni, i njohur për symprehtësinë dhe analizat e thella që u bënte veprave, prej nga nxirrte përfundime që s'i vërente dot lexuesi i rëndomtë. Ai kishte shkruar: "Veprat e Dalan Kodrës i lidh një nyje enigmatike e trivialitetit. Nëse e shikojmë elementin e përbashkët të veprave të tij, ajo do të ishte tema banale e politikës. Pikënisje për çdo thurrje romaneske a dramaturgjike për autorin janë temat e përditshmërisë politike. Në njërën vepër është kritik ndaj kryetarit të bashkisë së Qytetit, në tjetrën është nëpunësi i lartë i ndonjë ministrie, në tjetrën skandali i dashurisë i një ministri, kurse në ndonjë tjetër vepër mosdurimi midis pushtetit dhe qytetarëve. Në përgjithësi duke u marrë me tema që dalin nga përditshmëria politike, veprat e tij s'janë gjë tjetër pos një shkëputje kronike nga faqet e gazetave me një mesazh se s'kemi shpëtim nga politika...".

Sali Troni, të cilin e mbanim si penë të parë të kritikës letrare, fjalën e tij në disa faqe mohimi e kishte thënë troç, pa rretherrotullime. Sadoqë unë kurrë s'kisha menduar se veprat e mia, të cilat këto vite kishin qenë më të shiturat nëpër librari, janë në nivel të ngjarjeve të ditës, këtë vlerësim të kritikut të shquar nuk e mora si tragjedi. Për më tepër isha i hutuar që kishte gjetur çelësin e enigmës. Ja përse dhe unë kisha pasur atë rezervë brenda vetes.

Tash, më në fund, kisha kuptuar se në penën time kishte ngjarë një proces bashkëdyzimi. Gjithë atë që kisha aluduar në kohë gjatë shkrimeve në gazetë për çështje politike, e kisha derdhur në vepra letrare. Sikundër që në fillim në shkrimet gazetareske për tema politike kisha futur shumë elemente të shkrimeve letrare, tash më ndodhte e kundërta. Nëse dikur analizat politike s'kishin mundur pa figura artistike, tash librat e mi s'mundnin pa një linjë rrëfimore me situata politike! Me fjalë të tjera, një krijues me identitet të dyfishtë, ose dhe më keq, një krijues me dy identitete paralele, ku bashkëjetonin *homoartisticus-i* dhe *homopoliticus-i*. Prandaj dhe gjithë ajo përzierje stilesh e zhanresh që më kishin përcjellë.

Më dukej se tashmë e kisha humbur luftën. Unë asqë dija të shkruaja ndryshe. Asgjë më nuk mund të ndryshoja nga ky dualizëm i penës, as si njeri, as si profesionist, as si krijues! Në një farë mënyre, do

të isha dorëzuar para fatit. Ky nuk ishte dorëzim i rëndomtë para rrjedhës që s'mund t'ia ndryshoja kahen. Por ishte një lloj pajtimi me realitetin. Edhe Shekspiri dikur i kishte shkruar veprat e tij i motivuar nga ngjarje nga intrigat në oborre mbretërore, që s'janë gjë tjetër pos fërkime politike të atëhershme.

Kushedi ç'porosi universale do të rezatonin këto vepra të mia që kritiku ka vërejtur se janë përplot politikë. Pas një, dy a më shumë shekujsh, do të kishin kuptim universal, apo jo?

NEKROLOGU

Doli papritur në rrugë. Ndejti një kohë të gjatë para TV-së, i stepur, i pa gojë. Një bllokadë truri më shumë se një shtangim trupi të pazakontë, ishte shkas që të shuajë TV-në dhe të dalë jashtë. Jashtë kishte rënë një mjegull e dendur dhe qyteti dukej sikur të ishte zënë rob. Njerëzit që kalonin rrugëve shumë pak i gjasonin vetëvetes, e më tepër siluetave. Ishin ato silueta që njerëzit i identifikonin me xhindet e prallave!

Vërtet, qyteti dukej sikur të ishte mbushur shpirtëra të asaj bote. Një një atmosferë ku mbretëronin nuancat e errëta të ngjyrave (të gjitha ngjyrat sikur ishin shndërruar në të përhime), tok me siluetat bënin që vetë qyteti të dukej sikur ishte në botën tjetër. Vallë të ishte e mundur që ai tash po sillej në një ëndërr të trishtë? Pamjet që projektoheshin në mjegullën e dendur mund të jepnin shkas për të dyshuar edhe në njërën edhe në tjetrën mundësi, por ishte gjë që nuk fshihej se në qytet mbretëronte një atmosferë zymtësie e përshkuar me një lloj frike nga e panjohura. Arianit K. kishte dashur me të shkyçur TV-në dhe me daljen në rrugë të ishte nga një lloj tjetër i zymtësisë, nga ai që për çdo ditë e kishte në ekranin e TV-së, por kjo jo vetëm që s'po ndodhte, por edhe më tepër bëhej pjesëmarrës në të.

Vjeshta e vonë është kohë e mjegullave në qytet-nxitoi të gjejë shpjegimin e logjikshëm, Arianit K., heroi i tregimit. I pa vetëdijshëm se kjo s'mund të ishte pikërisht çështje e stinës, rikujtoi shumë stinë vjeshte të kaluara dhe biente në hall: mjegullat binin mbi qytet në vjeshtën e vonë, apo në dimrin e hershëm dhe ku ishte kufiri midis këtyre dy gjysmë-stinëve ku shfaqej fenomeni. Duke rrahur mendjen se kur ishin shfaqur mjegullat në vitet e kaluara, ai më në fund do të kujtojë se fundja kjo edhe nuk ka ndonjë rëndësi me gulçimën që ai ndjente në fyt, ajo gulçimë që vinte nga kundërmimi i reve të rënda që kishin rënë mbi qytet.

Një frymëzënie ku përzihej mungesa e ajrit ë pastër, lagështia që vinte nga mjegulla por dhe nga mungesa e dritës. Kjo pastaj ndjehej edhe në hapat që ishin të plogësht. Jo vetëm që ishte lodhëse të ecje kështu, porse mungesa e rrezeve të dritës përbënte një element plotësues i frymëzënies. Kujtonte se në këto kushte nuk do të arrinte shumë larg. Diku rrugës do të pushonte frymëmarrja, do të ndaleshin hapat e tij dhe të njerëzve që s'i dallonte nga fytyra.

Një atmosferë e nderë në ajër, një kopje e filmit të Karpenterit "Mjegulla". Mungonte anija para 100 vjetësh, bregu dhe deti që qyteti nuk i kishte, kulla e vëzhgimit s'ishte, sepse brigjet e lumit ishin pak për të sajuar atë pamje që e kishte fiksuar prej shumë vitesh kur e kishte parë filmin. Mungonte

dhe ai shpirti i zgjuar njëqind vjet pas për të gjetur vrasësit, mungonte drapëri i tij në dorë që u prente kokat. Megjithatë, i shkonin mornicat trupit, ca si ethe që ndjente sa nga gjysmëterri, ca nga mungesa e rrezeve. Ishin dhe ethe frike.

Ecja gjer te stacioni ku i hypte autobusit urban u zgjat më shumë seç bënte zakonisht. Kishte vetëm dhe djetëra metra deri te stacioni i Bit Pazarit, kur në një shtyllë vërejti një portret të njohur. U ndal të shikojë foton e tij në një nekrolog. Lexoi tekstin për personin që i përngjante një të njohuri:

PËRKUJTIM:
Më 3 dhjetor vdiq i dashuri dhe i paharrueri ynë...
Fytyrën e tij shembullore do ta kujtojmë
për jetë të jetëve.
Gruaja dhe fëmijët

Emri i të ndjerit, që i dukej krejt i njohur, në këtë moment kur mjegulla kishte depërtuar gjer në kujtesën e tij, nuk i kujtohej. E di unë atë, e njoh. S'mund të them se ishte njeri shumë i mirë, e as ndonjë dashakeq. Ishte një njeri me vyrtyte dhe vese të veta. Nuk mund të them as se e dominuan vyrtytet apo veset. Si çdo njeri, sipas periudhës dhe sprovave të jetës.

Po kush ishte ky njeri?

Fërkoi sytë, në mos e dallonte të paktën nga fotografia. Pasi shpoi bllokadën e trurit, iu kthjell dhe më fytyra e të panjohurit. Dale, dale, po ky,

është, Ai, ai që jeton në hyrjen e godinës...në një hyrje jetojmë. Po, po ai, është, jo vetëm që ka jetuar në një hyrje, por madje në një banesë...Ai ka fjetur dhe me gruan time, o-bo-bo, o-bo-bo,..Ai është babai i fëmijëve të mi! I pacipi, si s'i vjen turp të dalë para meje...qoftë dhe i vdekur.

Po, po Ai është, sigurisht, Ai, vërtet? Madje mbajka dhe emrin tim! Prit, prit, po në atë hyrje kush tjetër mban emrin tim? Po del se Ai jam Unë...

Unë??!!

Po nëse Unë jam Ai, ç'kërkoj Unë këtu përballë Atij?!

Zërrrr, zërrr, zërrr...

Ishte ora e zgjimit nga ankthi.

DASËM PA DHËNDËR

Ishte e shtunë dhe në mëhallën e Kodrajve tashmë ishin vendosur kazanët. Gjithçka ishte gati për dasmën e Felekit. Ishin liruar pesëmbëdhjetë oda të katundit për mysafirë. Ishte shpërndarë harxhi nëpër shtëpitë ku do të vendoseshin ata. Bajraqet i kishin sjellë nga komuna. Bukët ishin porositur nga furra e Gazi Babës dhe ato do t'i sillnin me çezë. E therrën edhe mëzatin "surk", i cili deri tash kishte shpuar me brinjtë e tij shumë mëzetë të tjerë të ushqyer si ai për mejdan, dhe tash gjithë ata që ruanin mëzetën për t'i matë brinjtë me të tjerë, mund të merrnin frymë lirshëm!

Dasmori Fisnik Kodra kishte një nur krenarie në fytyrë. E martonte Felekin, nipin e tij më të vogël, dhe donte të bënte një dasmë për t'u mbajtur mend. Për këtë ai nuk donte të kursente, prandaj e kishte therrë edhe "surkun", krenarinë e ahurit të tij, i kishte thirrë daullexhinjtë më të njohur të Shutkës, usta Rustemin me djemtë e tij, që kishin bërë aheng për dasmat më të njohura të kësaj ane. Kuptohet, për këtë dhe ishin trefish më të shtrenjtë se të tjerët, dhe mund t'i ftonin për lodra vetëm ata që kishin kaçik. Familja e Kodrajve ishte e tillë. Që mysafirët të ndaheshin të kënaqur, ai e kishte thirrë gjellbërësit më të mirë të Çarshisë së Vjetër, Mitko çorbaxhiun, të cilit i kishte dalë zëri se mund të

bënte mrekulli me gjellërat me pasul, patate, oriz, mish të zier ose të pjekur dhe sidomos çorbën me shirija. Njerëzit i lëpinin gishtat. Pikërisht për këtë, ditëve të pazarit, të marteve dhe të premteve, në "ahçianen" e tij pritej në rend për të zënë vend nëpër tavolina, sepse të gjithë kryeparët e familjeve që zbritnin në qytet për të shitur ndonjë bulmet ose për të bërë pazar për shtëpi, nuk ktheheshin pa shijuar një çorbë me mëlmesat më të shijshme, ose një gullash siç dinte ta bante vetëm Çorbaxhi Mitko. Edhe pse i fesë tjetër, jo vetëm që në gjellë nuk fuste mish ose yndyrë derri, por mishin e derrit nuk e përdorte fare, që myshterinjtë e tij të mos bëjnë shybe. Ata pleq me dujçit në krahë shisnin ndonjë kile djathë ose të shpeshtën gjizë e pak kajmak të mbledhur gjatë javës, dhe blinin pastaj zahire për shtëpi, kishin mall të falnin një namaz xhumaje te xhamitë njohura përreth Bit Pazarit dhe Çarshisë së Vjetër, dhe të hanin gjellë te gjelltorja e Çorbaxhi Mitkos. Dhe, të mbushnin dujçit me mollë Tetove. Mu për këtë dasmori i pat thënë Fatiut, nipit të madh, që gjithsesi për dasmë ta angazhojë Çorbaxhinë, pa pyetur për çmim. Dhe ai, që kishte qenë i nderuar kur kishte marrë të falat nga dasmori, kishte pranuar ftesën dhe tash gjendej te kazanët dhe u jepte urdhëra, djelmëve të mëhallës, "ndihmësve" të vet se ç'duhej të bënin. Kishte kërkuar sasinë e duhur të mishit, vajit, dhjamit, patateve, pasulit, qepëve, kurse prej Shkupi kishte sjellë vetë mëlmesat që i bënin të shijshme gjellërat

e tij e që nuk i gjeje jo vetëm në katund, por as në gjelltoret e tjera. Disa thoshin se ia sjellin haxhinjtë nga Jerusalemi, të tjerë se në Selanik i sjellin tregtarët nga larg, nga India, por gjëja më e besueshme ishin fjalët se ai ato vetë i përgatit nga përzierje zarzavatesh e gjethesh e lulesh të bimëve që ai vetë i kërkonte në malet përreth Shkupit, madje gjer te Maja e Selanikut.

Pas faljes së namazit të iqindisë nisën të vijnë mysafirët e parë. Të parët, nga fshati Kopejcë erdhën dajallarët, duke prurë peshqesh dashin e ngjyer me bojë të kuqe në ballë dhe në shpinë.

Më pas erdhën shokët e fëmijërisë nga vetë katundi, të cilët përveç dy qengjave, kishin sjellë edhe fyejt e dyllosur, që ishin punuar me një mjeshtri të rrallë. U radhitën edhe mysafirët tjerë, dosti i Fisnik Kodrës, Xhelili nga Piroku i Tetovës, me të cilin kishin lidhur dostëlli duke qenë bashkë në ushtrinë e Dovletit, kur ai e kishte shpëtuar në njërën nga betejat e ushtrive të Perandorisë. Erdhën edhe nipërit e Fisnik Kodrës, të të dy motrave të martuara në Rashçe dhe Laskarcë...

Erdhi, e kush nuk erdhi, pesëmbëdhjetë oda mysafirë. I gjithë fshati ishte në këmbë. Po të dilje në rrugë pas faljes së akshamit, çdokund shiheshin njerëzit që shkonin andej-këndej, duke bartë sahanë e tepsi dhe bukët për mysafirët, kurse pasdarke, se

si dasmori me burrat e mëhallës vizitonin mysafirët në çdo odë.

Zëri i daulleve dhe zurnave u dëgjua gjithë natën. Ahengu dhe muhabeti nuk kishin të ndalur.

(Por, kohë më parë....)

Në Bunarin e Karaxhës çdo pasdite i shihje gratë e tri mëhallave duke mbushur shtambat me ujë. Ishte ky pus i përbashkët i Kodrajve, Himëve dhe Karaxhëve. Ndonëse pusi gjendej në "territorin" e mëhallës së Karaxhajve, ai ishte amanet i Haxhi Ximës së ndjerë, i cili e kishte hapur me qëllim që të mbushin ujë të tri mëhallat, por dhe i gjithë katundi kur të ketë nevojë. Ai e kishte bërë këtë për hajratë, për hir të Allahut, që çdo pikë ujë që ta pijnë, t'i shkruhet sevapë për në botën e amshuar. "Nuk dua as ta mbajë emrin tim ky pus, le ta mbajë emrin e mëhallës, që të dihet ku gjendet", e kishte lënë amanet. Kështu, ky pus u përkiste vetëm këtyre tri mëhallave, pasi mëhallat tjera kishin puset e tyre, të vetat ose të përbashkëta, e disa sish e kishin më afër çezmen e katundit, prandaj rrallëherë ndodhte që dikush tjetër "i jashtëm", pra nga ndonjë mëhallë tjetër, të mbushte ujë.

Kohëve të fundit ndodhte që pasditeve në Bunarin e Karaxhës të flisnin gratë për një temë jo gjithaq granore. Plaka Xhevë para më shumë grave të tjera që mbushnin ujë, papritmas një ditë u kishte thënë:

"A dini moj të fikta ç'po flitet?!"

"Çka moj e zezë, flitet për të mirë, a për të keqe?"

"Flitet, oj të fikta, flitet....se ka da dalë një ferman i Mbretit...Mjer ju që kini burra në shtëpi!"

"Phu, phu, ...po a për të keq na paska dalë ai ferman, se në mbretëri ka dhe ferman për të mirë!?"

"Ferman, ferman i dovletit, oj fatëzeza...Kur mbreti nxjerr ferman...mjer për ju që keni burra, lum unë që s'kam as burrë as djem!"

'Aman moj t'u thaftë goja, çka na thua?!"

"Po flitet edhe kjo...po flitet se..."

"Hë moj se na plase, për mirë a për keq kjo tjetra?!"

"S'di ç'të them, ndoshta çdo e keqe ka ndonjë të mirë. Në çdo terr ka ndonjë shkëndi dritë...".

Shpresë për fermanin?

"I thashë dhe Lalës Rexhep për këtë që po flitet, e ai: Nëse ka dalë ferma(n), ka dhe orma(n)!"

Fjalëtë për fermanin plaka Xhevë i kishte dëgjuar në gjini të vet, në Lubin, një katund më afër qytetit, prej nga vinin ato lajmet që pastaj përhapeshin gjithandej. Por, sadoqë fjala mort nuk bëhet, prapë se prapë ato kishin futur shqetësim jo të vogël ndër banorët e katundit. "Fermani i

mbretit? S'do të na dalë për të mirë kjo punë?!", flitej pas asaj dite kur plaka Xhevë ua tha grave te Bunari i Karaxhës. Duke qenë më afër Shkupit, fshati i gjinisë së vet, atje vinin shpesh të parat lajme nga Stambolli që pastaj të përhapeshin në gjithë Dërvenin.

Fermani i Sulltanit? Kujt ia merrte mendja se e dinte kuptimin e fjalës "ferman", me mburrje ua shpjegonte të tjerëve. Dëshira për ta zbërthyer këtë fjalë, e sidomos për ta gjetur kuptimin "e fshehur" të tij, ishte një obsesion që do ta zgjaste derisa të mos ndodhte diçka lidhur me fermanin. Çkadoqoftë, ndash për sherr, ndash për të mire, le të marrë fund një herë, thoshin ata. Vetëm të mos zgjaste në pafundësi kjo pritje. Hajt mos thirrni kobin, ç'e kërkoni me ngulm ta dini ç'do na dalë prej këtij fermani, flisnin të tjerët, ata me kujtesë më të madhe në jetë. Por, sa bëhej e kalonte koha, gjithnjë e më shumë i jepnin të drejtë plakës Xhevë që te Bunari i Karaxhës u kishte thënë grave: "Mjera ju që keni burra në shtëpi...". Në fshat nisi një lëvizje më e madhe. Nisën të gropohen strehimore të fshehta, kurse filluan që në stanet e katundit, lartë në Malit e Thatë, të shkonin ata për të cilët dyshohej se bënte fjalë fermani, ndërsa çobanët, për të cilët mendohej se askujt nuk i kishin futur ferrë në këmbë, e aq më pak Dovletit, i kthyen t'i punojnë arat. Ky ndërrim që mund t'u binte në sy shumë lehtë zabitlerëve të Dovletit, ishte një druajtje më tepër, por rrugë tjetër nuk kishte.

Në gjithë këtë shqetësim, kur çdo lehje qensh në fund të katundit bënte që të fiken të gjitha llampat e vajgurit, katundarët i mundonte pyetja e madhe: Kush nga fshati e kishte hidhëruar Sulltanin? Ndoshta i gjithë fshati? Kush tha se fermani është nxjerrë vetëm për një katund. A merret dovlet vetëm me një fshat? Nuk ishte e mundur. Pra, shqetësimi duhej të ishte më i madh, do të shtrihej gjithandej, në të gjitha pashallëqet. Me gjithë hallet e tyre të jetës, ata vit për vit i paguanin të gjitha obligimet ndaj tij. Në anën tjetër, deri tash, në fshat nuk kishte pasur kaçakë. Që kur para disa vitesh ishte zënë në pritë çeta e vogël e Betim Shpatës, kur këtij i shkoi koka se i kishte marrë erë për t'ia kthyer pushkën dovletit, nuk guxonte më askush të bëjë zë e të shprehte qoftë vetëm një fjalë që do të shkaktonte zemratën më të vogël të hyqymetit. Pëshpëritjet e rralla kundër, bëheshin në katër sy, sepse shumëkush kishte frikë nga hafijet të cilat punonin për dovletin.

Mirëpo, duke kaluar koha, filloi të kullohet uji i turbullt i thashethemeve. Fermani i mbretit, siç shpjegonin disa njerëz më të udhëzuar në punët e perandorisë, nuk kishte asgjë për t'u brengosur. Sepse, thoshin ata, sulltani nuk nxjerr ferman kundër miletit të vet. Në gjithë këtë u paraqit një finesë e cila ishte një argument më tepër për rehati. Një ditë erdhën zabtiet nga Shkupi dhe bujtën në hanin e fshatit. Aty ata kishin thënë se kurrfarë

fermani nuk ka dalë, sepse Padishahu i Madh nuk nxjerr ligje e urdhëra kundër miletit të vet. Nuk ka nevojë të nxjerrë ferman të veçantë për ata që ia hanë bukën e ia përmbysin kupën, sepse ndaj të tillëve kanë vepruar ligjet kaherë.

Jo nga fjalët e zaptieve, por më shumë nga shkaku se asgjë nuk po ndodhte, puna e fermanit mori tjetër kahe. Njerëz të udhëzuar mirë, shumë kohë pas shkuarjes së zaptieve, do të tregojnë se megjithatë ka dalur fermani i mbretit, porse ka dalur vetëm për krerët, për bajraktarët. Pa e ditur saktësisht se përse pikërisht për ta. Sidomos ngase me udhëheqës të fiseve kishte kohë që dovleti kishte një bashkëpunim që siguronin qetësi.

Një ditë tjetër te Bunari i Karaxhës tek i mbushte kanistrat për t'u çuar ujë dhenve në stan, plaka Xhevë i tha Rexhep bylikbashit:

"Po flitet lala Xhep', se ka dalë fermani i sulltanit, se do t'i mbledhë të gjithë bajraktarët..."

Kur i thoshte se "do të mblidhen", Rexhep Kodra bylikbashi e kuptonte se ajo donte të thoshte se me këtë ferman sulltani do t'ua priste kokat.

"Nëse ka dalë fermani, ja ku është ormani, oj Xhevë!", ishte përgjigur ai.

Rexhep Kodra dhe i biri Feleki, ishin të vetmit bylikbashë në katund. Deri tash me devotshmëri i kishin shërbyer hyqymatit. Ai shqetësim i beftë nga këto fjalë, e kishte edhe pyetjen tjetër që s'e tha: "Vallë, është e mundur që t'na i presë kokat neve

që i kishim shërbyer me besnikëri dovletit kaq vjet? Për kohën tonë nuk ndodhi një trazirë më e madhe në grykën e Dërvenit. Mos ndoshta ndonjë hafije ka folur për qëndrimin e tyre ndaj Betim Shpatës, se gjoja ata nuk e kanë zënë në pritë kur ka ardhur te jatakët e vet. Nëse ky do të ishte mëkati i yre, cili ishte mëkati i krerëve të tjerë për të cilët paska dalë fermani? Ka të ngjarë që sulltanit nuk i duheshin më krerë që do ta përfaqësonin pushtetin e tij këtu. Nëse nuk do t'i nevojiteshin këta, vallë do të sjellë të tjerë prej përtej? Vallë, gjer aty erdhën punët sa të mos ketë më besim, sa të mendojë se secili bajraktar krahine të jetë një sulltan në vete, që nuk mbledh tagra për arkën e perandorisë por për vete, se nuk e përfill pushtetin e shenjtë të dovletit, se ai vetë ndjehet dovlet në tokën e vet.

Sado që Rexhep Kodra nuk donte t'ua varë veshin thashethemeve, kohë pas kohe e shoqja Duda, kur binin të flenë, do t'i thoshte:

"O njeri, mos e merr punën asgjë...Gratë po flasin për atë t'zi ferman!..."

"Fjalë grashë...Ku dinë gratë nga punët e dovletit?".

'Më dhimbset Feleki...është i ri".

...

Një të premte erdhën zaptiet në fshat. Pasi e falën namazain e xhumasë, u drejtuan në shtëpinë e Rexhep Kodrës, ku lanë një shkresë të firmosur nga Valiu i Rumelisë.

"Është një ditë e madhe për Perandorinë, një ditë që do të shënojë forcimin e mëtutjeshëm të pushtetit të shenjtë të Sulltanit...Është shpikur një pushkë e re me gjashtë fyshekë. Ka gjashtë fyshekë dhe gjuan larg. Për nder të këtij dyfeku, do të bëhet një paradë e madhe ushtarake në Bitol".

U tha zaptieve se e ka dasmën e djalit pas dy javësh, por ata e bindën se do të mbërrijë të kthehet, pasi shkuarja dhe ardhja nuk mund të zgjaste më shumë se një javë.

Pas kësaj Rexhep Kodra ishte më rehat. Ndjeu një krenari të pashoqe: Valiu i Rumelisë i kishete ftuar t'u bëjë nder që të marrin pjesë në paradën e askerëve me pushkë të reja. Dyfekë të tillë pastaj do të kishin edhe ata, bylikbashët. Dimçeku i drurit të gdhendur me ndonjë stoli të bukur që simbolizonte perandorinë, kurse nishanin prej argjendi do të faktonte nga rrezet e diellit. Do të shihej prej së largu. Tek iu kujtua fermani për të cilin flisnin gratë e mëhallës dhe katundit te bunari, ai vuri buzën në gaz: "Të kishin gratë mend sa kanë fjalë, Kurani do të lejonte që ato të bëhen imamë!".

Por, vërtet, ç'të bënin me dasmën e Felekit? Tashmë e kishin ndarë vaden për të shtunën dy javë. Udha vade s'ka, kishin thënë pleqtë, prandaj një herë i shkoi ndërmend që të shkojë gjer në Kopejcë, që me mikun të merren vesh ta shtyjnë për një javë, por kjo nuk iu duk ide fort e mirë. Ta linte paradën në Bitol? Punë që s'bëhej, se nuk iu bën nder valiu çdo ditë, se nëse nuk shkohet, mund t'i

mbetet hatri. Për dy tri ditë pas paradës mund të kthehej edhe atë dy ditë para se të fillojë ahengu i dasmës.

Ashtu dhe bënë, dasma nuk ka të ndalë, as udha, as vdekja.

I ngjeshën armët, dy rende fyshekë dhe u nisën me të birin Felekin, për Bitol.

(Por...)

Në dasmën e Kodrajve mysafirët kishin pyetur ku janë Rexhepi e Feleki, pse s'janë kthyer ende.

Fisnik Kodra, i jati i Rexhepit, i cili i kishte kaluar të 80-tat përgjigjej me druajtje: Do të vinë, do të vinë, nëse jo sonte, nesër patjetër. Do të jenë vonuar rrugës, se udha vade s'ka".

Por as të nesërmen në mëngjes nuk erdhën. Afrohej dreka, kur krushqit tashmë duhej të niseshin për fshatin Kopejcë, që s'ishte as një orë larg, dhe kjo nuk e shqetësonte dasmorin aq, se atje mund të mbërrinin kur të duan, por si të nisen kur as dhëndrri as i jati nuk ishin.

Sëpaku të dinin në janë nisur me siguri dhe deri ku kanë mbërritur.

Parada sigurisht do të ketë përfunduar qysh para disa ditëve dhe se djali dhe nipi i tij, tashmë do të duhej të ishin kthyer. As si ka përfunduar parada ushtarake nuk mund të dinin. Mos kanë thyer kuajt këmbët dhe po kthehen ngadalë? Sikur këta dy të vonoheshin, do të duhej të ishte kthyer ndonjë tjetër pjesëmarrës nga ndonjë katund tjetër, për të treguar. Por, meqë askush nga Dërveni nuk

ishte kthyer, kjo nisi ta brengosë Fisnik Kodrën. Ditën e premte të pazarit, ata që për nevojat kishin qenë në Shkup, kishin dëgjuar disa fjalë, por edhe ato jo gjithaq të kuptueshme. Këtë ia kishin thënë edhe Fisnik Kodrës: "Diçka e madhe ka ndodhur në Bitol!"

Po, e madhe, ishte përgjigjur ai. Për ngjarje të madhe dhe qenë ftuar në atë paradë të askerit me dyfek të ri...

"Po, ama....", s'kishin ditur të përgjigjen këta që ishin kthyer nga Shkupi. Deshën të thonë edhe atë se në këtë ngjarje të madhe përmendet edhe gjaku, por këtë s'ia thanë plakut që të mos shkaktojnë shqetësim edhe më të madh.

Pasi hëngrën drekën, kryshqit u mblodhën në sheshin e katundit, dhe pasi pritën nja dy orë, plaku Fisnik Kodra urdhëroi që të shkohet për të marrë nusen. "Duhet të vijnë patjetër Rexhepi e Feleki", kishte thënë ai, por tashmë me besim të luhatur se kjo vërtet do të ndodhte që të shpëtonte dasma.

Kushëriri, Mustafa, ndenji disa orë mbi avli, duke shikuar nga rruga se mos vinte Feleki për t'u bërë dhëndërr. Legeni e brisku i mprehur pritën më kot, uji u ftoh tashmë.

Krushqit e sollën nusen. Nuk ishte as dhëndrri as vjehrri për ta zbritur nga karroca. Duke u dridhur mbi shkopin e thatë, më i sikletosur se kurrë në jetë, nusen e zbriti zoti i shpisë, Fisnik Kodra. Ishte zverdhur fare, s'i kishte mbetur gjak

në fytyrë. Gratë e paluan Nusen sipas zakonit në një qosh të çardakut, defet nuk pushuan, e as vajzat dhe gratë duke e kënduar me një zë të përmbytur.

Askush më nuk besonte dhëndërri do të vinte gjer para mesnate për ta mbyllur me nusen. Koha që kalonte pamëshirshëm si kurrë më parë, e piu edhe atë pak pikë shprese.

Nusja atë natë fjeti e shoqëruar nga vajzat.

E diela mbrëma, ishte një ndër netët më të pakuptimta në mëhallën e Kodrajve.

"Udha vade s'ka". Me këto fjalë dëshirohej të arsyetohej mosprania e dhëndrrit dhe krushkut, dy personazheve kryesorë në çdo dasëm, por, gjithnjë e më të zëshme bëheshin thashethemet për "ngjarjen e madhe në Bitol" e cila tashmë dukej qartë se mund të kishte lidhje me atë fermanin e shumëpërfolur të Sulltanit.

(Epilog)

Një ditë erdhën përsëri zaptiet në katund dhe u drejtuan në shtëpinë e Fisnik Kodrës. Ia lanë një shkresë.

"Rexhep Kodra Bylikbashi dhe i biri Felek Kodra Bylikbashi, me urdhërin e Sulltanit u vranë si murtatë të Perandorisë"!

Siç rrëfyen më vonë, në Bitol i kishin ftuar të gjithë krerët e trojeve shqiptare, pashallarë e agallarë, bejlerë e çaushë, bylikbashë e askerë të tyre, dhe i kishin rreshtuar karshi togës së askerëve me dyfekë të rinj.

Pastaj ishte dhënë urdhëri...

Ishte zbrazur batarja mbi mysafirët e veshur për paradë. Derisa bienin të kositur nga plumbat, patën pak kohë të pyesnin veten ç'kishin gabuar dhe cili ishte mëkati ndaj perandorisë.

Thoshin se kështu nga Stambolli ishte dërguar porosia siç ndodhte shpesh në kënde të ndryshme të Perandorisë: "Allahu në Qiell, Padishahu në tokë! As i bëhet shok Allahut, as ortak Padishahut"

....

Nusen e Felekit e kthyen për Danin, kushëririn 14 vjeçar.

GJYKIMI I PARTIZANES ROBËRESHË

Beteja te ura kishte përfunduar. As partizanët e morën urën, e as ballistët dolën matanë lumit të Treskës. Ishte një moment i mjaftueshëm për të prajtur midis dy betejave. A do të suleshin partizanët të parët për të dalë në bregun tjetër, ose ballistët që t'i dëbojnë përtej malit të Ujanës prej nga kishin ardhur, ishte çështje taktike e dy shtabeve komanduese. Për çdo eventualitet Arif Kapetani urdhëroi rojet të qëndrojnë pranë urës dhe përskaj brigjeve, gjersa të numrohen të gjallët, të vdekurit dhe të plagosurit. A kishin pasur fat kësaj radhe të kalonin pa të vrarë? Po. Por si kishin kaluar me gjahun ndaj kokave të partizanëve?

Kur komandanti i ballistëve i numëroi luftëtarët, i kishin dalë të gjithë në numër, përveç Ruxhës së Bojanës. Nisën të shikohen luftëtarët mes veti. Si mundet Ruxha të ketë mbetur në betejë. I plagosur apo i rënë "shehit"? Urdhëroi një patrullë të shikojë përreth mos e gjenin diku të shtrirë përtokë. Por, gjersa patrulla po nisej pas tij, diku larg, dy hije njerëzish, një më shtatlartë, e tjetri me shtat të shkurtër po kalonin lumin në këmbë. Siluetat dallonin dhe nga ngjyra e veshmbathjes: ai me trup më të lartë, ishte me tirqi dhe kapelë të bardhë në kokë, ndërsa ai me trup të shkurtër për

gati një kokë, me veshmbathje që prej së ngjyrë të përhime ose jeshile. I shkurti ecte para të gjatit. Ore, këta s'janë të një ushtrie, vërejtën disa më symprehtë! Ishte vranët që të mund të dalloheshin hijet prej së largu, por ai me shtat të lartë, do të jetë Ruxha! Po, po, brofën në këmbë të gjithë, ai është Ruxha, shëndoshë e gjallë. Ai ishte shtatlarti, i cili, tashmë gjersa shikonin më mirë, mbante mauzerin gati pas shpinës së shtatshkurtit. Disa që ia patën zili për një moment thanë me vete: ore ky na doli trimi i betejës, ka zënë një partizan!

-Ore, ky Ruxha ka zënë ndonjë partizan, ose ndonjë fëmijë partizani!?-foli Arif Kapitani, duke mos e fshehur hutinë dhe pakënaqësinë.

Por, habia do të pasonte kur Ruxha ta afronte robin e luftës. Sepse nuk na doli rob, por robëreshë. Ishte një luftëtare partizane, me kapuçin me yll të kuq në kokë, e cila përskaj Ruxhës shtatlartë dukej sa një fëmijë që posa është rritur!

Komandanti edhe më shumë u zemërua. Si ia lidhën duart dhe caktuan dy veta për ta ruajtur, Arif Kapetani e thërriti mënjanë Ruxhën.

-O i humbur, nga gjithë ata partizanë, zure këtë shkinë!? Çka jemi ne, luftëtarë në shallvare!? Kështu do të luftojmë për shtet?

-Komandant, po unë e zura me pushkë në dorë! Kushedi sa ka vrarë si ne tyta e saj!

Ai kishte të drejtë! Edhe ajo ishte njëra që ka dalë në mal për ideal të tyre! Por ama femër, ta hajë

dreqi. Ç'janë dhe këta partizanë që marrin femrat në luftë! Luftojnë ore, o bëjnë dashuri nëpër kaçuba!? Iu kujtuan fjalët e Xhemil Efendisë që kishte folë për komunizmin dhe komunistët: "O vllazën, si duket osht avajt dita e qametit! Ne sa duhet t'luftojmë për Shipni, duhet t'luftojmë kundër ktajne komunistave. Ata nauk dinë as për din, as për iman. N'at' Rusinë e Moskovit, krejt hajshin pi ni kazani, pi ni luge! Ata, larg koft prej nesh, i dajshin ene gratë me njoni-qetrin! Mos ta lamë këtë farë t'mbajllet e t'bie n'këtë dhe t'muslimanit!"

Arif Kapetani u gjet në hall. Deri tash nuk kishin pasur rast të zënë rob ndonjë luftëtar të armikut, e lere më të kenë zënë ndonjë femër. Çka kishin pasur punë me partizanët, e kishin pasur së largu. Këta gjuaj prej kësaj ane të bregut, ata gjuaj prej asaj ane. Për një kohë të gjatë ishin bërë beteja të përgjakshme te Ura e Gllumovës, por fati i vullnetarëve të Dërvenit kishte qenë i tillë që për një kohë të gjatë kishin mbetur në këtë anë të bregut. Lufta e tyre kishte nisur ta humbë kuptimin, sepse përderisa këta nuk shkonin matanë, e partizanët nuk depërtonin në këtë anë, pyetja ishte për të vrarë kokën. Për çka luftonin? Kush sulmonte e kush mbrohej? Si do ta bënin shtetin e tyre nëse nuk arrinin t'ua merrnin një fshat që gjendej fill pasi ta kaloje urën. Nuk qahej Arif Kapetani te luftëtarët, te zelli i tyre, te ideali i

tyre. Të gjithë kishin shkuar për një qëllim, "Ja Shipni, ja gjur e hi!". Kjo ishte pjesë e një luftës së pambaruar që pas 1912-tës, të cilën s'e kishin harruar. Si kishte ndodhur që pasi ishte marrë Shkupi nga turqit, të binte pastaj në dorë të serbëve. A nuk vendosej fati i luftës me pushkë? Me pushkë e morën Shkupin dhe tash në këtë luftë të sërishme për shtetin e tyre, gjithandej zhvilloheshin betejat, por në Shkup jo.

"Eh, sa të shkojë gjermani, do të shohim!", thoshte ai. Kështu kishte thënë edhe kur Shkupin e kishin marrë bullgarët. "Sa të shkojnë bullgarët...", ama kur ikën bullgarët, erdhën gjermanët. Kujt ia mbante të matej me ta? Pastaj a ndërhyhet në luftërat "e mëdha" me një pushkë me gjashtë plumba në krah? Me gjermanin ishte punë që duhej "të mëdhenjtë të merren", e jo një grusht shqiptarësh nga Dërveni. Përveç kësaj, gjermani u kishte dhënë bukë shumë shqiptarëve të Dërvenit. Askush më parë nuk i kishte paguar si gjermani në mademin e Radushës dhe si t'ia kthenin pushkën, do të humbnin bukë shumë familje. "Ah, mbret o mbret, na lae jetimë!" thoshte nga një herë dhe në maje të gjuhës i vinte për ta sharë, por zbrapsej nga mendimi se mbreti yt, edhe hale të jetë, është halja jote, duhet nganjëherë të hysh patjetër për të kryer nevojën! Ai nuk kishte qenë i hajrit pa luftë, e lere në luftë. Sa qe mbret, i la nën serbin, e kur krisi lufta, iku matanë detit me brekët plot! Mu për këtë,

herë - herë i vinte keq për turkun që iku. Ç'na u desh t'ia kthejmë pushkën, se më mirë mbret mysliman, se ndër Kralin shka. Ndonjëherë thoshte më mirë të kishin marrë udhën e Anadollit kur Krali ua hapi derën që krajlia e tij të lirohet nga shqiptarët, por në anën tjetër, guri rëndon më shumë në vend të vet, dhe a lihet kjo tokë për ta marrë shkau?

"Si quhesh?" e pyeti partizanen në gjuhën e saj.

"Sofia,...Sofia Strugar", u përgjigj ajo duke ia kthyer me një zë të thartë plot urrejtje "po ç'të duhet tash emri im?"

"As vetë nuk e di më duhet a nuk më duhet emri yt. Kur flas me dikë dua të di se me kë po flas...Por, përse po luftoni moj zonjushë?".

"Për shtet, po luftojmë, për një shtet dhe një shoqëri, ku unë dhe ti do të ishim të barabartë!"

"Ia nise propagandës së kuqe, ë?! Harron se ku je?"

"Më pyete, të tregova! Unë luftoj për idealin e asaj shoqërie, pa mbret, pa zotër dhe shërbëtorë, pa shtypës dhe të nënshtruar. Nuk të duket se po luftoj për një çështje të drejtë? Po ti pse po lufton?"

"Shih, shih, e paska gjuhën e mprehtë dhe me helm kjo zuskë e kuqe!". Deshi t'i mëshojë një shuplakë që t'i shkojnë xixa syve, por u përmbajt se kishte dëgjuar nga hoxha i katundit se qoteku nuk ka dalë "nga xheneti", ashtu siç flasin laikët, por madje mund të digjesh për qotekun e pamerituar

që mund t'ia japësh ndokujt. Po, ama në moment iu kujtua se hoxha kishte thënë se në disa vende myslimane mëkatarët i rrihnin publikisht, ndërkaq kjo partizane gojëhelm do ta meritonte atë dajak. Sigurisht gjer në fyt është në mëkate. Partizanët kishin pirë "tamblin e Moskovit", dhe ata nuk besonin zot, edhe pse nga qielli kishin "zbritur" një yll dhe e kishin vënë në kapelat e të pafeve.

"Ç'të bëjmë me ty?!"-i kishte thënë Arif Kapetani, por më tepër për vete se asaj.

"Çka t'i bëjmë? Të kishte qenë burrë, kollaj, po me këtë femër gojëhelm, çka do që t'i bëjmë, do të gabojmë" u kishte thënë edhe atyre luftëtarëve që i mbante afër vetes saherë që kishte ndonjë mëdyshje.

"Hë avokat, çka thua ti?"-i ishte drejtuar Sejdës së Bukoviqit, të vetmit që kishte diplomë, dhe atë jo çfarëdo, por diplomë Italie. Ai kishte fituar para lufte një bursë nga Mbreti dhe kishte kryer fakultetin e drejtësisë në Itali dhe sapo ishte kthyer dhe kishte hapur zyrë avokati, kishte ardhur lufta dhe gjithçka e kishte marrë dreqi. Kush zihej me dikë e të shkonte te avokati? Në luftë shkoje si qeni në rrush dhe kurrkush kurrkujt s'i jepte përgjigje. Pastaj ende vepronte Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe njerëzit s'kishin nevojë të dilnin nëpër gjyqe, po ia lidhnin krenë punës vetë me grykën e "martinës".

"Unë do të kisha thënë disa fjalë, por do të doja në katër sy"-i tha Sejda i Bukoviqit. Komandantit nuk i erdhi aq mirë, jo pse dikush do të dyshonte se

ç'kanë për të folur për të mos ditur të tjerët, por pse kështu mund të fyheshin ata. Megjithatë, u dha shenjë të tjerëve dhe mbetën vetëm ata dy.

"Komandant, ti mban gradë ushtaraku, apo jo? E din ç'do të thotë kjo? Kjo don të thotë se duhet t'u përmbahesh rregullave të luftës për robërit!".

"Don të thuash se unë mund t'i shkel ato rregulla?". Në një moment iu duk si një shprehje arrogance dhe mendjemadhësie. Sikur desh t'i thotë, ti je komandant, ama "pa shkollë", dhe nuk di si të veprosh, edhe pse vetë ishte ai që i kishte kërkuar mendim.

"Bëhu më i qartë".

"Dua të them këtë. Lufta është luftë. Lufta ka dy palë që shihen në nishan. Ti gjuan dhe vret, ai të gjuan dhe të vret, Kurrkujt kurrgjë. Më vrave, të vrava, luftë është kjo. Por, kur dikë zë rob, kur dikush i ngre duart për t'u dorëzuar, punët ndryshojnë!"

"Punët ndryshojnë thua, po armiku mbetet armik!"

"Armik është gjermani për inglizin, por kur e zënë rob njëri tjetrin, ata nuk i vrasin, por i këmbejnë robërit me marrëveshje!"

Komandanti Arif Kapetani u çua në këmbë! "Çfarë marrëveshje me të kuqtë e pa fe dhe të pa besë!?"

"Shih komandant", iu drejtua me zë të ulët Sejda i Bukoviqit, "nuk duhet të ngutemi. Mund të çojmë një korrier deri te Xhemë Hasa, ai është

Kryekomandant. Po deshe, të pyesim Hafëz Hasanin e Bojanës, edhe ai është i ditshëm dhe i lexuar. Bile mund të na tregojë se ç'thuhet në Kur'an për robërit e luftës!"

Arif Kapetani u mendua gjatë, kurse Sejda vazhdoi: "Pastaj, komandant, dije një gjë. Një ditë do të përfundojë lufta, dhe nuk dihet nga do ta rëndojë kantari i fatit. Për çdo shkelje të ligjeve të luftës, mund të përgjigjet ndokush. Të shpeshtën përgjigjen komandantët, madje jo vetëm për gabimet e veta, por dhe për fajet e luftëtarëve të vet!"

"Ç'janë ore këto ligje?...Atje te Duçja i ke mësuar këto rregulla!?"

"Këto janë ligje të luftës! Ushtritë e rregullta, kështu veprojnë! Ka dhe ushtri bashibozuke që s'përfillin rregulla. Pyetja është, çfarë ushtrie jemi ose duhet të jemi ne?"

Këto fjalë e shpuan ku s'duhet Komandantin. Vërtet, çfarë ushtrie jemi ne? Vullnetarë! Vullnetarë që luftojnë për tokën e tyre, për shtetin e tyre që t'mos ua marrë edhe një herë shkau, e sidomos këta të kuqtë që kishin sjellë atë farë komunizëm të Moskovit. Po ama shpesh i dukej se si ushtri më shumë kishin zemër se tru. Dukej se qëkur kishte fluturuar Mbreti Zog përtej deti, të gjitha ushtritë që luftonin për mbrojtjen e tokave shqiptare

dukeshin si të pa kokë! Prandaj dhe nëpër katunde quheshin "vullnetarë".

"Po, ti avokat, si thua, po ta zënë ndonjërin nga ne, çfarë do t'i bënin këta partizanët?".

"Unë nuk e di çka do t'i bënin? Po nëse janë ushtri ashtu siç e mbajnë veten, rregullat vlejnë edhe për ta! Gjyqi i drejtësisë së luftës vlen për të gjithë".

"A na mbeti Daut Logri i Bojanës i plagosur matanë malit të Ujanës? Ç'i bënë partizanët kur ra në duart e tyre?", e pyeti avokatin.

"Unë flas për rregulla, sepse lufta ka rregulla. Përderisa nuk dimë ç'ka ndodhur me Daut Logrin, në ka vdekur nga plagët para se të zihej nga partizanët, në e kanë zënë partizanët dhe a është gjallë apo jo...Komandanti i tyre mban përgjegjësinë nëse i kanë shkelur rregullat e luftës".

"Po cili ligj dhe gjyq do t'i gjykojë ata?!".

Arif Kapetani mbeti me dilemat e tij. Si një luftëtar i kauzës, te partizania shihte një armike dhe pengesë për sendërtimin e idealeve të luftës. Kjo që i thoshte avokati e shtyri të mendojë, sepse një fshatar si ai, që e kishte lënë parmendën në arë dhe kishte marrë pushkën për në mal, nuk mund t'i dinte të gjitha. Por, nuk ishte aq pa dijeni rreth bëmave të armiqve të tyre, partizanëve. Ata bënin gjyqe për ata që i konsideronin armiq, dhe pa një pa dy, i pushkatonin. Pse të mos bëjmë edhe ne një gjyq, thoshte ai? "Kush lufton kundër nesh, është

armik apo jo? Kush është armik, duhet të gjykohet, apo jo?! Dhe të marrë dënimin e merituar". Ta mbash këtë partizanen gjithë kohën duarlidhur dhe ta marrësh me vete në çdo betejë, do të duhet të ndash nga luftimet të paktën dy veta që të mos ikë. T'i japish bukë nga buka e luftëtarëve të lodhur nga betejat. Ta këmbenin me robër që kanë zënë partizanët, i dukej punë që s'bëhet. Ku mund t'u zësh besë atyre që s'i besojnë Zotit? "Cilin ballist e zunë ata dhe e lëshuan pastaj?".

Ne kemi dhe parinë civile, kujtoi komandanti i aradhës së Dërvenit. E kemi kryetarin e komunës së Arnaqisë, Hafës Hasanin, njeri i ditur, nga të rrallët e kësaj ane. Po, ajo që më së shumti do të sqarohej, ishte çka thotë Kur'ani famëlartë për këso situatash, si ka vepruar Profeti Muhamed me robërit e luftës. Arif Kapetani deshi të shihet vetë me Hafës Hasanin, të cilin të nesërmen e gjeti në zyrën e tij.

"Kemi zënë rob një partizane, s'dimë si të veprojmë. Ta marrim me vete nga të shkojmë nëpër beteja, është punë që s'bëhet. Nuk është arushë ta shëtisish nëpër katunde, e as ne jemi gabelë që shëtisim arusha. Ndoshta si kryepar i Dërvenit, mund dhe të ta dorëzojmë, si pushtet, pastaj vendos çka është më mirë".

"Ju jeni ushtri, ju keni përgjegjësi"-i tha Hafës Hasani. "Të ishte një hajne ordinere, një vrasëse në kohë paqe, do të ishte marrë pushteti civil me të.

Ne jemi në luftë, e në luftë gjerat zgjidhen ushtri me ushtri".

Nga ç'i thoshte Hafës Hasani komandanti s'mund të ishte i kënaqur. Fjalët e tij dukeshin si ato të avokatit. Rretherrotull, pa kuptim. Prandaj me respekt të veçantë iu drejtua atij si një njeriu jo të pushtetit por të dijes, si imam i njohur që ishte, si njeri që ka lexuar Kur'anin.

"Gjerat dihen. Muhamedi A.S. ka bërë shumë beteja me qafirat, me të pafetë, dhe me shumëzotërit, ka zënë shumë robër, por me ta është sjellë mirë. Në ka qenë për t'u falur, e ka falur, në ka qenë për t'u kthyer në këmbim me para, e ka bërë, në ka qenë për t'u këmbyer me robërit që ushtria qafire ia kishte zënë ushtarët e tij, i ka këmbyer. Ka pasur dhe gjykime për ata që kanë kryer krime lufte!".

"E si t'ia bëjmë ne?"-pyeti komandanti.

"Ju e dini vetë në duhet gjykuar ose jo, këmbyer ose falur, ose dënuar. Kushdo që ka marrë jetë të pafajshmish, meriton ndëshkimin. Edhe të gjyqeve të kësaj bote, edhe të të Madhit Zot".

Ah, hoxhë, o hoxhë, tha me vete komandanti, mua më duhet thënë troç, ta vrasim ose ta falim, e ti m'i hapë plot rrugë. Që ka vrarë kjo nuk duhet të diskutohet gjersa ka dalë në mal. Ka vrarë të pafajshëm? Kush i jep të drejtë asaj të vrajë

këdoqoftë, qoftë dhe ndonjë që po si ajo, lufton për ndonjë kauzë tjetër. A nuk është kjo vrasje të pafajshmësh? Apo të pafajshëm janë vetëm ata pa pushkë në dorë?

Kur u kthye në aradhë, përsëri e thërriti Sejdën e Bukoviqit. Me gjasë ti do të kesh të drejtë, i tha atij. Lufta me ligjet e veta, por dhe feja i ka ngjashëm. Çështja është si të dëshmojmë nëse kjo partizane ka vrarë dikë "të pafajshëm".

"Komandant, qyshse ka dalë në mal për të luftuar, mund ta marrim me mend se do të ketë vrarë ndonjë luftëtar si ne...".

"Domethënë, s'kemi çka të mendohemi, e pyesim a ka vrarë, nëse thotë po, edhe ne asaj plumb në kokë!"

"Dale, Kapetan, nuk është aq e thjeshtë për t'u gjykuar. Një shtet nga një shtet tjetër dallon për nga drejtësia, e jo drejtësia të bëhet me "si na e bëjnë do t'ua bëjmë"! Ne duhet t'i bëjmë tamam gjyq, nëse duhet të ndajmë drejtësi".

Gjyq? S'i kishte shkuar mendja se duhet të formojë gjyq. Caktoi veten, Sejdën dhe Zirapin e Ramës së Bojanës si trup gjykues. U ulën në një dru të prerë si gjykatës, kurse karshi tyre, në një shkëmb u ul partizania. Luftëtarët ishin nga të gjithë anët si publik. Gjykimi u vonua nga shkaku se Sejda i tha komandantit se i gjithë gjykimi duhet të shkruhet në letër, duhej gjetur njeri që do të mund të merrte shënimet. Disa talebe që kishin

mësuar te Mulla Mustafa i Bojanës nuk i dolën zot kësaj pune, sepse deri atëherë kishin shkruar shqip, por me shkronja arabe. Aty ishin edhe disa që kishin kryer katër klasë fillore, por problemi ishte i njejtë. Se në shkollat e Krajlit, ishin mësuar shkronjat serbe. "S'ke ku shkon" i tha Sejdës, "ti ke qenë edhe në Tiranë, edhe në Itali, në mos i ditsh shkronjat shqip, ato italishte janë të ngjashme. Ulu aty, bëhu vetë gjykatës dhe vetë merr shënime, sepse këto gjëra do të jenë pjesë e historisë se si kemi luftuar për shtetin tonë!". Tefterë nuk patën nevojë të kërkojnë, sepse i vetmi që në janxhikun e tij kishte defterë, ishte Sejda.

Tamam të fillonte gjykimi, edhe një ndërprerje. Sejda i pëshpëriti në vesh komandantit, e ky meqë s'e dëgjoi, e thërriti të hynin në zyrën e shtabit, në shtëpinë që ishte në hyrje të Gllumovës.

"Ç'deshe t'më thuash?" i tha i hutuar komandanti.

"Kapetan, ajo ka të drejtë të ketë mbrojtës".

"Mbrojtës?! Çfarë mbrojtësi ore, ne e gjithë aradha e mbrojmë, kush e ngucë, vetëmse duhet ta gjykojmë!".

Sejda ia sqaroi se në çdo gjykim, i akuzuari duhet të ketë avokat i cili do ta mbrojë.

"Ore avokat, mos deshe tash t'ia ndërtojmë edhe një pallat gjyqi asaj, me lloj-lloj zbukurimesh

prej druri që të ndjehet mirë, ë? Ku t'ia sigurojmë, kur as ne nuk kemi kulm mbi kokë!

"Mund të jetë ndonjëri nga ne mbrojtës i saj. Kur një i akuzuar nuk ka avokat, atij i siguron ai që e gjykon, pra vetëm gjyqi, më saktë, shteti!"

Kapetanit i humbte durimi. Nisi të pendohet që kishte pyetur "më të ditshmit", të cilët vetëm ia komplikonin punën. Tash do të duhej të harrojnë luftën me partizanët që vazhdimisht çonin krye matanë lumit, për t'u marrë me një partizane të tyre robëreshë këtej.

Komandanti urdhëroi që partizanes t'i jepet të hajë nën mbikqyrje. Asaj i duhej ta mbushte barkun, sepse do ta priste një gjykim i cili nuk dihej sa do të zgjasë. Komandanti vendosi që ai vetë të ishte prokuror, gjykatës caktoi Sejdën e Bukoviqit, kurse për mbrojtës të partizanes, caktoi Xhemshitin e Krosëve të Raçes, i cili kishte kryer shkollën në medresenë e Krajl Aleksandrit në Shkup. Në këtë ndarje rolesh më së shumti u ankua Xhemshit Krosi. "Ku di unë ta bëj këtë punë, kapetan, s'kemi mësuar këso gjërash në medrese! A mua më gjete për ta mbrojtur këtë të pafe që do të digjet në atë dynja në zjarrin e xhehenemit!".

"Kështu e dashka puna. Ne kemi një gjysëm shtet që mezi e bëmë këmbë e duar para katërdhjetë vjetësh dhe duam të bëjmë një shtet të plotë

shqiptar, apo jo? E po ja, avokati po na thotë se për një shtet të këtillë, shumë me rëndësi qenka drejtësia. Edhe gjykimi është një drejtësi, të gjykosh që të kuptosh fajin ose pafajësinë e dikujt. Ne askë nuk duam të shpallim fajtor pa qenë, dhe nuk do ta lëshojmë të pafajshëm nëse është i fajshëm. E ke të qartë? Pastaj ti, me sa di unë ke mësuar pak ilm edhe te mulla Beqa n'Raçe dhe mund të dishë të drejtën e sheriatit më shumë se secili luftëtar këtu?"

Xhemshiti i Krosëve u pajtua, por nuk mendonte se në këtë ndarje detyrash të këtij gjykimi, atij ia kishin ndarë rolin më të qëlluar. As kishte qenë ndonjëherë në gjykim, as kishte qenë vetë i gjykuar. Vetëmse i kishte me përrallisje shumë rrëfime për kadinjtë dhe drejtësinë e tyre të korruptuar, kur dovleti kishte kishte marrë teposhtëzën. Nuk e kishte pasë asnjëherë të qartë në ishin kadinjtë e korruptuar shkaktarët e kësaj rënie, apo rënia e perandorisë kishte shkaktuar edhe rënien e drjtësisë së saj. Kur u prish drejtësia, u prish dhe perandoria, kujtoi ai. Me fjalë të tjera, në këtë gjykim s'duhej vendosur as me hatër, as me hile. Roli i tij do të ishte në drejtim të një vendimi sa më të drejtë për këtë partizane.

Kur Sejda-Gjykatësi e hapi gjykimin para luftëtarëve, mbretëroi një kureshtje e madhe se si do të rridhte ky gjykim, të cilin disa e merrnin si fare të panevojshëm: "të kuqve dhe të pafeve,

plumbin në ballë dhe udha mbarë!". Por, pajtoheshin se duheshin të respektohen më të ditshmit ndër ta, të repsektohen urdhërat, se "nuk jemi ushtri bashibozuke". Por tek dëgjonin të fliste Sejda-Gjykatësi për gjykimin, atyre me një vesh u hynte, në tjetrin u dilte. Sejda tha disa gjera, të cilat ata që i kuptuan se çka tha, mund të rrumbullakoheshin me pak fjalë: domethënë, kemi një të dyshuar para nesh që ka një farë faji për të cilin duhet të gjykohet.

Kur ia dha fjalën Komandantit – Prokuror Arif Kapetani, ky mbeti ca i hutuar!

"Çka të them unë?"-iu drejtua gjykatësit.

"Thuani për çka e akuzon Prokuroria. Cili është faji i saj për të cilin ju mendoni se duhet të dënohet!"

Komandanti u gjet vërtet në siklet, por pasi përmblodhi veten dhe tha në vete "do t'ia tregoj qejfin shkinës", tha: "Kjo, zonjusha këtu, Sofia Strugar, duhet të dënohet për shkak se ka luftuar kundër çetave tona! Ajo sigurisht ka vrarë luftëtarë tanë".

Kur përkthyesi, një ish medresant nga fshati Kopanicë, Beqir Gjushti, ia përçonte në vesh me vonesë fjalët e prokurorit, partizania reagoi ashpër:

"Unë nuk jam zonjushë borgjeze, nuk pranoj gjyqe borgjeze!".

Prokurori u ngërdhez: "Ti do t'na tregosh çfarë gjyqi do! Sus moj e pafe!".

Reagoi Gjykatësi: "Ju lutem ta mbani nivelin e gjykimit. Nuk do të toleroj këso sjelljesh!". Sikur iu drejtua të dy palëve dhe ndonëse Prokurori-Gjykatësit-luftëtar. "Ore, ky që vetes i ndau rolin e gjykatësit, dëshiron të hypë mbi mua-Komandantin", kujtoi, por nuk ishte vendi që t'ia tregojë ku e ka vendin ky luftatar që ai vetë e kishte bërë Gjykatës, tash duhet të vazhdonte gjykimi dhe foli: "Fajtore është se duke luftuar kundër çetave tona, ajo ka rrezikuar luftën tonë të drejtë për Shqipni".

Sejdo Bukoviqi, siç e quanin, tash gjykatës i këtij gjyqi të partizanes e thërriti Prokurorin që t'i thotë pa teklif:

"Shih Kapetan, nuk mund të dënohet me kësi lloji akuzash! Ajo lufton për idenë e vet, ne për tonën, e ke të qartë? Ku është fajësia këtu! Luftë është për ide, për qëllime, secila ushtri i ka të vetat. Ne si gjyq duhet ta gjejmë krimin e vërtetë të saj!".

Kapetani ia ktheu poashtu pa teklif, gjersa të tjerët nuk dinin çka flisnin në heshtje: "Ti e nise këtë punë gjyqi, mos më the kërthija tash".

"Për vrasjen e kujt e akuzoni?"

"T'ia ngjesim dikë. Me siguri ka vrarë shumë pushka e saj?"

Gjykatësi: "Duhet të thoni me emër e mbiemër, kohën kur ka kryer krimin, motivin përse e ka bërë këtë...".

Prokurori edhe një herë u bë pishman që ia nisi gjithë këtij logu burrash ku i dukej se i kishin përzier rolet. E ku ta dinte ai kë ka vrarë kjo luftëtare e ideve të mbrapshta.

"Hë moj e pa fe, fol, kë ke vrarë!?".

Parizania u përgjigj me një shpërfillje të çuditshme para "gjyqit të armikut": "Pyetne pushkën time kë ka vrarë! S'kam si i jap llogari këtij gjyqi!".

Prokurori u mat t'i mëshojë një shuplakë partizanes, por u kujtua se përsëri do t'i bënte vërejtje Gjykatësi dhe shpejt e shpejt e tërhoqi dorën. Kërkoi që të ndërpritet gjykimi për të bërë hetime, pasi e pa që i mungonin shumë fakte për ta akuzuar përnjëmend. Por këtu ndërhyri Mbrojtësi.

"Mendoj se klientja ime është e pafajshme pasi nuk ka fakte dhe dëshmitarë nga të pranishmit që do të vërtetonin të kundërtën", foli Xhemshit Krosi-Mbrojtësi, i cili e habiti "publikun" me fjalën "kliente" që pak kush e kuptoi se ç'donte të thoshte, por edhe ai s'e kishte aq të qartë, përveç se aty për aty iu kujtua ta kishte lexuar në ndonjë gazetë avoketët t'i quajnë ashtu ata që i mbronin.

Gjykatësi megjithatë ndërpreu gjykimin, duke i sugjeruar Prokurorit që të përgatiste akuzën konkretisht.

Arif Kapetani-Prokurori, në mbrëmje e vizitoi partizanen në "qeli". I tha se më miri për të do të ishte të tregonte vetë bëmat e saj. Që të mos e detyrojnë! Por, gjëja e fundit që i shkonte ndërmend në këto rrethana ishte që t'ia vënë dajakun një femre të humbur ndër gjithë këta burra. Çfarë burrërie do të ishte kjo, ndonëse ndonjë shuplakë e meritonte t'ia ngjeshte. Ndonjëherë edhe burri gruas së vet ia ngjesh t'i tregojë kush është zot shtëpie! E pyeti me të butë nëse donte ajo vetë të tregonte. Nga cilat fshatra kishte kaluar me partizanët e saj. A kishin plaçkitur nëpër ara ose ahura gjënë e shtëpisë, a kishin vrarë dikë të paarmatosur...Po, po, e gjeti, ajo duhej të tregonte në kishte vrarë ndonjë pa armë në dorë. Ose ndonjë tjetër që ta ketë vrarë pasi të jetë dorëzuar. E pyeti t'i tregonte dhe për dëshmorin e çetës së tyre, Daut Kodran. Si u vra ai? A mos ajo e ka vrarë pasi e kanë gjetur të plagosur pas asaj batareje kur ballistët u tërhoqën nga matanë bregut, kur Daut Kodran s'patën mundësi ta tërhiqnin nën atë breshëri plumbash që vinin, o zot, nuk e dinin nga vinin, nga lulet e bostanit, nga kallinjtë e kollomboçit, nga lapat e duhanit, nga drunjtë e malit...Ç'i bënë, ia mjekuan plagët Dautit, apo i dhanë plumb në kokë? Vallë kishte edhe ajo gisht në këtë vrasje? Por, ajo iu përgjigj: ashtu e paska pasë emrin ai i çarturi juaj që hyri në shtab dhe vrau komisarin dhe disa luftëtarë tanë? A ka merituar të jetojë pastaj ai? Me duart e mia do ta

kisha gulfatur t'më kishte rënë në dorë, me thonjë do t'ia nxirrja shpirtin! Po për fatin e tij pyetni tjetërkë, pyetni ku e keni lënë dhe si e keni lënë? Sa luftëtarë mund të humbisni në luftë, kush ju ka fajin!

Arif Kapetani e pyeti partizanen edhe për një bari që e kishin gjetur të vdekur në malin ku kishte vepruar aradha e kësaj partizaneje kokëfortë. I tha se dyshojnë se kjo vrasje është një krim i rëndë që kanë mundur ta bëjnë vetëm partizanët e saj, se bariu as një mizë trolli nuk ka shkelë, se lufta nuk i ka interesuar, se madje as e di se për çka luftohet dhe midis kujt.

Prokurori nuk ishte i sigurt që ka ndonjë gjë me çka të vazhdohet gjykim. I dukej se kjo lufta ishte një fushë e gjerë ku mund të bësh çka të duhet, të vrasish ose të të vrasin dhe të mos përgjigjet askush. I shkrepi në mendje t'ia lënë partizanes duart zgjidhur dhe ta lënë të provonte të ikte dhe ashtu duke ikur, t'i jepnin plumbin. Kështu do ta merrte dënimin e merituar.

Të nesërmen kur u mblodh përsëri gjyqi, Arif Kapetani mbajti një fjalim të shkurtër ku përmendi involvimin e mundshëm të partizanes në vrasjen e Daut Logrit, pastaj në atë të bariut të fshatit Harnaqi, që me dhen kishte humbur përtej vijave të frontit midis partizanëve dhe ballistëve dhe pastaj e

kishin gjetur të vdekur. Në fjalën e tij përmendi dhe çështjen e besimit, se ajo dhe ata si ajo, kanë përqafuar një besim të djallit, se ai besimi i moskovit që mohon Zotin, do të sjellë vetëm fatkeqësi, madje më shumë se vetë plumbat e tyre, se ata vrajnë shpirtin e njeriut, dhe nëse për asgjë tjetër, për këtë meriton të vdesë jobesimtarja.

Prokurori thërriti dhe dëshmitar Naipin e Sulës, vëlla i Daut Logrit, por ai e kishte kuptuar se s'kishte si ta akuzojë për vrasjen e vëllaut, sepse nuk e kishte parë me sytë e vet, e as që dikush e kishte përmendur. Ai madje bëri diçka tjetër, i tha se të vetmen gjë që don të dijë është ku e ka varrin vëllai i tij.

Por partizania me përgjigjet e saj, ose me heshtjen e kohëpaskohëshme, i hidhte kodër më kodër.

Gjykatësi Sejda i Bukoviqit në fund ia dha fjalën mbrojtësit, Xhemshitit të Krosëve. "Unë nuk kam çka të them. Nga ç'u tha gjatë gjykimit, nuk doli asnjë provë për ndonjë faj të klientes sime, Sofia Strugar. Për gjërat që është kompetent ky gjyq, pra, për faj ndaj njerëzve, kërkoj që të lirohet nga akuzat, ndërkaq për gjërat që s'janë në kompetencat e këtij gjyqi, ajo që u përmend mosbindja e saj ndaj zotit, nuk janë njerëzit që të gjykojnë, por i takon të Madhit Zot, Allahut, Zotit të tokës dhe qiellit, që të përcaktojë fajin dhe dënimin për çdokë.

Kërceu nga vendi Prokurori, deshi të kundërshtojë mbrojtësin, por u frenua dhe tha me vete se si ky gjykim që prej fillimi kishte hyrë në qorsokak, saqë të gjithë ata që donin ta vrisnin partizanen që kishte luftuar gjithë kohën kundër aradhës së tyre, të dëshironin lirinë e saj. Madje dhe medresanti Xhemshit Krosi që ia dhanë rolin e mbrojtësit, sikur e kishte kuptuar rolin e tij me seriozitet të tepruar.

Mbeti fjala e Gjykatësit. Ai nuk e zgjati shumë. Tha se ky gjykim ishte provë për një pushtet dhe shtet të mirëfilltë, se e mati fajësinë dhe pafajësinë e të dyshuarës dhe se erdhi në përfundim se në mungesë të provave, partizania shpallet e pafajshme dhe me këtë fiton lirinë e saj.

Komandanti i aradhës, Arif Kapetani, caktoi Zirapin e Ramës, Naipin e Logrive dhe Ruxhën e Alisë që ta nxjerrin partizanën matanë lumit, në territorin e kontrolluar nga partizanët e saj. Armën e saj, një "shmajzer" gjermani, e mbajtën si trofe lufte.

...

Lufta kishte vazhduar gjer nga fundi i '44-ës, ndërkaq një vit më vonë, pushteti popullor tashmë ishte konsoliduar aq, sa të fillonte t'i ndjekë të gjithë ata që kishin luftuar katër vjet kundër çetave partizane. Një nga shkaqet pse ishin ndjekur shumë ish-ballistë, përkundër marrëveshjes për çmobilizim paqesor (shumëkush qysh atëherë kur u ishte ofruar kjo, kishin thënë të mos i dorëzojnë

armët se nuk i besohet komunistit), kishte qenë se partizania që e kishin liruar, ishte gjetur e vdekur matanë lumit! Askush nuk mund të kuptonte si kishte ndodhur kjo, duke e ditur se ata e kishin liruar. Zirapi i Ramës nga Bojana, i cili me të dëgjuar për fatin tragjik, e dinte se do ta kërkonin për ta gjykuar dhe doli përsëri në mal, kur të gjithë ishin kthyer nëpër shtëpi. Por u lodh duke ikur nga një fshat në tjetër dhe që të mos u bëjë sherr atyre që e strehonin, një ditë vetë u dorëzua. Ia kërkuan shmajzerin e partizanes. U tha se shmajzerin e kishte si trofe lufte por jo se ishte ai që e kishte vrarë.

E dënuan me burg të përjetshëm, porse nuk e pati gjatë në burg, pasi një ditë i erdhi lajmi se ia kishin vrarë të birin. E dinte se këtë ia kishin bërë ca hasmërinj të vjetër, që ishin afruar shumë me pushtetin e ri. Vdiq prej së keqi që s'mund të dilte për të marrë hak.

Pushteti e kishte dënuar me burg edhe Hafës Hasanin, të cilit ia kishin hedhur fajin që paska dhënë urdhër për vrasjen e saj, si pushtet që kishte pasur atëherë. Pas disa vjetësh e lëshojnë në liri, porse përsëri ishte bërë i dyshimtë si armik i popullit, dhe një shok i tij maqedonas, i cili asnjëherë nuk kishte dyshuar se ai mund të ishte fajtor për vrasjen e partizanes, e kishte njoftuar se po i përgatitej sërish arrestimi, dhe Hafës Hasani brenda natës i mbledh plaçkat dhe ikë për Turqi, prej nga pushteti asnjëherë nuk kërkoi ekstradim.

Ndoshta ngase i duhej atje, si shembull në vitet pastaj, se ku është vendi i muslimanit kur u bë shpërngulja masive e shqiptarëve dhe muslimanëve nga pushteti komunist.

Sejdën e Bukoviqit e dënuan me 17 vjet burg, prej të cilave i vuajti tetë. Në zyrën e tij të avokaturës në Çarshinë e Vjetër në Shkup, shpesh e vizitonin civilë, për të cilët ai dyshonte se janë sigurimsa.

Arif Kapetanin nuk arritën ta zënë pasi kishte kaluar kufirin me të dëgjuar se kërkohej. U kthye në vendlindje pas rënies së komunizmit i sigurt se askujt nuk i hyn më në punë fakti që kishte qenë në luftë në anën "e gabuar".

Pushteti kishte futur në burg dhjetëra burra tek të cilët kishin gjetur shmajzer, ndër ta kishte që u vranë në Monopolin e Tetovës pa gjyq.

Askush gjatë gjykimit, e as më vonë, nuk pranoi fajësinë.

RRËFIMI PËR TREGIMIN

Atë pasdite i cingëroi telefoni sekretarit të partisë të komunës. Matanë dëgjohej zëri i njohur I Hysni Shyqriut, redaktorit të redaksisë shqipe në TV e Shkupit. Nuk i kishte ndodhur më parë që ta shqetësonte me ndonjë thirrje telefonike gjatë të shtuneve e aq më pak të dielave, nëse nuk do të kishte ndonjë arsye urgjente. Hysniu ishte një kuadër i devotshëm i partisë, njeri me frymë të gjerë internacionaliste dhe i mbathur mirë nga pikëpamja ideologjike. Ishte nga ato kuadro që përfliteshin si luftarë të sinqertë të kauzës komuniste. Ishte e çuditshme që përkundër këtyre bindjeve, si bashkëluftëtarë të radhëve të para të partisë, sidomos kohëve të fundit kur ishin shtuar veprimtaritë armiqësore anekënd vendit, asnjëherë nuk ishin bërë miq familjeje.

-A ke lexuar sot gazetat?!-e pyeti Tosum Pahallin

-Si jo, i kam lexuar. Ka diçka që nuk e kam vërejtur? Sa pashë, të gjitha ishin në vijë.

-Shoku Tosum, nuk vërejtët ndonjë gjë që do t'ju bënte përshtypje?

-Të them të drejtën, nuk kam parë ndonjë gjë të tillë. Shihet se gazetat u kushtojnë rëndësi të veçantë ngjarjeve që e preokupojnë vendin.

-Më falni, shoku Tosum, nuk dua t'ua prishë rehatinë gjatë fundjavës, por pa ju thënë ndonjë gjë konkrete, vetëm ju kisha sugjeruar ta lexoni faqe për faqe gazetën "Flaka e vëllazërimit". Kam përshtypje se në këtë redaksi, kohë pas kohe na ndodh diçka që na ikë kontrollit. Kam frikën se mund të ketë ndodhur diçka e tillë kësaj radhe. Mendoj se është mirë të lexoni dhe ju dhe si të shihni e analizoni se ç'ka në të, do të kishte qenë pozitive që reagimi të ndodhte prej nesh se sa çështja të shkojë drejtpërdrejt lartë, në Komitet Qëndror. Besoj se jeni dakord!

Shoku Tosum Pahalli, i cili me vigjilencën e tij të lartë kishte denoncuar sa e sa elemente të dyshimtë në radhët e partisë, sidomos ndër mësuesit e shkollave të Dërvenit, iu thanë buzët dhe goja. E mundonte diabeti kaherë dhe tash ndjeu se përnjëherë i kërceu Shyqri në 18 nga vetë fakti se mund t'i ketë shpëtuar ndonjë gjë që ai patjetër ishte dashur ta vërejë. Vetë thirrja e shokut Hysni Shyqriu ishte një sinjal serioz, madje dhe një kërcënim i tërthortë, ngaqë nuk e kishte vërejtur me kohë atë që ai do ta kishte vërejtur dhe nesër mund

ta shtrojë në organet partiake të Qytetit, madje dhe më lartë, mungesën e syçeltësisë.

E kërkoi gazetën "Flaka e vëllazërimit" që e kishte lënë mënjanë pas një leximi jo aq të vëmendshëm. Nisi ta shfletojë faqe për faqe, tekst për tekst, madje lexoi edhe nekrologët se mos ndoshta gazeta kishte botuar nekrolog për ndonjë armik të popullit. I erdhi çudi që edhe pas shfletimit më të vëmendshëm nuk arriti të zbulojë ndonjë gjë "për t'i bërë përshtypje". E kafshoi buzën. Ç'është ajo që shokut Hysni i ka bërë përshtypje? Mos vallë syçeltësia e tij është më e madhe? Pastaj e çoi dyshimin te redaksia e "Flakës së vëllazërimit" me të cilin viteve të fundit jo pak herë kishin pasur probleme. Në këtë redaksi sikur duhej vazhdimisht të "ysteshin" për të trajtuar problemet, sidomos prej demonstratave të Kosovës e këtej. Ishin mbledhur aty shumë shkrimtarë e gazetarë, të cilëve, ndonëse me libreza partiake, vazhdimisht duhej t'ua përkujtoje detyrat që dilnin nga KQ i Partisë. Mungesa e vetiniciativës për të shprehur vigjilencën ndaj vijës së Partisë ishte një problem që shpesh përflitej në forumet partiake. Ata nuk janë komunistë të vërtetë, atje librezat partiake u shërbejnë vetëm për të përparuar në detyrë, se kur duhet që të dëshmohen në vepër,

gjejnë një mijë arsye për t'iu ikur detyrave. Kështu mendonte edhe shoku Tosum. Partia nuk i kishte lënë asgjë rastësisë, prandaj në "Flakë" kishte dërguar edhe shokë të devotshëm që do t'i "koordinonin" punët sipas direktivave, por pikërisht këtu kishte ndodhur një situatë problematike në numrin festiv të gazetës me rastin e Ditëlindjes së Prijësit. Siç kishin bërë me vite, në numrin e gazetës që i kushtohej 25 majit, gazeta botonte një shkrim të redaksisë përplot dashuri e adhurim. Para dhjetë vjetësh, kur shoku Tito kishte kremtuar ditëlindjen e tij të fundit në këmbë, se vitin e ardhshëm ra në shtrat dhe nuk e priti ditëlindjen e 88-të, njeriu i partisë e kishte marrë mbi vete ta shkruante atë shkrim. Kush do të shkruante një shkrim përplot elozhe më mirë se vetë ai, prandaj këtë detyrë nuk ia kishte dhënë ndonjë gazetari por ia kishte dhënë vetes. Fundja, edhe ai duhej të dëshmonte që ishte njeri i penës, jo vetëm i diskutimeve të zjarrta. Mbase do të kishte fituar edhe ndonjë pikë para udhëheqësve më të lartë. Kështu, shoku Nysret Elhami, e kishte shkruar shkrimin siç kishte ditur më bukur. Duke ndenjur me gazetarë, por dhe duke i lexuar shkrimet e tyre si redaktor, kishte mësuar shumë shprehje të bukura dhe ia kishte dalë që ta

shkruante asisoj sa të krenohet me vetëveten. I kishte menduar edhe komplimentet që do t'i merrte nga shokët e partisë kur ta lexonin të nesërmen. E shkroi, e qëndisi dhe zbukuroi çdo fjali, për t'i vënë kapakun me atë që shpesh e bënin komentuesit më të denjë në vijën e partisë dhe të Prijësit: "Të duam sa malet shoku Tito!". Por, ai nuk kishte pandehur se do të ketë bërë një "lapsus lingua" apo "lapsus kalami" gjersa e kishte shkruar dhe se pikërisht do t'i lajmëroheshin nga forumet e partisë.

"Ç'budalla ore ky Shoku ynë atje!" kishte thënë shoku Tosum sa e kishte lexuar tekstin e Nysret Elhamit.

Iu lajmërua autorit dhe e gjeti të papërgatitur. "Tekstin e ke të shkëlqyer, por përfundimin e ke të paqëlluar!" - i tha shokut Nysret, i cili nga Komiteti i partisë në Tetovë ishte dërguar në "Flakë" për të kujdestaruar në vijën ideopolitike të gazetës.

"Ama, shoku Tosum, e dini, kjo është një nga ato dëshira që popujt tanë ia shprehin shokut Tito për çdo vit në ditëlindjen e tij!"

-Shih, shoku Nysret, çështja është një lapsus dhe të mos ishe në pyetje ti, një kuadër i devotshëm, një aktivist i sinqertë, shokët nga lartë do të kishin dyshuar se këtu ka ndonjë prapavijë!"

-Nuk ju kuptoj, shoku Tosum, po unë, e dini me sa kujdes i kam mbledhur këto shprehje, madje kjo, që ju thoni, ne përherë i kemi shprehur adhurimin nga zemra shokut Tito, prandaj janë nga ato shprehje universale...

-Po, po, por, ja, ta lexojmë përsëri fundin! E ke gazetën pranë, lexoje edhe një herë!

-Ja, këtu e kam mbi tavolinë. Dhe si thoni ju, ja dhe përfundimi i tekstit "Të duam sa malet shoku Tito!"

-Lexoje edhe një herë!

-"Të duam sa malet shoku Tito!"...çfarë ka këtu të paqartë!

-E di përcaktimin tënd të drejtë shoku Nysret...e shoh që edhe një qind herë ta lexosh nuk do ta vëresh, sepse me zemër e ke shkruar, ndërsa dora ka shkarë padashtas...Si thua pra, cili është urimi: "TË DUAM sa malet" (e theksoi në mënyrë të veçantë) apo "RROFSH sa malet"(përsëri e theksoi)!

-Uh, vërtetë... – u ndje ofshama habitëse dhe keqardhëse matanë telefonit e shokut Nysret - si nuk e paskam vërejtur këtë lapsus!

Shyqir qe nuk ndodhi afër t'ia shihte djersët qe i dolën si avull nga koka e tij qe u skuq beftas.

-E di, e di, askush nuk do ta zë për të keq, vetëmse t'u lajmërova që të jesh përherë syçelë, se ndonjë armik brenda jush mund të të shkruajë diçka tjetër. Gjithë partia e di se ke dashur prijësit tonë t'i shprehësh dëshirën që të jetojë se malet, e jo se e duam sa malet. Dihet si e duam, si birin më të madh të kombeve e kombësive tona të vëllazëruara, e jo sa malet...

Sadoqë kishte qenë shoqërore, vërejtja që ia kishte bërë, shoku Tosum nuk e dinte se kjo shokun Nysret nuk e kishte lënë rehat me ditë e javë, nga frika se kësaj pune mos po i del tymi dikah tjetër. Kur një ditë ishin takuar në një manifestim, kur Nysret Elhami e pyeti se mos ka ndonjë vërejtje për tekstin e tij në forumet e larta, ai i kishte thënë se askush nga udhëheqësit partiakë nuk ka bërë ndonjë vërejtje, por dhe se nuk ka vend për vërejtje kur shihet nga hëna qëllimi i sinqertë i autorit.

Por, tash shoku Tosum u gjet paksa i papërgatitur, pikerisht si shoku Nysret me atë urimin e famshëm. Mos vallë edhe atij i është topitur tehu i syçeltësisë? A mos vallë ka nisur të mplaket e nuk po e vëren? A mos vallë është rezultat i një ndjenje të qenurit jetim qëkurse u nda nga jeta para dhjetë vjetësh Prijësi? Nuk donte ta thoshte këtë me zë e as ta ndante me dikë, porse

shpesh mendonte se ata që e trashëguan, nuk janë të denjë që ta vazhdojnë vijën e tij. Madje ç'është kjo që gjithnjë e më tepër po kërkojnë më shumë demokraci dhe liri të shprehjes? Vallë, Partia deri tash i paska ngulfatur? Kur shoku Hysni Shyqriu i tha të shfletojë "Flakën" mbasi ai tashmë e kishte lexuar dhe nuk kishte parë gjë karakteristike, i shkoi mendja te kjo çështja e lirisë së shprehjes, që ngaherë me disa redaktorë dhe gazetarë të kësaj gazete ishte gjetur në zgripc kur dikush do t'i thoshte: "Po dhe partia kërkon kështu...edhe partia kërkon debat dhe konfrontim mendimesh!"

Si të ndaheshin këto punë tash? Në njërën anë, është vija e partisë, ajo është e drejtë, e pandryshuar, ndërsa në anën tjetër, debati, mendimi ndryshe! Si ta dallosh mendimin ndryshe kur është e kur nuk është në vijë!? Ky na qenka mendim ndryshe, në KQ u bënë horr duke sharë njëri - tjetrin! Do të kishte këso debatesh të ishte gjallë Prijësi? Dokrra! Tash po vjen koha që jo një, po të ketë më shumë vija. Mjerim! Kjo e bënte shokun Tosum që çdo mbledhje ta priste me siklet të veçantë, sepse kishte frikë se do të ketë shumë vija dhe nuk do të dinte cilën ta mbështeste. Më parë, një shenjë me kokë nga udheheqësi i mbledhjes, mjaftonte që të hetoje nga fryn era. Tash

u bë lesh e lijë, askush nuk din. Ai nuk mendonte se shumëzërësia ka sjellë cilësi në Parti. Shumë zëra përnjëherë, pazar grashë! Prej se u promovua në parti e drejta e mendimit, edhe pse ai nuk pajtohej se kjo u shpik tash, ai parandjenjte se gjërat do të shkonin në drejtim të gabuar.

Dhe kjo "Flaka..." si një kasnec i "kohës së re" dukej se po i rrëshqiste partisë nga duart. Ishin paraqitur ca gazetarë të rinj, por dhe ata të vjetrit sikur e hiqnin lëkurën e qengjit që kishin nisur të krekoseshin me shkrimet e tyre, sikur po e tepronin me zëra kritikë. Vallë kishte kush t'i frenojë pak e t'u tregojë se gjithçka ka kufi?

"Më ngadalë, partia është për mendim të lirë, siç ka qenë kurdoherë, po ama thuaju këtyre tuajve se "Flaka" nuk është gazetë studentore...", i kishte thënë një ditë shoku Tosum kryeredaktorit të gazetës, duke u munduar të lë përshtypjen se kjo është më tepër këshillë se sa direktivë. "E kemi parasysh këtë, mbajmë llogari për masën e kritikës, gjithnjë ndjekim vijën e partisë, por e dijmë edhe vijën e kuqe..." ishte përgjigjur kryeredaktori, i cili kishte përvojë të mjaftueshme me "këshillat" dhe "direktivat" nga shumë sprova të maparshme.

Mbeti duke gjurmuar mbi gazetë, e ndjente veten i humbur si rosat në mjegull. Jo, edhe më keq,

i ngjante si atë ditë me mjegull kur në malin e Karaxhicës kishin shkuar me shokët e komitetit për gjueti dhe kur kishte humbur, me orë kishte kërkuar rrugën. Ai kishte shkuar si gjithë shokët për gjah, ndërkaq kur ishte ndarë prej tyre papritmas, i ngjante vetja si delja që ndahet nga kopeja dhe e han ujku! Obobo, ç'ndjenjë e mjerueshme kishte qenë ajo. Ne për gjah të derrave të egër, dhive të egra apo drerëve, e ç'jam unë tash në këtë mjegull, vetëm brirët dhe bishti më mungojnë. Më mungon vetëm të dal para qiftes së sekretarit të partisë dhe të bëjë "bam"!...Uh, larg qoftë, ofshani mbi gazetë. E ndjeu veten njësoj të humbur si në atë gjueti, ku me shokët ishte gjetur vetëm pasi të gjithë dalëngadalë kishin hypur në Majën e Selanikut kur ishte larguar mjegulla. Krahasimi i shkonte tjetërkah: nëse atëherë kishte kaluar pa dalë para qyftes ndonjërit nga shokët e komitetit, tash mund të pasonte pjesa e dytë e "të humburit në mjegull". Sepse, nëse në këtë numër të "Flakës" ka diçka subverzive e që ky s'e kish vërejtur, nesër jo vetëm që do të plaste turpi për mungesë syçeltësie, por dhe do të plaste një "bam" i madh, jo një kritikë shoqërore, jo një vërejtje për parapërjashtim, por ndoshta dhe përjashtim nga partia dhe masa të tjera! Emri i tij do të hynte në

analet e përplasjeve partiake dhe spastrimeve ideologjike, por tash i radhitur në anën e gabuar!

Vendosi ta ndërprejë këtë paqartësi rreth këtij numri të "Flakës së vëllazërimit". Vendosi ta kërkojë kryeredaktorin, por e shoqja e tij i tha se ai nuk është në shtëpi dhe se ka vajtur në një promovim libri në Strugë. Dreq o punë, si do të bënte gjer të hënën. Pastaj, ishte çështja më delikate seç dukej në shikim të parë. Çka edhe sikur ta gjente! Çka t'i thoshte! T'i thoshte se ka nevojë për t'ia përkthyer tekstet e "Flakës" që ishin në gjuhën shqipe! T'i thoshte se kërkon diçka midis rreshtash që dikush tjetër ia ka sinjalizuar se ka "diçka"! Por, jo, tha me vete, do të shkoj te shoku Hysni Shyqriu e t'i them troç: Aman se më plase, më thuaj ç'paska aq për t'u analizuar në "Flakë"?

Të hënën, që në ora tetë ishte në Televizion. Hysni Shyqriu u habit kur erdhi kah ora 8.30 që e gjeti shokun Tosun Pahalli te sekretaresha e tij duke e pritur. Shikimi habitës e pak qesëndisës sikur Tosumit ia shtoi edhe më shumë sekëlldinë, sepse iu duk sikur donte t'i thoshte "Hë, të djeg kah këmbët! S'të ze vendi vend!?".

"Më paski pritur, shoku Tosum, ejani të pimë një kafe e të kuvendojmë", e ftoi në zyrën e tij shoku Hysni. Prapë Tosumit iu dukën fjalët me

bisht, sepse mungonte vetëm t'i thoshte "e dija se do të vije, kur të mungon syçeltësia, të nevojitet ndihma e shokut të partisë".

Tosum Pahalli kishte ardhur pak si "pa teklif", siç thotë populli, sepse ky kishte qenë ai që i kishte dhënë një shtysë vendimtare karrierës së Hysni Shyqriut dhe ky duhej ta ndjente veten borxhli ndaj tij. Kur KQ-ja kishte detektuar problemin e nacionalizmit në radhët e gazetarëve të redaksisë shqipe të Televizionit të Shkupit, pikërisht shoku Tosum e kishte njohur luftëtarin e pakompromis në personalitetin e tij dhe e kishte propozuar para shokëve të partisë dhe nuk kishte gabuar. Shumë herë udhëheqësit më të lartë e kishin lëvduar për këtë zgjidhje kadrovike, sepse shumë shpejt u tejkaluan problemet në redaksi. Me të shkuar atje, ai i ndërroi të gjithë redaktorët që kishin ndonjë njollë biografike, disa i suspendoi nga puna, ndërkaq i pranoi toponimet sllave të qyteteve që kërkonte Komiteti i Arsimit dhe Nejaz Limoni që disa herë vetë kishte ndërruar mbiemrin, saqë askush nuk e dinte ç'vetëdije kishte për përkatësinë dhe përse aq shumë urrejtje villte në çdo dalje në televizion ose gazeta! Shoku Hysni rrinte shpesh me shokun Limoni dhe flitej se dhe duke pirë, mbi

tavolinë, bënin strategjinë e veprimit kundër kuadrove të dyshimta.

"Shoku Hysni, biseda telefonike që patëm më shtyri të mendoj, po ama, ndoshta është punë vitesh, ndoshta dhe sklerozë, por, të më vrasësh, nuk gjeta gjë të dyshimtë në "Flakë"!

"Ke lexuar rubrikën e kulturës?"-ishte përgjigja shumë e shpejtë.

"Ja ku e kam gazetën. Edhe rubrikën e kulturës e kam kaluar, por as aty nuk gjeta gjë!

"Në kurse partiake ke qenë, apo jo!"

"Po, jo një herë, por i kam kaluar që të gjitha kurset e mundshme partiake, që prej këtu, në Beograd e gjer në Kumrovc..."-iu përgjigj shoku Tosum, por pasi u ndal pak, deshi ta pyeste shokun e partisë diçka. Ah, ky farë Shyqri shpesh ia humbte rrjedhën e mendimeve, ndonëse në këtë moment nuk ishte kjo arsyeja që u ndal. U ndal që t'i tregojë se me këtë pyetje sikur don ta fyejë, don ta sprovojë përcaktimin e tij. "Ku e pate fjalën me kurset partiake!?"

"Aty, pra, dua të dal...Çka na mësonin në kurset partiake!?"

"Shumëçka na mësonin, por tash nuk është vendi e momenti që me një fjali të thjeshtë ta rrumbullakojmë një kurs që zgjaste me muaj...".

"Me një fjalë, dua të dal aty, se përherë Partia na ka mësuar se uji fle, e armiku, pra, qoftë i jashtëm, qoftë i brendshëm, nuk fle...Për mua, kjo ka qenë dhe ka mbetur beteja kryesore e revolucionit. E ke parasysh, armiku nuk guxon të na zejë në gjumë. E në numrin e fundjavës në "Flakë", armiku si duket i ka zënë të dremitur ata shokët e redaksisë që duhet t'i kenë sytë çelë edhe kur flejnë".

"Obobo, ç'punë serioze do të na dalë...Më duhet të jem autokritik, se dhe mua do të më kenë zënë në gjumë, qyshse nuk kam mundur të vërej gjë të dyshimtë!", mendoi.

"Eh, shoku Tosum, ndonjëherë armikun e kemi fare pranë, po s'e shohim. Ai ndonjëherë flet si ne, me ne pin e han, e s'e njohim! Prandaj duhet t'i hapim sytë"!

Tosum Pahalli fshiu djersët e ftohta. Kishte ndonjëherë djersë të këtilla, sepse atij në këtë moshë i ishin mbledhur shumë gjëra. Por këto djersë s'kishin lidhje me lëngatat e tij të moshës e të stinëve. Ishin ethe sikleti që para hunde i kishte ikur diçka për të cilën gjë shoku Shyqriu ishte treguar më syçelë.

"A lexon letërsi shoku Tosum!?"

Uh, edhe një thikë në "të holla" nga shoku i partisë! Nisi të ndjejë një pendesë që pikërisht Hysni Shyqriun e kishte përkrahur si kuadër premtues. E tash ky, i flet me shumë temsile mentorit të tij.

"E kam pa të keq, shoku Tosum. Armiqtë klasorë futen kahmos. Edhe në radhët tona. E të mos flasim se historia e klasës punëtore dhe idologjisë komuniste është përplot armiq që na paraqiten me penë në dorë! Nuk janë armiq vetëm ata që mbajnë armët për të bërë kontrarevolucione. Që duan ta përmbysin pushtetin e partisë dhe vëllazërim-bashkimin e popujve tonë...."

"Don të thuash, më të rrezikshëm janë ata me penë...Ja, kjo është e vërteta!".

Gjersa po bisedonin, kryeredaktori e thërriti me telefon sekretareshën për të porositur kafe.

"Për mua kafe të hidhur dhe ujë me gaz", tha shoku Tosum. Ndonëse për shkak të diabetit ai i ikte kafes me sheqer, me tonin se si e bëri porosinë, kishte një si dozë vreri, sikur të thoshte "Më sill pelin, se për pelin e kam bërë punën!".

Pasi doli sekretaresha, Hysni Shyqriu vazhdoi ku e kishte lënë muhabetin. "E din historinë e përplasjeve të partisë me elementet rrënuese të sistemit? Cilët kanë qenë kryesisht armiqtë e partisë

këto dekada?! Njerëzit me laps, shoku Tosum! Njerëzit që një flasin, e tjetër punojnë, njerëz që kur shkruajnë nuk mund t'i kuptosh çka kanë dashur të thonë, njerëz - urithë, që natën e bëjnë ditë, duke punuar për të rrënuar këtë sistem, prej poshtë, prej nën tokë".

Tosum Pahallit një çehre i shkonte, tjetër i vinte. Me avuj të padukshëm djersësh sikur të dyshuarin për vepër më të rëndë të cilin e pret dënimi i merituar. Duket se fundi i kësaj meseleje do të dilte te zënia e tij në gjumë. Por si, kur që prej bisedës telefonike, ai tashmë "ishte zgjuar", por përsëri nuk kishte parë atë që me gjasë e kishte vërejtur shoku Hysni! Gjithsesi, shenjë e keqe për të, këtë të rinjtë si Hysniu e kanë shikimin më të mprehtë, ndërkaq kuadrot si ai vetë, tashmë mund të quheshin dhe të vjetër, sepse ka nisë t'u topiten shqisat! Sa i janë topitur "shqisat" duhej pyetur Gojëlulja, sekretaresha e tij, me të cilën nga ndonjëherë iknin nëpër "udhëtim zyrtar" në ndonjë nga hotelet e fshehura prapa gjetheve malore ku pak kush mund ta njihte.

"Asnjëherë nuk i kam admiruar ata të "Flakës". Saherë që kam pirë kafe me ta, kurdo që t'i kem shikuar në sy, më janë dukur të dyshimtë. Eh, sa e panë që po fryjnë erëra të tjera, urraaa, ta rrëzojmë

sistemin!", mendoi në vete. Dreq o punë, si nuk mund të gjente një element dyshues për çka e bën gjithë këtë muhabet rretherrotull shoku Hysni.

"E ANKTHI?"-pyeti beftas Hysniu.

Uh, edhe një herë seç ndjeu një duhmë sikleti prej brenda. Ka filluar të flasë me "shifra" konspiracioni, kujtoi ai. Pastaj, nga e di ky ore se shpesh e kapë ankthi në gjumë! Kujtoi mos ndoshta partia ka nisë të dyshojë dhe tash i kanë vënë përgjues dhe në dhomën e gjumit! Gjer atje të kenë shkarë gjërat, e ky i painformuar!

"Gjithë ne kemi ankthe, do të thosha. Di ndonjëherë të më kapë, ashtu, natën, sikur më gulfat, më shkund dhe më zgjon në djersë. Më kanë thënë se mund të ketë lidhje me diabetin. Ti e di, ka qe sa vite, nga këto beteja ideologjike me mësuesit e Dërvenit, mora dhe Shyqrin! E di, më së shumti telashe patën me atë monografinë e shkollës "Drita" të Rashçes. Me Abedinin dhe Brahimin, vëllezërit Krosi, të cilët duke shkruar për 40 vjetorin e shkollës, ç'nuk kishin futur në të, që nga ilirët e gjer te vetë ata. Ç'na i kishin përzier tumat e katundit me përparimin që solli partia komuniste, do të kishte shkolla. Po, po, shihej qartë aty në monografi një përqasje nacionaliste që ishte kundër vëllazërim-bashkimit. E din sa perfidë na dolën

këta. Anëtar të këshillit redaktues ata kishin futur edhe arsimtarin maqedonas, Ivan E.-në, nuk di në e kishin mashturar me ndonjë pije, por ai ishte bashkfajtor dhe edhe ky si ata e mbronte librin, nuk pranonte se ka përmbajtje nacionaliste. Më duket se atë e kishin pasur si mburojë, me lidhje "lartë" dhe nuk arritëm t'i përjashtojmë prej pune. Abedini kishte shkuar te një historian maqedonas, si njeri i shkencës, Novica S., dhe i kishte thënë troç: Ku konkretisht partia sheh nacionalizëm në këtë monografi. Ai i ishte përgjigjur se shokët nga lartë, veçmas shoku Tosum, nuk mund të pranojë se çështja e tumave ilire ka lidhje me shkollën, se këtu ka një dreq prapa, një prapavijë, madje diç që qenka në kundërshtim me tezat e historianëve serbë, të cilët këto tuma nuk duan t'i lidhin aspak me shqiptarët. Po, mirë, i kishte thënë, Abedini, ja të shkojmë në katund, dhe tumat aty janë, nuk i kam shpikur unë...Lere se ç'na dolën arrë e fortë këta Krosët, dhe mezi ia dolën t'i qërojmë hesapet me ta. Abedinin e shkarkuam nga posti i drejtorit dhe e çuam pedagog në Bojanë, kurse Ivanin, i cili asesi nuk pranoi t'i bëjë kritikë monografisë, dhe Brahimin i lamë aty, nën mbikqyrje të fortë që edhe një gabim të vogël ta bëjnë, të fluturojnë prej pune. Me Krosët partia kishte pasë probleme që viteve

shtatëdhjetë, kur e kishin ngritur flamurin shqiptar. Ata kishin ngritur flamurin me të dëgjuar se në Beograd Tita me shokët e Kosovës ishte marrë vesh t'u lejohet shqiptarëve flamuri. Këta, pa një pa dy, e flamurin e venë të valojnë para shkollës. Saherë që shkonte dikush për t'u thënë ta heqin, ata u thoshin. "Tita ka thënë!..." dhe të gjithë zbrapseshin duke u frikësuar se ndoshta këta kanë ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me vetë Titën. Dhe kështu, përderisa në fshatrat tjerë të Shkupit flamurin e kishin lejuar vetëm "për dasma", në Rashçe valonte në çdo festë, si të ishte flamur shtetëror e partiak...

Tosumi fliste si njeriu që ka ndonjë hall që vetëm pak ta prekësh në tel, shpërthen dhe fjalët i dalin vetë. Ai do të vazhdonte kështu, por u ndal, se nuk ishte kjo çështja e ankthit që përmendi shoku Hysni. "Dale, ti s'e pate fjalën te ankthi që na kapë ndonjëherë në gjumë, apo jo? Ku deshe të dalësh?"

"Të ka rënë në sy ndonjë gjë në Flakë e që mban titullin "Ankthi"? Ja, për këtë e kisha fjalën".

U kujtua pak. "Hë, Ankthi, po thua, a?". E nxori "Flakën" e së shtunës dhe nisi t'i bëjë ekspertizë çdo titulli! Ankthi, a, ah, ankthi...Ja, ku i doli te rubrika e kulturës. "Ankthi", tregim i një autori të ri, Dan Logri, emrin e të cilit kohë pas

kohe e kishte hasur me poezi, por dhe skica e reportazhe. I ishte dukur përherë një autor me stil interesant, të lexueshëm, të qartë në dukje, po seç i zgjidhte do tema të rralla, dukej sikur ndonjëherë i mjegullonte gjërat. Bënte shumë pyetje dhe i linte hapur. Sikur donte të çonte ndonjë porosi midis rreshtash. Aman, more ky na paska shkruar edhe prozë, tha me vete.

"Domethënë, e ke fjalën për këtë tregim, ë? Seç më duket se i hodha një sy, por nuk më bëri ndonjë përshtypje. Sa pashë unë, një tregim i errët lufte..."

"Të mos flasim më tutje kuturu, unë kam mendimin tim, por të gjendemi sërish pas orarit të punës, ndërkohë që ti ta lexoje me vëmendje, dhe pastaj të flasim".

Kështu u nda prej Hysniut, porse në vete ndjente hidhësinë e kësaj përvoje të papritur me shokun e partisë. "Hë, "Ankthi", ore si s'ma zuri syri aspak këtë tregim!" tha me vete. Pranoi se e kishte dobësi letërsinë dhe sadoqë ndjente nevojë t'i qasej përherë më seriozisht, si detyrë partiake, përherë mundohej ta eskivojë. Si kuadër i lartë i partisë, doemos duhej të kishte kulturë të përgjithshme dhe kur të ulej në tavolinë me profesorët e Gjimnazit ose madje me ata të Katedrës së Gjuhës Shqipe ose të Akademisë Pedagogjike, të

ndjente veten të barabartë kur të çelej ndonjë temë nga letërsia. Por, nga ana tjetër, përherë kishte frikën se kur të thellohej në veprat letrare, do të përhumbej në mënyrën e leximit: të lexonte letërsinë, apo të zbërthente mendimet e fshehura të shkrimtarëve. Janë një soj njerëzish prej të cilëve përherë kishte pasur problem partia. Dhe tash nga i doli punë me këtë tregimtarin e ri, pak kishte të vjetër, dhe ky i riu! Me shumicën e të vjetërve, partia kishte kryer procesin e dënimit dhe rehabilitimit. Ishin shpallur fajtorë për idetë e tyre të mbrapshta, pastaj kishin vuajtur burgun kush shtatë, kush tetë vjet, kush ndonjë muaj dhe kishin dalë pastaj të tjerë njerëz. Ja ku i ke tash, përsëri shkruajnë, anise partia i ka gjithnjë në shënjestër. Ka shokë të partisë, por kuptohet edhe organet e sigurimit, të cilët përcjellin çdo frymëmarrje të tyre, sepse një gjë është e ditur, ujku e ndërron qimen, por jo dhe hujin. Po, kjo punë e "Ankthit" edhe është që iu shkon të rinjve, se ata janë kokëkrisur, sa e ndjejnë veten, kujtojnë se mund ta ndryshojnë botën, mozomakeq, ta rrëzojnë sistemin.

Iku shoku Tosum te zyra e tij dhe i tha sekretareshës "për askënd nuk jam këtu, përveç Atyre, e di ti!". I tha t'ia bëjë një kafe pa sheqer, dhe e nxori tregimin përpara, sikur t'i thoshte "S'ke ku

t'më ikësh!". Sa bukur, tha me vete, ka gjë poetike këtu t'i thuash "Ankthit": "Tash unë të kam kapur për fyti!". Ankthin, për fyti, he!? E filloi ta lexojë dhe nxori fletoren e shënimeve ku mendonte t'i fusë gjërat që do t'i dukeshin të dyshimta. Gjënë e parë që i vuri pikëpyetje ishte titulli. Pastaj një pikëpyetje ia vuri edhe vetë autorit. Do të duhej të shihet biografia e tij. Dhe mori menjehere telefonin dhe iu lajmerua Leksit në Shërbimin e Sigurimit të Brendshëm, duke i thënë të shohë ç'ka të shkruar në dosjen e Dan Logrit, dhe sidomos të shikojë të kaluarën e familjes.

Ç'ka dashur, ore të thotë me këtë titull, pyeste veten duke shikuar tregimin? Sigurisht se përmbajtja do të dëshmojë nëse ka ndonjë gjë me prapavijë të keqe. Por, leximi në një frymë i tregimit nuk i nxori në pah ndonjë dyshim. Për më tepër, ishte një "tregim partizan". Po, po, pikërisht ashtu. Ishte me tematikë lufte, që fliste pakashumë në mënyrë të mjegulluar për okupimin e një fshati nga ushtria okupatore. Dale, "në mënyrë të mjegulluar"? Mos vallë këtu fshihet lepuri? Tamam, ky flet për okupimin e një fshati nga një ushtri e huaj, ama nuk flet asgjë se për cilën ushtri okupatore e ka fjalen. Për më tepër, edhe emrin e katundit e kishte pagëzuar si Fshati i Shenjtë, që

edhe më shumë të lë gjera të paqarta. Ç'janë këta shkrimtarë, ore, asnjëherë nuk mund t'i kuptosh çka duan të thonë! Por, duke menduar hollë e hollë, tash i dukej edhe një gjë shumë interesante: hajt se nuk e përmend se për cilën ushtri okupatore bëhet fjalë, por as nuk përmend se cila ushtri lufton kundër saj! Çka i pengon të thotë në njërën anë ishin gjermanët, në anën tjetër partizanët. Ose në njërën anë bullgarët, në anën tjetër partizanët. Ose, në njërën anë ishin italianët fashistë, e në anën tjetër partizanët. Po, për njërën anë nuk duhej të kishte dilemë, e për anën tjetër, do të duhej ta përcaktonte, sepse kështu nuk e di se kush me kë po lufton! Edhe ky Fshati i Shenjtë, ku gjendet, në cilën zonë të okupuar është zhvilluar kjo ngjarje. Pastaj ngjarja? A veç natën luftoheshka? Vetëm pas shpine sulmohet armiku? Ç'është ky heroizëm i natës? Ç'është kjo ushtri që s'i del armikut përballë në pikë të ditës? Po lere se, kjo rezistenca që përmend i ngjan një filmi horror, dhe ushtria okupatore nuk ndeshet me kurrëfarë partizanësh, por me hije, me ushtri fantazmash!

Metaforë? Ah, po, metaforë! Shkruan një gjë, e tjetër mendon! Simbole! Përplot simbole e metafora? Ç'janë ore këta shkrimtarët? Nuk dinë t'u thonë troç gjërave po rretherrotull! E dinë ata vetë

ç'kanë dashtë të thonë? Nga gjithë kjo që shkruan në këtë tregim, përfundimi del se kemi një luftë kundër ushtrisë okupuese në një natë të turbull. E pse?

Hajde, de, pse?

Jo, ore jo, ti këtë gjë nuk ia shet Tosumit. Hajt ta tregoj unë tash "luftën"!

Shokut Tosum iu hapën tash horizontet. Kishte ku të kapet. Do ta krihte tregimin fill e për pe, vetëm që shoku Hysni të mos e trumpetonte "lartë" mungesën e syçeltësisë, që nuk e paska zbuluar menjëherë. Kur ia kishin lënë "Flakën e vëllazërimit" si detyrë, ai e kishte kuptuar këtë si komplment. Njësoj si edhe shkollat e Dërvenit. Sepse të merrje për obligim të përcillje ajkën intelektuale, ishte një besim i madh i Partisë ndaj tij. Mirëpo, nuk e dinte as vetë përse ia kishte frikën këtij Hysniut, kishte diçka të frikshme te ai. Atëherë kur ky kuadër ambicioz e kishte marrë përsipër "ta rregullojë" gjendjen në Televizionin shtetëror, sikur Tosumit i kishte marrë një pjesë të terrenit për fushëveprim në betejat me elemente të dyshimta. Kishte frikë se ai mos pretendon t'ia merrte edhe "Flakën" dhe mos del madje dhe në shkollat e fshatrave të Dërvenit, ku ai që nga demonstratat e studentëve të Prishtinës, ishte ngarkuar nga Partia.

Ai vetë kishte qenë luftëtar i Brigadës së Shtatë dhe e dinte si bëhej luftë. Luftën këta shkrimtarët si ky çilimiu që shet mjegullnaja e kanë parë nëpër filma, e jo në fushat e minuara te "Ankthi" ku nuk

dije ku shkel. E kanë lexuar nëpër libra, e jo të jenë sulur në bunkerët e armikut. Ata nuk mund të dinë ç'është heroizmi i vërtetë. Të vdesësh për ideal, i lumtur që nëse ti flijohesh, ka kush do ta shijojë frytin e luftës tënde. Pastaj ai e kishte shijuar dhe luftën e paqes, atë që zhvillonte partia vazhdimisht, duke drejtuar masat në rrugën drejt komunizmit, domethënien e së cilës sigurisht nuk mund ta kuptojnë këta çilimi kabinetesh. Prandaj dhe është ky tregim kaq i errët, pothuajse pa heroizëm çfarë e njihte ai.

Çështje rrymash letrare, tha ai. Këtë e kishte dëgjuar në një debat midis dy shkrimtarësh pikërisht në "Flakë", kur Teki Shehi, një shkrimtar mendjemadh, i kishte thënë shkrimtarit Muso Spahos, se s'merr erë nga modernizmi, se poezitë e tij më së miri do të ishte t'i lexonte në mesin argatëve të fushës ose në zgafellë, në mesin e minatorëve, sepse s'kanë pikë vlere për t'u thelluar në to, ndërkaq arti që krijonte vetë Tekiu, na qenka në të njëjtën rrymë letrare me dofarë Kafkash e Borhesësh! E kishte ndjerë dhe vetë sikletin në këtë bisedë përplot suetë të dy krijuesve, por e kishte pasur vështirë të kuptojë se për çka në të vërtetë flisnin. Tash kur e lexonte me kujdes "Ankthin" e Dan Logrit, gjërat i dukeshin më të qarta.

Mirëpo shoku Tosun Pahalli, me gjithë këto, nuk u bind se ka bërë ndonjë mëkat të madh ky farë autori i tregimit. Iu lajmërua në telefon shokut Hysni për t'i thënë ta shtyjnë për tjetër ditë kafenë,

se priste nga shoku Leksi i sigurimit të brendshëm informata për autorin, por kur bashkëfolësi matanë linjës tha se është "punë që s'pret", atë e vërshoi dhe një valë djersësh të ftohta. "Paska krisë diçka e madhe me këtë tregim, e unë s'po arrij të kuptoj!".

Kur u panë përsëri, shoku Hysni nuk e zgjati shumë: "Armiku nuk fle, shoku Tosum. Lexoje tregimin, për çka flet? Flet për një ushtri që e pushton një vend. Ushtria nuk ka emër, apo jo. Emri i vendit të pushtuar, poashtu nuk ka emër, gjithë është në mjegull. Hë. A nuk të kujton kjo masat e jashtëzakonshme që janë vendosur për të qetësuar situatën në Kosovë?!".

Një ofshamë e rëndë lëshoi shoku Tosum. Thirri kamarierin t'i sjellë një gotë ujë, nxori një tabletë për qetësim, ky ishte momenti kur ai mund të merrte goditje në tru! Aman, deri atje paskan vajtur punët me këtë tregim?

Derisa shoku i partisë priste të qetësohej, e shikonte me një shikim fitimtari, sikur donte t'i thoshte, e sheh, kur të flisja për armikun, ti s'më kuptoje. Kollaj e ke ta njohësh në deklarata e programe partie, por në praktikë, ai të përvidhet, të hyn nën lëkurë e t'i s'e sheh. Mori forcë më në fund, që t'i përgjigjet, edhe pse tashmë nuk dinte si të vazhdojë më tutje.

"Ky farë tregimi, sa e kuptova unë, më gjason në një tregim me partizanë dhe ushtri të pa emëruar okupatore! Nuk më duket se bën fjalë për

masat e jashtëzakonshme dhe dërgimi i armatës në Kosovë!".

"Nuk ju duket, ë? I gjithë ky tregim është përplot simbole të errëta, përgjasime e aluzione për një ushtri pushtuese nga njëra anë, dhe për një popull që mbrohet nga ana tjetër. Ushtri armike, që përfundon në hallakamë nga një popull që mbrohet. Këtu nuk ka partizanë e gjermanë, shoku Tosum, këtu autori flet qartë se ushtria popullore që është dërguar në Kosovë, do të përfundojë si ushtria në tregimin "Ankthi".

Në një moment iu duk vetja fare i pavlerë. E konsideronte veten një komunist të devotshëm, gjithë jetën dhe karrierën politike i kishte flijuar për ideal, kishte hyrë në luftë të pakompromis me elemente të dyshimta, por kjo që po dëgjonte tash nga shoku Hysni, fliste o për një tren të ikur për kuadrot në moshën e tij. Iu ka ardhur koha të pensionohen e t'ua lëshojë vendin kuadrove të reja më syçelë si Hysniu, me një vizion tjetërndryshe nga ata që dolën nga lufta. Ose, dikush ka luajtur këtu!

Aluzionet e tij tashmë u zgjeruan. Nisi të kërkojë dallimin midis vetes dhe Hysniut. Midis një kuadri që është ngritur në të gjallë të Titos, dhe një kuadri pa Titon. Një kuadri që kishte shef partie këta grindavecët e komitetit qëndror të cilët janë duke e shkatëruar unitetin që duhet të zgjedhin midis lojalitetit ndaj Stipe Shuvarit ose Sllobodan Millosheviqit, Azem Vllasit a Rahman Morinës...Ai

kishte pasur jo pak hamendje këtyre viteve të fundit për t'u rreshtuar. Ishte përzier pak si tepër ideologjia me ca interesa të tjera, secili ngrehte nga vetëvetja, ishte ngjallur një egoizëm që sa ishte gjallë Titoja nuk lente të çojë krye. Tash kishte çuar krye nacionalizmi, uniteti ishte në rrezik.

Shoku Hysni i dukej tash si një djall, krejt i zi, i errët, në kokë e në mendje. Vërtet nuk ishte se letërsinë e kishte qejf, po ta lidhte tregimin e këtij autori anonim me një ngjarje që ka ndodhur të premten, kjo i dukej vërtet një imagjinatë e krisur e shokut të partisë. Si krijoheshkan veprat letrare, ore e di ky shoku? Bëri një analizë të shpejtë në kokë: masat e jashtëzakonsme Kryesia e shtetit i kishte marrë të premten. Të premten dorëzohen të gjitha rubrikat e kompletuara dhe të shtunën mbetet të futen vetëm lajmet e fundit të "deskut" dhe sportit. Prandaj, nëse Kryesia i ka marrë masat të premten, ndërkaq ushtria praktikisht në Kosovë ka arritur të shtunën, atëherë kur arriti Dan Logri ta shkruajë tregimin? Kur këto dilema të veta ia tha shokut Hysni, ai u përgjigj preras:

"Uji fle, armiku s'fle, shoku Tosum! Kjo mund të jetë pikërisht pjellë e armikut" dhe shtoi: "në KQ tashmë janë informuar shokët dhe pres çdo moment të na thërrasë shoku Niku, nga Komisioni për Çështje Ideo-politike. Madje do të njoftohet edhe sekretari i parë i partisë".

"Mos u ngut, Hysni, nuk më duket mua ashtu si të duket ty. Mos të dalim gazi i botës!". Shoku

Tosum iu drejtua në emër që t'i tregojë se ai është më i vjetër se ai, se duhet të ketë më shumë respekt në mos për përvojën, të paktën për moshëne tij.

"Gjithçka është e qartë te "Ankthi". Ai aludon në masat e jashtëzakonshme dhe dërgimin e ushtrisë në Kosovë. Shihe ti si e ka mbështjellë me mjegull, me një tymnajë të errët që të mos e kapësh askund, por unë jam i sigurt, autori e ka dhe porosinë të errët, që kjo ushtria jonë atje të përfundojë me pushkët tytaposhtë, siç e ka përshkruar në tregim, të përfundojë në një zjarr e hallakamë, në një çmenduri...Kështu e dëshiron autori përfundimin e ushtrisë sonë atje. Aty është ushtria me tanke, si ushtria jonë".

Shoku Tosum mbeti në qëndrimin të mos nguten me përfundime të prera, të shihet tregimi në çdo detaj, sepse ai, që tashmë e kishte lexuar me vëmendje, kishte vërejtur disa detaje, ndonëse perifere, që flisnin vërtet për një ushtri të huaj që ka ardhur "prej matanë detit", vërtet nuk e emëron nëse janë italianë ose gjermanë, por kjo ka pak rëndësi në krahasim me faktin që ajo është diferencuar si ushtri okupatore.

"Pikërisht ashtu, ushtria jonë konsiderohet si okupatore!" tha me plot bindje Hysni Shyqriu, duke ia tërhequr vërejtjen të ketë vërtet kujdes kur të shkojnë në KQ, sepse çdo fjalë mund të interpretohet si rënie nën ndikimin e elementeve armiqësore. "Ti që ke pasë aq shumë beteja me këto

elemente, të paktën me përvojën që ke, duhet të tregohesh gjithnjë syçelë!".

-Po ç'mendim kanë ata të KQ-së pasi komisioni për çështje ideopolitike e paska marrë çështjen në shqyrtim?-pyeti.

-Sekretari, Pero Gjosheja është më shumë në Beograd se këtu, ndoshta dhe e kanë informuar, por prej tij nuk mund të pritet të merret me këtë çështje. I gjithë vendi vlon. Shokët Sefo Sulo dhe Nejazi Limoni, të cilët e kanë lexuar tregimin, ndajnë të njëjtin mendim se ka diçka të dyshimtë në të. Shoku Niko Stavre është i rezervuar, pret informacion. Nesër do të na thërrasin në KQ, ku do të jenë edhe nga "Flaka" dhe do të shohim ç'do të bëhet më tutje.

....

Për Tosum Pahallin gjerat kishin dalur nga binarët. Si një komunist i vjetër mendonte se përherë kishte qenë në vijë dhe kishte marrë vendime të drejta, të rrebta ndonjëherë, por të drejta. Ishte e gjatë nata kur s'e zuri gjumi duke pritur, mezi fjeti kah mëngjesi. Në mesditë u gjetën në Komitet, ku kryetari i Komisionit për çështje ideopolitike kishte ftuar edhe disa shokë të tjerë.

Në fillim, foli shoku Leksi nga punët e brendshme, të cilin shoku Tosum i kishte kërkuar informata për autorin. "Autori Dan Logri ka një biografi të pastër. Nuk ka në dosjen e tij diçka që do të veçohej. Në studime ka pasë një sukses mesatar, përveç lëndëve profesionale të gazetarisë ku është

shquar sidomos në punën praktike duke shkruar lajme e reportazhe për stil tërheqës. Shërbimin ushtarak e ka kryer në njësitin e policisë ushtarake. Ka disa shënime kur është marrë në pyetje pas demonstratave në Kosovë, por në to nuk ka gjëra që janë me interes për sigurimin".

Po për familjen e tij, gjete ndonjë gjë?-pyeti shoku Hysni.

"Familja e tij është një çështje shumë interesante. Babai i tij, Nexha, ka qenë shumë vite kryetar katundi. Xhaxhallarët e babait kanë pasë fate të ndryshme, njëri, para lufte, është vrarë në rrethana të pasqaruara deri sot si rojtës i shkollës. Dyshimi, një vrasje me porosi, për shkak një dashurie të ndaluar, porse familja e fali gjakun pa e ditur vrasësin dhe dorasin. Thuhet se gjërat janë ditur, por janë heshtur që të mos bëhet më e madhe. Një tjetër xhaxha, ai emrin e të cilit e ka marrë pikërisht autori i këtij tregimi, poashtu është vrarë, por gjatë luftës, si pjesëtar i Ballit. Thuhet se ka qenë antikomunist i përbetuar, që u vra matanë Vodnos, kur partizanët i zbrapsën ballistët. Kemi informacione se familja e ka kërkuar gjatë kohë varrin e tij për t'i çuar eshtrat në kaundin e lindjes, por nuk e kanë gjetur. Me gjithë këto fakte domethënëse, pas lufte nuk ka pasur ndonjë paraqitje armiqësore nga kjo familje, përveç një dyshimi që asnjëherë nuk u vërtetua, të xhaxhait më të vogël të Nexhë Logrit, Naipit, të ketë qenë në grupin e Dërvenit të NDSH-së që e shpartalluan

forcat e OZN-ës 1946-tën...Dy paraardhës më të largët, ndonëse i kanë shërbyer perandorisë osmane, janë vrarë në rrethana të pasqaruara".

"S'është dhe pa hiq kjo familje!", tha Hysni Shyqriu, të cilin me luajtje koke dhe shikim i dhanë shokët Sefo Sulo dhe Nijazi Limoni. " Vëreni me kujdes, çdo herë gjendet ndonjë që është jolojal ndaj pushtetit. Mund të konsiderohet se ky pinjolli i fundit, Dan Logri, të ketë marrë ndonjë amanet nga më pleqtë që të luftojë pushtetin komunist!".

Të gjithë u shikuan njëri me tjetrin nga vërejtjet e Hysniut.

"Mendoj se duhet shikuar rrethanat si është shkruar tregimi. Ato do të na çojnë të përgjigja në ka ose jo ndonjë prapavijë për të degraduar masat për qetësimin e situatës në Kosovë.

Të pranishmit nga redaksia e "Flakës së vëllazërimit", kryeredaktori dhe redaktori i rubrikës u ndjenë të thirrur të sqarojnë.

"Unë e lexova pa dyshuar fare se mund të ketë ndonjë prapavijë", tha redaktori Hako Sela. "Tregimi kishte një qasje interesante, ndaj vendosa ta botoj. Në kolegjium e prezentova përmbajtjen dhe askush nuk pati rezervë ndaj përmbajtjes së tij. Nuk e kemi zakon që të lexojmë gjithçka në kolegium".

"Ne kemi përvojë të hidhur nga e kaluara, prandaj çdo redaktor mban llogari se ç'tekste boton, konsultohemi nëse ka dyshime, gjë që nuk

ka qenë fare në rastin e këtij tregimi", foli kryeredaktori, Rexhail Floriu.

"Për kujdesin tuaj, jeni të njohur, shoku Rexhail", foli Nejazi Limoni me ironi "e shohim dhe me këtë tregim me atmosferë të zymtë. Po, po, ky autori juaj i pasherr, e ka marrë në shenjë ushtrinë tonë, a s'po shihni, apo s'po doni të shihni?!".

"Më falni shoku Nejaz, unë e kam të njohur përkushtimin tuaj për të luftuar nacionalizmin që e gjeni dhe ku nuk është, por këtu flasim për një tregim që ka një përmbajtje shumë të qartë!", gjegji kryeredaktori.

Nejazi Limoni kërceu si gjel. "Ky është provokim! Që kur flas nëpër forume që "Flaka" kaherë është shndërruar në çerdhe armiqsh të sistemit. Atje, për shkak të dobësisë sonë, janë mbledhur gjithë ish-at e diferencuar dhe të dënuar politikë, intelektualë pa librezë partiake, çfarë e mendoj të jetë edhe ky çilimiu që ka shkruar "Ankthin" dhe mendon se s'do ta zbulojmë idenë e mbrapshtë dhe porosinë e fshehtë. Të tillë jeni ju të "Flakës", gjuani gurin dhe fshihni dorën. Dhe mbroni njëri tjetrin. Edhe Partia ju ka toleruar, se ndoshta ka pasur dhe lartë ndonjë që ju ka mbrojtur, ndoshta ndonjë që poashtu ka veshur lëkurën e qengjit..."

Sefo Sulo, profesori i filosofisë dhe ideatori kryesor i diferencimeve në Akademinë Pedagogjike, mërmëriti nëpër dhëmbë siç e ka

zakon duke thënë se shoku Limoni "ka të drejtë". "Kam pasur shumë probleme kur isha kryeredaktor i "Flakës", secili më i mençur se tjetri, secili më i thellë se tjetri në metafora e simbole...Ndonëse ato ishin kohë pak më tjera".

"Me një fjalë, shokë të "Flakës", pranoni kritikat se ju ka munguar syçeltësia", ndërhyri Hysni Shyqriu.

"Të kthehemi te rrethanat", tha Tosum Pahalli. "Ju shokë të "Flakës" nuk dyshoni, madje siç mund të përfundohet, tregimi është dorëzuar para se të merren masat për Kosovën, që don të thotë se përjashtohet çdo mundësi për ta lidhur përmbajtjen e tij me ngjarjet e fundit". Ai kishte dhe hallin e tij, që po të dëshmohej se tregimi kishte motive politike, i binte faji edhe atij që s'e kishte alarmuar menjëherë partinë dhe tash shokët mund të propozonin ndonjë masë degradimi edhe për të.

"Më duket se disa shokë po ruajnë bythën e tyre, më falni në shprehje!", tha gjithë mllef shoku Shyqri.

"Dhe mua më duket se dikush dëshiron të gjeje qimen në ve, më falni dhe mua në shprehje. Më duket se e paska pasë kjo puna e partisë, kur ka shokë që prodhojnë gjëra të paqena!", u nxeh edhe shoku Tosum.

Shoku Niko, kryesues i këtij takimi, apeloi për qetësi dhe konstruktivitet. Shokut Leksi i tha që organet duhet të vazhdojnë të përcjellin me kujdes situatën në terren(duke mos përmendur "Flakën"),

sepse situata në të cilën gjendet vendi, kërkon urtësi dhe syçeltësi. "Detyre e çdo anëtari të partisë që t'i dënojë dukuritë që rrezikojnë unitetin, çdo shkarje ideologjike nga vija e partisë. Edhe shokët e KQ-së do të njoftohen me rastin. Por, shokë, nuk duhet dhe të ngutemi. Duket sikur rrethanat kanë ndryshuar jo vetëm rretherrotull nesh, por dhe në parti. Janë ca re të zeza që ndoshta s'po i shohim, ndoshta nesër do të qeshemi me vetëveten, ku të dishë".

U shpërndanë të gjithë me një ndjenjë të çuditshme të Tosum Pahallit që shokët si Hysni Shyqriu dhe Nijazi Limoni sikur kishin marrë një mision për ta marrë në dorë partinë. Ata që dukeshin më katolikë se Papa, e bënin të dyshojë në vetëveten, në programin e partisë, në veprimin e deritashëm, të shqyrtojë dhe vetëveten dhe vendimet që kishte marrë. Gruaja vërejti shqetësimin e tij kur u kthye në shtëpi, i bëri një kafe pa sheqer, i dha diçka për t'ia normalizuar sheqerin, i nxori një shishe ujë mineral pasi i ishin tharë buzët. Ç'do të pillte rasti i tregimit tash i dukej krejtësisht pa rëndësi, sepse mund të ishte edhe ai në rend dite, pasi kokat si Hysni Sheqeriu dhe Nijazi Limoni kishin sjellë një frymë tjetër në parti, atyre duhej frikësuar. Ata nuk gjykojnë atë që është shfaqur si devijim, ata devijimin e trillojnë vetë e pastaj i dënojnë të tjerët. Ky ishte një dallim esencial.

...

Pas nje serë takimesh që ishin mbajtur në organet e partisë në "Flakë", në kolegjiumin redaktues, si dhe nga marrja në pyetje të redaktorëve nga inspektori i sigurimit, Leksi, (nga këto peripeci, çuditërisht, ishte lënë anësh vetë autori, i cili ditë me radhë kishte ndjerë veten si një qengj i gatshëm për kurban), shoku Niko i kishte thirrë edhe një herë në Komisionin për çështje ideopolitike, i cili kishte dhënë konkluzionin para se të marrë fjalën ndokush tjetër: "Çështjes së tregimit "Ankthi" duhet t'i vemë pikë këtu. Sikur të mos kishte ndodhur fare. Nga hetimi dhe hulumtimi i rastit nga shumë aspekte, më së miri është që të mos njoftojmë askë më lartë, se po shkoi në Kryesinë e KQ të Partisë, do të bëhemi gaz i botës, do të qeshin me ne jo vetëm shokët por dhe gjithë publiku! Doli se u tund mali, e polli miun. Tregimi për të cilin na alarmuan disa shokë, është shkruar që vitin e kaluar për konkursin letrar. Dëshmia materiale: kopja e tregimit me shifër. Çdo debat tjetër është shterp. Aluzionet se ai bën fjalë për masat ushtarake në Kosovë don të thotë t'i japim autorit aftësi profetike, që do të ishte një nonsens. Partia nuk merret me botën paranormale...".

Sa e madhe iu duk shokut Tosum "pika" që iu vu "Ankthit". Vërejti si iu mërdhez fytyra shokëve Hysni, Sefo dhe Nejazi.

FSHEHTËSIA E RAMUSHIT

Keni dëgjuar për ndonjë amanet nga njeri që s'keni ndonjë lidhje. Nga njeri që mezi e njeh. Kështu më ndodhi mua me një shok të babait. Do t'i themi shok, pasi ishin pothuajse të një moshe, kurse lidhja farefisnore midis Ramushit dhe babait, ishte nga linja e gruas, gjegjësisht, sime mëmë, pasi e ëma e saj ridhte nga kjo familje. Duket sikur penjtë e rrëfimit duken të ngatërruara në shikim të parë dhe do të përgënjeshtroni fillimin për një njeri që "mezi e njeh". Na del se nuk është ashtu, mirëpo e vërteta është se ne me këtë familje nuk kishim hyrje-dalje, se lidhja familjare e sime mëmë ishte e largët, kurse babai me Ramushin kishin këputur lidhjet që në fëmijëri, pasi një vëlla i Ramushit kishte rënë në bela me një katundar, prandaj dhe qenë detyruar të iknin në qytet të mos pillte ndonjë bela dhe më të madhe. Por, s'është kjo çështja. Kishte diçka të çuditshme në karakterin e këtij njeriu. Ose më saktë, ashtu më dukej mua kur komunikonte me njerëzit. Asnjëherë nuk e dije kur bën shaka dhe kur flet seriozisht. Prandaj dhe unë nuk e kuptova seriozisht kur një ditë m'u drejtua me një paralajmërim.

"Ty do të të kërkoj t'më bësh një nder që s'ia kam kërkuar askujt!", më tha një në prani të tim et. Unë posa kisha kryer fakultetin dhe isha bërë gazetar. Si thuhet, ende s'isha ulur mirë në tavolinën e gazetarit. "Kam lexuar gjëra të bukura

prej teje, prandaj një ditë do t'ma bësh një nder! Ata që shkruajnë, e kanë prej Zotit prirjen që gjërave të rëndomta, t'u japin kuptim". Përderisa unë kujtoja nderin që duhej t'i bëja "me të shkruar", ai shtoi:

"Pasi të vdes unë...".

Pasi të vdesë? Si t'i bëhet nder njeriut, pasi të vdesë? Ndoshta e kishte fjalën që t'i mbaja një fjalim të bukur në varrimin e tij, një fjalim që do ta mbajnë mend njerëzit, më mirë se vetë jetën e tij.

Ramushi ishte në moshë. Kishte disa vite që kishte dalë në pension. Nga këndvështrimi im, ishte një njeri me një jetë të rrumbullakuar, gjithë jetën kishte qenë shef në sektorin e urbanizmit në komunë, fëmijët i kishte rritur dhe martuar, vajzat i kishte dhënë në derë të huaj, djalit ia kishte ndërtuar një shtëpi në një lagje të mirë të qytetit, dhe tash ai, mund të jetonte vitet e fundit pa ndonjë hall. Me fjalë të tjera, njeri i plotësuar, që s'i kishte munguar gjë gjatë jetës dhe që s'i mungonte dhe tash kur ishte në perëndim të jetës. Pagën e pensionit s'ia kërkonte askush, kështuqë atë e harxhonte me moshatarët e tij nëpër çajtore e kafene, duke luajtur "pishpirik" ose domino.

Saherë që e takoja, ashtu në të rrallë, do t'ma kujtonte fjalën që ma kishte thënë. "Aq mund të bësh për mua...", më thoshte, "një nder të vogël".

Ndoshta çdo takim i ardhshëm, shënonte nga ndonjë shenjë më të theksuar pleqërie, gjersa një ditë, pa pritë e kujtuar, nuk e pashë foton e tij në lajme, ku familja e tij, përmes një mbese që punonte

në Televizionin Shtetëror, lajmëronte se ka vdekur "ish-punëtori i zellshëm shoqëroro-politik, Ramush Peçi". Lajmi u dha pas varrimit, kështuqë ndjeva keqardhje që të paktën të kisha marrë pjesë në varrim, përderisa ai aq shumë e kishte kërkuar një nder. Ndjeva veten se nuk e kisha kryer këtë obligim të cilin nuk e kisha marrë vetë, por që e ndjeja si të tillë. Por, disa javë më pas, kur avokati i autorizuar kishte hapur testamentin e tij, familjarët ishin gjetur të befasuar kur në një një pikë isha përmendur dhe unë! Kushedi se ç'kishin kujtuar ata se ç'më ka lënë dhe përse nga pasuria që ndoshta e kishte fshehur prej tyre, por dyshimi i tyre kishte qenë fare i kotë, pasi mua më kishte lënë një pako që e kishte strehuar me kohë në një kasafortë banke që s'kishte lidhje me pasuri materiale. Mua më kishte lënë jetëshkrimin e tij, ashtu siç ai e kishte "përjetuar kohën"(citat nga letra përcellëse) në disa fletore shënimesh me kapak të trashë. Ai prej meje kërkonte të lexoja me vëmendje fletoret e tij dhe të vlerësoja në ia vlen një njeriu si ai t'i bëja një epitaf në gazetë ose në libër. Nëse e sheh të arsyeshme, nëse mendon se jeta ime ka një vlerë, shkruaje një epitaf që të mund të kuptojnë njerëzit kush isha në të vërtetë, a ia vlejtën ëndrrat e mia dhe a i realizova në jetë. A isha njeri i mirë a i keq. A isha vetjak apo kam menduar dhe për shoqërinë. A kam bërë vepra të mira që t'më kujtojnë, apo vepra që s'vehen fare në peshojë. Nuk kërkoj shumë, nëse s'ia vlen një epitaf, atëherë

mund të shkruash një tregim me një personazh si unë, me emër krejtësisht tjetër. Një personazh artistik ku dhe mund të shfrytëzosh imagjinatën tënde prej krijuesi dhe të më bësh më të zi seç kam qenë, më të bardhë seç kam mundur të jem. Unë jam këtu, me frymë e shpirt, në këto fletore. Aty janë mendimet e mia që s'i kam thënë në publik, sepse dhe unë një kam menduar, e tjetër gjë kam bërë. Aty janë ëndrrat e mia të realizuara dhe të parealizuara. Janë qëndrimet e mia ndaj kohës, sepse koha është më shumë se matje 24 orëshe. Koha ka ngjyrat, nuansat, nën-nuansat...Sytë e njeriut janë mënyra e të parit të kohës dhe të përjetuarit. Unë kështu e kam përjetuar kohën.

Një ditë u ula dhe shkrova rreshtat që do të ishin përmbushje amaneti:

Nuk e keni njohur R.P.-në

Në mesin tuaj ka jetuar
Njeri me inicialet R.P.
Një Hamlet që s'i dha fund jetës
Kur u gjet në zgrip,
Një Othello që s'e vrau të Bukurën
Kur e shpifën për tradhti
Një palaço që s'bëri askën të qeshë
Kryevepra e tij përqeshëse qe vetëvetja
Keni njohur njeriun që jetoi pranë
Pa e njohur fare
Se dhe ai vetë iku
Me pyetjen kush ishte përnjëmend

NATA NË ANIJE

Shumë gjëra atij i dukeshin të çuditshme në jetën e tij. Ndonjëherë mu për këtë bëhej objekt talljeje në shoqëri. Një nga ato gjëra për të cilat e tallnin moshatarët ishin edhe poezitë. Aman o Gent, vërtet kujton se me ato vargjet e tua do të arrish ta ndryshosh botën? Ishte pyetje se nuk ia vlente të përgjigjej. Ç'kishte t'u përgjigjej atyre që në jetën e tyre ishin futur numrat ose meridianët gjeografikë, llojllojshmëria e botës bimore e shtazore, formulat kimike, forcat lëvizëse në fizikë, trupat qiellorë... Punë e tyre, secili ka preokupimet e veta. Atij asnjëherë nuk i kishte vajtur mendja t'u përzihet të tjerëve me se merren e aq më pak t'i tallte ata. Po poezia që ia përmendte ndonjëherë dikush që nuk e kuptonte se ai as dëshiron të arrijë diçka, e as që të ndryshojë botën, nuk ishte një temë që një krijues mund të humbte kohë me ata që ishin larg vlerave të amshueshme. Poezia ishte për të një cytje prej brenda që t'i nxirrte në letër përsiatjet e tij të moshës. E kishte si një ushqim shpirtëror që po të përpiqej t'ia shpjegojë, do të bënte një punë kotnasikoti.

Lere atë, flet me qiellin, me hënën, me tokën, me ujin, me detin...flet madje me të gjitha të dashurat që asnjëherë nuk i ka pasur!

Kjo e fundit i kishte dhimbur si tepër. Edhe kësaj pune nuk do t'ia varte veshin, por në moshën e tij, kur të gjithë flisnin për dashuritë e tyre të sinqerta ose për aventurat e natës, që shpesh i shndërronin në numra, ai nuk kishte "me se" të lëvdohej. Shkruan poezi dashurie, ore, na thuaj për ndonjërën nga muzat tua! Kështu e tallnin kur në ndeje, gjysmë të pirë, nisnin shokët t'i zbulonin sekretet e tyre pre "maço" tipash, kur hiperbolat e tyre ishin në përpjestim me "promilat" e alkoolit që kishin pirë. Ai neveritej ndaj nuk e parapëlqente të flisten në temën e dashurive për një natë, i vinte një e vjellë të dëgjonte e lere më të tregonte. Nuk ishte aq tip introvert, sa e merrnin shokët, por dhe s'kishte sekrete që atyre duhej fshehur. Por sikur të vihej në sprovë, sikur t'i bënin shantazh o do të tregosh, o s'ka tjetër rrugë?

S'kishte ç'të tregonte, apo ajo që mund t'u tregonte s'mund të joshte kureshtjen e tyre! Por, njerëzit që e mbanin me një fantazi të bujshme, prisnin madje ndonjë tregim të trilluar për ta plotësuar kureshtjen e tyre, por dhe për t'u dhënë një dell artistik rrëfimeve të tyre bajate. Por ai nuk mund të dilte nga lëkura dhe atë imagjinatë krijuese që e kishte e shprehte në letër, jo duke ndenjur në kafene. Nga ana tjetër, do të ishte po aq të papërshtatur me moshën e tij, për shkak se nuk mund të ishte "i barabartë" në biseda, të ndahej dhe të mbyllej në vetvete, në vetminë e frymëzimeve, në moshën më të bukur të rinisë.

Jo se ishte rob i verbërisë, por ai megjithatë, duke lexuar dhe libra të shenjtë, një gjë kishte mësuar për etikën njerëzore: të fshehtat e botës së përbrendshme nuk duhet ndarë me botën. Por derisa ai përmbahej këtij parimi, ata që e tallnin për heshtjen e tij, e shpotisnin dhe për shkak se dyshonin se gjersa nuk flet për këto gjera, kishte ndonjë "arsye" që s'e thotë! Në një shoqëri kishte gjëra që njeriu ndan me të tjerët, ka gjëra për të cilat ka nevojë të kërkojë mendim, dikush ka nevojë të marrë prej teje dhe kjo i dukej normale. Shokëti e tij flisnin për shumës, ndërkaq po të fliste në këtë temë, ai ishte rast i njejesit. T'u thoshte për dashurinë ndaj vajzës që ia kishte marrë mendjen dhe e kishte çuar deri në përsiatje qiellore, këtë askush nuk do ta kuptonte.

Ishin botë të ndryshme. Një gjë ishte ajo që ata e konsideronin paksa "mënjanë", dhe krejtësisht ishte tjetër ajo që ai mendonte. Porse as ai, nuk do të mund të përballonte aq lehtë thumbat që i dëgjonte pas shpine "Lëre se s'ka fat ne femrat ai!". Nuk e kishin cenuar filozofinë e jetës së tij, por ajo që çdo mashkull nuk don ta vë në pyetje, qoftë ai dhe poeti më i marrë pas muzës së tij të vërtetë ose të trilluar. Sepse, kur thoshte dikush "edhe poetët që kanë shkruar për dëlirësinë e bukurisë së femrës, për virtytet e idealizuara, për devotshmërinë, në jetën e tyre kanë qenë të tjerë fare!". Kurse në jetë një femër mund të duash dhe me njëqind të tjera të kesh lidhje! Por ty me asnjë nuk po të shohim!

Genti i një lagje të Shkupit ku gjërat nuk mund të fshiheshin, aq më tepër nga shokët lazdranë, shpesh gjendej para situatës të vente veten në sprovë. Të tradhtonte veten dhe t'i lëshohej epshit.

Por, do ta tradhtonte dhe Yllkën, që jetonte në çdo varg të tij. Ishte ajo fytyrë që e bënte të besojë në atë që të tjerët për këtë mund të të shpallnin të krisur, besonte në dashurinë e vërtetë.

Me Yllkën takohej mbrëmjeve në skutat e lagjeve larg qendrës, megjithëse në një qytet, sado i vogël o i madh të jetë, është çudi të mbeteshe pa u parë. Vërtet kërkonte vende intime më larg lagjes dhe syve kureshtarë dhe ndante përkëdhelitë dhe shikimet me atë zjarr që din ta krijojë mosha dhe vetë dashuria e vërtetë. Ah, botës i interesonte çështja e seksit? Në kishte o s'kishte në lidhjen e tyre përafrime aq të thella, këtë s'mund t'i jepte dikujt llogari. Por për këtë gjë shpesh ishte hamendur vallë t'ua tregonte ndonjë rrëfim që ata e prisnin, që pastaj vetë atij t'i rritej "çmimi" si bandill, por ndjente se me atë rast do të ndjehej i ndyrë, i pistë, dhe do të tradhtonte dyfish: vetëveten dhe parimet e tij dhe në këtë rrëfim s'donte assesi ta përmendte Yllkën. As zëvendësimi i saj me një personazh tjetër anonim, sa për të kaluar "provimin" e burrërisë para miqve të tij, nuk i dukej se mund ta bënte.

Përderisa gjërat mbeteshin nën velin e misterit, shokët e tij gjithnjë e më tepër besonin se me Gentin gjërat nuk janë "në rregull". Vitin e ekskursionit të

apsolventurës do të vizitonin disa qytete të Bashkimit Sovjetik. Moska e Leningradi ishin destinacione të mrekullueshme për të parë të kaluarën dhe të tashmen e një populli. Disa ditë të kaluara në Moskë, do t'u kishin lënë shumë mbresa studentëve të ardhur nga një vend me socializëm "më liberal", porse gjurmët e historisë së socializmit atje ishin më të dukshme, më mbresëlënëse. I shihje në çdo hap. Në atë shkallë të vetëdijes ndjeheshin krenar që më 1948-ën Titoja i tyre ia kishte thënë "JO-në historike" Stalinit, me çka socializmi i tyre kishe marrë kahe tjetër, ishte shndërruar në një socializëm më të hapur ndaj botës. Pak socializëm, pak kapitalizëm... Por këto gjëra vetëm kalimthi mund t'i vërtiteshin nëpër kokë ndonjërit. Ndoshta Gentit që përçapej midis historisë dhe poezisë së famshme ruse. Tolstoi, Çehovi, Pushkini, Dostojevski, Sholohovi, Turgenjevi, Majakovski, Jesenini,...pastaj Pasternaku, Sholzenjicini e Bullgakovi, që ishin mënjanuar nga letërsia zyrtare sovjetike, pastaj Marina Cvetajeva e mrekullueshme e atyre rrëfimeve të shkurtëra te "Tetori i kuq" po të paharrueshme që i kishte lexuar në gjuhën serbokroate. Çfarë ishte shpirti i këtij populli që i kishte dhënë letërsisë së përbotshme galeri veprash e personazhesh të papërsëritshme. Ai do të dëshpërohej gjithsesi kur do të takonte njerëz të cilët luhateshin si hije gjersa kalonin mbrëmjeve të pirë tapë. Ndonjëri prej poetëve do të ketë qenë i

këtillë, thoshte me vete. Fama e vodkës ruse në jetën e njerëzve të dëshpëruar nga përplasjet e kohëve, nga revolucionet e kundër-revolucionet, nga bolshevizmi e menshevizmi, nga kolhozët dhe kovhozët, nga Lenini, Trocki e Stalini, Vishinski e Berija, nga Kirovi, Bullganjini e gjer te, Hrushçovi, Brezhnjevi e Gorbaçovi që sapo kishte hipur në pushtet. Një popull i përvuajtur, doemos, një popull që më shumë se vodka e kishte nënshtruar ideologjia, e kishte thyer frika nga policia sekrete dhe dukeshin si hije.

Por, përse lodhej Genti me këto, kur shokët e tij vraponin pas çdo buzëqeshje të vashave që komunizmi, të paktën në moshën e tyre të njomë, ende nuk kishte arritur t'ua prishë bukurinë, shendin dhe frymën. Ajo që e kishte magjepsur nga letërsia ruse ishin dramat që luheshin për shkak të femrave fatale. Femrat që të bëjnë për vete me bukurinë dhe lajkat e tyre dukej se i shihte rrugëve të Moskës, e sidomos në ato të Leningradit. Leningradi e bëri për vete ngase ekskursioni i tyre qëlloi në "netët e bardha". Në lumin Neva dilnin natën dhe shikonin kur çoheshin urat dhe kalonin anijet. Shkëlqimi i dritave të urave dhe anijeve zbehej nga netët e bardha, sepse jo vetëm pse dielli perëndonte diku para mesnate, por dhe se pastaj nuk kishte terr të vërtetë. Thjeshtë, ato ditë të kaluara qytetin e famshëm të carëve rusë, të Pjetrit të Madh dhe të Ekaterinës që "i hante" meshkujt, të Leninit e të Revolucionit të Tetorit, të Pallatit të

Dimrit, ishin gjëja që Gentit nuk do t'i hiqeshin kurrë prej kujtese. I gërshetoheshin pamjet e shfrenisë së oborreve të carëve rusë, dekadencës së aristokracisë dhe të pashpirtësisë së ideologëve të spastrimeve komuniste, e tragjedive të mëdha individuale e pësimeve kolektive. Kush do t'ua gjente fundin e lëmshit gjithë këtyre pështjellimeve historike që ishin luajtur në këtë qytet. Ndonëse nuk kishte ardhur në këtë qytet t'i gjente përgjigjet për këto, megjithatë, nuk mund të mos kujtonte një kontrast midis njeriut të rëndomtë dhe të hegjemonisë së shtetit të madh. Si në Rusinë e carëve, si në Bashkimin Sovjetik, një ide shtetomadhe për shtrirje ndikimi gjithandej nëpër botë, kishin personifikuar Rusinë si një Arushë të Madhe, që nënshtron popuj e shtete, ndërkaq ata të cilët flijoheshin për këtë ide ishin njerëzit që kishin vetëm një jetë, që vdisnin dhe pa dashjen e tyre, ose vdisnin sikur të pirë me vodkë nga ideja për madhështinë e vendit të tyre të paanë! Kur kujtonte komunizmin, gjëja që më së shumti i bënte përshtypje ishte populli rus në njërën anë dhe lideri komunist jo rus në anën tjetër! Bënte një llogari të vdekjes: aq sa kishte banorë shteti prej nga vinte, aq kishte dhënë flijesë kundër okupatorit gjerman dhe në gjithë Luftën e Dytë Botërore. Por, kjo ishte ajo flijesë që çdo popull i shtypur është në gjendje ta bëjë për atdheun e vet. Por, përse një lider jo rus të çonte në vdekje nga përndjekjet e armiqve të brendshëm dyfishin e 20 milionëshit që e thoshte se

është e saktë poeti i syrgjynosur Sholzenjicin? Të pakta do të jenë rastet që një popull të madh ta shtypte një sundues që s'ishte i tij, por murtaja e kuqe, siç e kishte quajtur gjyshi i tij i ndjerë komunizmin, kishte krijuar udhëheqës përbindësha, të cilët i bënte të fuqishëm ideologjia që kishte fshirë dallimet midis njerëzve dhe popujve saqë nuk kishte më rëndësi se kush është shtypësi! Ndoshta mashtrimi më i madh i kishte bërë popullit rus kur ai kishte nisur t'i bindë ata se është më rus se vetë rusët! Nga një vagabond i Gjeorgjisë, që ishte shquar duke thyer hundët me rrugaçë si ai në luftë me banda të kohës së Carit, ai ishte ngritur mbi idetë e Marksit, dhe në kohën kur qe njohur me Leninin, ky punët e fëlliqura ia kishte lënë pikërisht Mustaqokut, pa ditur se një ditë ai do ta trashëgonte kundër vullnetit të tij.

Gentin e lodhnin këto gërshetime të çuditshme të historisë, ideologjisë e krimeve, ndërkaq magjepsej në Pallatin e Dimrit tek shikonte nga Neva, prej ku ciceronët tregonin me gisht kah ka ardhur "Aurora", anija e famshme me Leninin. Pati rast të shohë dhomat e carëve, dhomën ku ishte themeluar qeveria kalimtare e Kerenskit para se ta marrë gjithë pushtetin Lenini. Ç'kohë kishte qenë ajo, kur një despot i dështuar ishte zëvendësuar me një mbret të kuq gojëmbël, që në vdekje të dërgohen pastaj e të vdesin nga uria me miliona? Sa keq i dukej krahasimi me delet që shkojnë me blegërimë te kasapi! Njerëzit vetë kishin mposhtur

Carin, vetë kishin përqafuar një ideologji plot ëndrralla që në jetë u shndërruan në ankthin më ngulfatës. Kujtonte Mixhën Sherif, i cili në rrethana të çuditshme kishte qenë në Revolucionin e Tetorit. "Rridhte gjaku nëpër rrugë si me pasë therrë kurbanë!" me këto fjalë në mënyrë sa më të përafërt ua përshkruante njerëzve. "Aty në Petrograd e kam parë edhe atë, Mbretin e Kuq, Leninin! Nuk të zinte sy, por kur fliste, e ndizte turmën! Njerëzit e donin, te ai shikonin shpëtimin. Nuk dukej njeri i keq, po ama, që gjaku derdhej rrëke për shkak tij, nuk di çka të them. Ishte mjekër djalli, ajo, se meleket nuk mund të kishin mjekër. Kështu ndodh kur ndeshen dy të këqija, o njerëz, larg qoftë nëse ai farë komunizmi vjen një ditë te ne!". Kështu kishte folur mixha Sherif, në vitin 1920 kur ishte kthyer në fshatin e vet. Atëherë djalë i ri, gjithë gëzim që kishte mbetur gjallë, por i dëshpëruar që kur kishte ikur kishte lënë dovlet myslimani, e kishte gjetur xhandarë krali serb! I thanë se tutje kishte lindur një shtet me mbret shqiptar. Ah, Mixha Sherif, për të cilin ndjente keqardhje që s'ishte takuar e ta dëgjonte rrëfimin drejt prej tij. Me një histori të çuditshme gatise aventurë: nga një ushtar i Turqisë, i zënë rob nga armenët, e kishte mbërritur në selinë e Rusisë Cariste kur ajo po shembej! Kush do ta besonte se një banor i vendlindjes së tij do të kishte bërë këtë aventurë të pabesueshme.

Historinë e tij do ta rrëfej një ditë, zotohej ai, tek shkilte në sheshin para Ermitazhit. Këtu do të ketë

rrjedhë gjaku rrëke siç e ka parë mixha Sherif i Bojanës së Dërvenit!

Por, një brengë shpirti e kaploi kur ca studentë i thanë për Pushkinin, ditarin e të cilit kishte kërkuar t'ia gjenin! Donte të dinte për ditët e fundit të jetës së tij. I kishte përshkruar në detaje ca muaj të fundit, derisa nuk kishte dalë në dyluftim me dashnorin e gruas së tij. "Po ç'të duhet ai ditar?" i kishte thënë Sashoja, një student i Grupit të Gjuhës Shqipe të Universitetit Lindor që kishte ardhur nga Bjellorusia dhe kishte mbetur në këtë qytet si shumëkush tjetër. Ai e fliste mirë shqipen që e kishte mësuar nga profesorët e tij Agnia Desnickaja, Alvina Zhugra, Sasha Rusakv, Irina Varonina, Gertruda Entrej e të tjerë, që ishte një grup profesorësh të cilët në kohën kur Shqipëria e Bashkimi Sovjetik kishte pasur marrëdhënie të mira, kishin pasur mundësi shqipen ta mësojnë nëpër qytetet dhe fshatrat shqiptare.

"Nëse don të ruash imazhin e bukur të Pushkinit, më mirë të mos e lexosh atë ditar!", ishte rekomandimi i Sashës.

Edhe po ta gjente atë ditar, ai nuk do të mund ta shijonte ndjenjën e shqetësimit të shkrimtarit të madh. Tekstin në gjuhën rusishte do ta kishte kuptuar vetëm për gjysmë, sepse gjuhët sllave të popujve të shtetit të tij mund të ishin të afërta me gjuhën-mëmë të tyre(rusishten), por që ishin larguar prej saj, si fëmijë të shpërndarë nëpër botë që tashmë kishin humbur lidhjet.

Por që të mos e lexonte ditarin e poetit të madh, këtë ide nuk mund t'ia hiqte askush. Vetëmse çuditej që deri atëherë asnjë botues nga vendi i tij nuk e kishte bërë. A thua kaq shumë këta botues do të kishin respektuar Pushkinin sa të mos ia prishnin imazhin? Sashoja ia gjeti nga një bibliotekë dhe i tha që për dy ditë ta kthente, duke ia përsëritur edhe një herë që nuk bënte mirë që e lexonte. Por pikërisht kjo atë e bëri që ditarin para vdekjes së vet, ta lexonte brenda nate! Ajo që e lexonte nuk ishte më ndonjë letërsi që do ta krahasonte. Ishte një pornografi e vërtetë! Nuk ishte as si te Bukovski, as si te Apdajku, sepse përderisa shfreninë te "Biri i përdalë" dhe "Suingerët" e përjetonte nëpërmjet personazheve të trilluar, këtu protagonist ishte vetë Poeti ai që ishte zhytur në botën e mëkatit, ishte gruaja e tij Natalia me dashnorin e përligjur që çonte dashuri në sytë e burrit, ishte...çka nuk ishte! Më zi se ai filmi gjysmë-pornografik që e kishte parë në vitet e pubertetit "Orgjitë në fshatin e Carit", e ku në qendër të vëmendjes ishte edhe një tjetër rus i madh, mistiku i përdalë Rasputin! Çuditej pastaj me motivin e Pushkinit për t'i dalë në dyluftim të dyshuarit për aferë dashurie, pasi gjërat ishin krejtësisht bythëpraps! Ai përshkruante në ditarin e tij sa shumë e dashuronte gruan e tij Natalia, për të cilin ishte i gatshëm të vdiste për ta mbrojtur nderin e saj, ndërkaq përshkruante në detaje tradhtitë e ndërsjella, kur kishin çuar dashuri në

treshe, që këtij i villej tek e lexonte. Për një moment dëshironte të ndante dy botërat e Pushkinit, atë të poetit të madh, të vargjeve të pavdekshme të poemave të tij, që e bënë të famshëm në moshë shumë të re, dhe jetën e bohemit, aristokratit të përdalë, i cili në vargje shkruan për dashurinë e pastër, të himnizuar e idealizuar gjer në qiell, ndërkaq vetë futet në llumin e mëkatit prej të cilit s'mund të lahej as në këtë e as në atë dynja.

Si paska jetuar kjo aristokracia, si qenka katandisur në këtë derexhe? Po prandaj dhe u përmbys nga një grusht komunistësh ajo elitë që udhëhiqte këtë perandori. Ishte tjetër gjë ishte që edhe komunistët kishin për të vazhduar më pas me katandi të tjera të vetat, duke u zhytur në pellgje gjaku, duke kryer nga krimet më monstruoze që njeh bota.

...

Tetëmbëdhjetë vjet më pas i cingëroi telefoni. Një zë i panjohur, nga një numër shteti të huaj u dallua në ekranin e telefonit. U prezentua si korrespodent i një televizioni ukrainas, Pjoter Sendeliev. Korrespodentit iu desh një kohë që t'i tregojë peripecitë si e kishte gjetur telefonin e tij duke pyetur ku kishte mundur.

"Ju jeni Gent Sulo?"

"Po, unë jam Gent Sulo, megjithëse nuk e di në jam ai që ju kërkoni. Ka dhe të tjerë me këtë emër".

"Personi që më ka angazhuar për t'ju gjetur më ka thënë se jeni profesor, filolog"

“Po, filolog jam”

“Domethënë, jeni personi që kërkoj...dhe dua t’ju pyes nëse ju kujtohet një vajzë me emrin Tatjana Kuzmenko”.

Genti nuk u mendua gjatë. “Po, më kujtohet, u njohëm para shumë vitesh në një lundrim me anije. Një kujtim i bukur”...

...

Ah, vajza në anije, seç iu drodh zemra. Vajza që kishte njohur fare rastësisht në fund të eksurzionit të apsoventurës. Pas Leningradit e Moskës, udhëtuan me tren për Kiev dhe atje hipën në një anije dy katëshe “Admiral Lushkov” dhe për një javë lunduran nëpër lumin Dnjepër për Odesë, në brigjet e Detit të Zi. Ato ishin ditët më të relaksuara, më të qeta, ishte çliruar pothuajse tërësisht nga impresionet e përziera për mbretërit dhe udhëheqësit e kuq, ishte çliruar nga dilemat morale të katandisë aristrokrate pasi kishte lexuar ditarin e Pushkinit, kishte dashur të shijojë pak këtë ujë të qetë të lumit dhe natyrës përreth, edhe pse edhe në këtë rrugëtim në brigjet vëreje zymtësinë e socializmit. Deshi t’i lë prapa persiatjet e tij që e kishin lodhur përplot dilema për carët dhe lojërat në oborr, për revolucionet dhe kundërevolucionet, për spastrimet dhe njeriun e dëshpëruar të socializmit, për flijesave për vendin, por dhe për komplotet dhe tradhtitë. Ah, tradhtitë...

Kishte dashur të ikë nga tradhtitë, por pikërisht në anije ai kishte njohur fytyrën e tradhtisë. Atë që

njeriu i bën njeriut, por dhe më shumë kur njeriu tradhëton vetëveten. Ajo vajzusha që tash ia përkujtoi kjo thirrje telefonike hyri në lojën e tradhtisë krejtësisht rastësisht. Nuk ishte ajo tradhti që përgatitet prej kohësh dhe pritet momenti, jo, ajo erdhi nga një shikim i beftë midis një studenti të dalldisur pas pyetjeve të shumta, më saktë, pas pseve që ai ato ditë i shtronte pa nda duke qenë në një vend "me shumë histori". Një shëtitje relaksuese nëpër valët e qeta të Dnjeprit, me ndalime nëpër qytete bregore, ishin një rrumbullakim i këtij eksurzioni studentor në një vend të paragjykuar, kurse pështjellimin e ri e shkaktoi njohja me Tanjën, Tatjana Kuzmenkon, një studente që gjatë pushimit veror punonte si recepcioniste në anije. Një fytyrë e bukur sikur ta kishte krijuar Da Vinçi, me një shikim përdëllues që e la pa fjalë ditën kur hipi në anije.

"Për këso femrash ngjajnë tradhtitë!", kujtoi me ta parë atë. Kujtoi Yllkën dhe dashurinë që ndjente për të, dhe gjëja më e marrë që mund t'i ndodhte dhe i ndodhi, ishte që Yllkën dhe Tanjën t'i vë në peshore të floririt! Cila më shumë vlente! Paramendoi situatën sikur në këtë anije t'i kishte njohur të dyja njëkohësisht, tek cila do të shkonte syri, për cilën do të ndjente atë shqetësim që ndjen bandilli kur njeh femrën e jetës së tij...Ky hamendësim e çoi Gentin buzë tradhtisë. Kur u ndalën në qytetin e parë, ai vetëvetiu kërkoi tregun

e luleve dhe bleu buqetën më të bukur dhe ia dërgoi recepcionistes.

"Lulet për lulen!..." e gjeti të befasuar. Mbeti të qëndrojë e habitur sikur për herë të parë dikush t'i dhurojë lule. Poligloti Gent nuk ishte i sigurt se ajo e kishte kuptuar ç'i kishte thënë.

"Lulet për mua?! Shumë faleminderit!"

"Gjëja e vogël që mund të bëjë dikush për një vashë si ti...Sepse, poetët lindin të magjepsur nga vashat si ti"- i tha "Ah, më fal, nuk ju prezantova. Jam Genti, student nga Jugosllavia...".

"Tatjana, shkurt Tanja".

Kishte një butësi dhe ëmbëlsi joshëse te kjo vajzë. Genti parandjente se ajo ka një shpirt të çiltër, ndryshe nga ato heroinat lajkatare të letërsisë. Ishte nga ato femra që njeriu flijon shumëçka për t'i pushtuar, nga ato që jepet betimi për besnikëri deri në varr, për ato femra që është mëkat t'i tradhëtosh. Për ato femra, që dhe mëkati i tradhtisë mund të falet.

"Ti nuk je si të tjerët!"

E befasoi ajo Gentin në momentin kur ai bluante në kokë mënyrën si të vazhdonte bisedën.

Asgjë, një mashtrim. Nuk është ajo si ato femra që njerëzit japin betimin për besnikëri të përjetshme. Unë nuk qenkam "si të tjerët". Sa meshkuj paska pasë ajo në jetën e saj, kur s'ka as 20 vjet të plota.

"Si qenkam kështu i ndryshëm...çfarë kam të veçantë...?"

"Nuk di ta definoj. Ka diçka që të dallon nga gjithë këta meshkuj në anije. Po t'i shikosh të gjithë me syrin e një femre, ti je ndër të rrallët që ke diçka të veçantë. Ke një shikim ëndërrues, që e kanë ata djem që dinë të dashurojnë pa hile. Çdo femër dëshiron përqafimin e një mashkulli me sy ëndërrues, romantik. Prandaj dhe ju besojnë femrat...Mos gabohem?".

"E ç'të them unë për ty...Nëse një i tillë siç më portretove të dhuron lulet, domethënë asgjë nuk është e rastit në këtë ndërsjellshmëri të çuditshme".

Ndërsjellshmëri! Dashuria për Yllkën kishte lindur disi ngadalë. Ishin parë aty-këtu, nuk ishin vërejtur. Pastaj i kishin rënë në sy njëri – tjetrit, por dashuria e vërtetë kishte ardhur më vonë. Kjo që po ndodhte në anije me Tanjën, ishte një tërheqje fatale që në shikimin e parë. Një njohje që mendonte se do të përshkohej me shumë pikëllim në ditën kur do të ndaheshin.

Jo, jo, në asnjë moment nuk bëhej fjalë për një instikt donzhuani të ngjallur beftas i cili egon e tij do ta plotësonte duke pushtuar një femër të bukur. Jo. Çështja ishte më serioze për te. Jo për shkak të tulatjes midis dy dashurive, por pse njëra do ta hante tjetrën.

....

"Nuk ju thashë se Tatjana Kuzmenko, që ju e kujtoni, përmes TV OKO-s ku punoj, ka shpallur kërkim për ju në emisionin "Të humburit". Ka humbur lidhjet me ju dhe ajo ruan kujtime të

bukura për ju, don të dijë nëse pas gjithë atyre luftërave në vendin tuaj të shpërbërë, keni mbetur gjallë!", ia ndërpreu kujtimet që e vërshuan për një çast zëri i korrespodentit që fliste në telefon.

....

Ah kujtimet e bukura?

Kujtoi çastin e njohjes dhe çastet kur me të dilte në kuvertë në mbrëmjet e freskëta. Kujtonte përqafimin e saj dhe puthjet e ëmbla që bënin të harronte Yllkën. Si do t'i dilte asaj përpara. Si do të fliste para saj. Si do të mund ta fshehë përjetimet me një vajzë të panjohur... Ah, kujtimi më i bukur nga çastet më të bukura...I ishte lëshuar afshit që ishte ngjallur, që e kishin nxjerrë nga lëkura e tij, e kishin bërë të verbër.

Një natë në dhomën e tij, kur ia lexoi vargjet që i kishin lindur fare spontanisht për të, ajo iu dorëzua krejtësisht. E kishin magjepsur vargjet e Gentit, të përshkuara me ndjenjën e Muzës që robëron zemrën e poetit. Jo, nuk ishte ishte vodka, as shampanja që i kishte dehur. Ata kishin magjepsur njëri tjetrin dhe pahetueshëm përkëdhelitë e tyre u bëne të pafrenueshme. Drita e qirinjve mezi zbulonte trupat lakuriqë që ishin bërë një, në mes tyre s'kishte asgjë që i ndante, ishin një trup dhe një shpirt.

Dhe, ai, dëgjoi zërin e mekur të saj, për çastin që ia vlen ta kujtosh për jetë, sepse nuk është fryt i një lajke, por i një dashjeje të sinqertë:

"Të lutem, jij i kujdeshëm, e kam herën e parë"!

Në atë delir, Gentit i erdhën fjalët nëpër mjegull, por domethënia e tyre bëri që koka t'i kthjellet shpejt. Kuptimi i fjalëve të saj do t'ia shtonin ndjenjë e mburrjes, dhe sa triumfues do të ishte ndjerë ndonjë donzhuan. "Edhe një virgjëreshë!". Por ai vazhdoi ta mbajë fort në përqafim Tanjën, duke ia puthur sytë dhe faqet, nuk donte të ndahej prej saj, por as nuk donte ta merrte këtë "trofe" nga një vashë të cilën kur të përfundojë ekskrzioni, do ta përqafonte për lamtumirë dhe s'do ta shihte më. Do ta linte të lënduar dhe bosh shpirtin e saj. Jo, ai nuk donte trofe. Nuk donte një tradhti. Sa të lënduar do të dilnin nga kjo gjendje.

"Të lutem vishu!", i tha Genti, duke u përpjekur ta largojë nga përqafimi, me një ftohtësi dëbuese. "Unë nuk të meritoj!".

"Nuk më do?!"

"Pikërisht pse të dua marrëzisht...!".

Në sytë e saj pa lotët. Dëgjoi dënesjen e një zëri të sapolënduar dhe e përqafoi sërish...

Ajo ishte heroina me të cilën ia vlente të jetoje amshimin.

...

Zëri i gazetarit vazhdonte t'i shpjegojë. Në vesh i arriti propozimi për t'i organizuar një fluturim gjer në Kiev dhe për të dalë në emision, për t'u takuar me të pas kaq vitesh.

"Dërgoni një buqetë lulesh në emër tim!"

FOTOGRAFIA E MUNGUAR

Shikoja njeriun që ia kisha lakmi për veprën e tij. Kishte larë një borxh të madh. Galeria gëllinte nga fotografitë e tij. Një fotografi peshonte më shumë se një mijëra fjalë bosh. Çdo autor do ta lëvdonte veprën e vet. Jo, do ta konsideronte me vlerë, ndoshta më me vlerë se çdo vepër e tjetërkujt. Por ai mendonte diçka tjetër në kokë. Ai jetonte me vite me fotografitë e tij që kishin konservuar ndonjë çast nga jeta, ndonjë moment nga historia, ndonjë gjest domethënës të njeriut në margjina. Ishte ky obsesioni i tij, më shumë se një angazhim profesional që kërkonte puna e tij në gazetë. Ai në çdo fotografi gjente disa jetë, i jetonte ato bashkë me personazhet e tij. Ai jetonte në momentin kur objektivi i kamerës së tij kapte çastin dhe pastaj jetonte saherë që e shikonte çdo foto të tij. Jeta në fotografitë e tij i përjetonte si të përjetshme. Aty jeta nuk vdiste. Aty vazhdonte të jetonte. Dhe ai jetonte me to. Me personazhet që i kishte takuar anekënd botës. Me dramat që ishin lojtur.

Ron H., fotoreporter i lirë, një biçim aventurieri, kërkues sfidash, gjendej para ekspozitës së fotografive që i kishte bërë në vatra krizash, në Bosnje, Darfur dhe Ruandë. Ishte dhe i pikëlluar. Në fotot e tij kishte shumë vdekje. Shumë gjak. Shumë vaje. Ishte dhe jeta e tij që kishte qenë pranë vdekjeve të të tjerëve. Dhe pranë vdekjes së tij,

saherë. Kishte qenë dhe në një liste vdekjeje që e kishin vënë "tigrat" e paramilitarit serb Arkan, pasi ai kishte botuar shumë foto nga viktimat që i kishin shkaktuar ata. Gjahu ndaj tij kishte përfunduar ditën kur komandantin e paramilitarëve e kishin vrarë në një qërim hesapesh midis mafiozëve në Beograd.

Prita kur të rrallohen vizitorët. "Jeni të kënaqur me ekspozitën, por sikur keni një pikëllim në shpirt!", i them. "Këto janë dëshmi që shkruajnë historinë pa fjalë! Ju përgëzoj për gjithçka! Sigurisht e kuptoni peshën e tyre", i thashë, duke iu prezentuar si gazetar nga Ballkani.

"Hë, Ballkani, një Perëndim i Egër i vonuar!", ma ktheu. "Një histori e rëndë, gjithkush kundër gjithkujt! Çuditem si atje ndonjëherë ndalen konfliktet. Një intermexo gjersa të shkaktohet i riu!".

"Ne ballkanasit themi që kemi më shumë histori seç mund ta mbajmë mbi supe!", i them, ndonëse e di që ai tashmë e ka dëgjuar këtë prej shumëkujt.

"Dhe shumë urrejtje. Se nga buron...", më plotëson.

"Dhe unë, atje u gjeta gatise djalosh. Më thanë po zien diçka në Ballkan, ik fotografo. Nëse ke fat, do të bëhesh i famshëm", rrëfen ai. "Erdha e u vendosa në Sarajevë kur me të madhe flitej se po zien diçka e madhe, diçka që do të marrë flakë.

Nuk pandehja se ç'është konflikti i vërtetë. Kurrë më parë s'kisha qenë aq afër".

Në një foto gjendej nëna që i rrinte te koka djalit të tij të sapo vrarë. "Shihe fytyrën e saj. Nuk është e tmeruar siç do të prisje, apo jo, është fare gjakftohtë. E din pse, sepse ajo nuk ishte vdekja e parë që kishte përjetuar. Tashmë ishte mësuar me vdekjen dhe asgjë s'e habiste! Një vdekje më pak ose më shumë, s'i bënte përshtypje. Është jo gjakftohtësi që të lemerit, sepse jonormaliteti është shndërruar në normalitet".

"Por ju me këto pamje i rrëfyet botës se ç'po ndodh dhe për këtë arsye aventura juaj mori dimension tjetër? Atë të ndërgjegjësimit për agresorët dhe për viktimat".

"Ka ende idealistë? Bota është e sehirxhinjve...Boto një mijë foto për një emocion çasti dhe aq. Konfliktet nuk kanë të ndalur asnjëherë". Dhe tregon absurdin që ka parë me sy.

"E dini ç'më ka tmerruar më së shumti. Fakti që në të shumtën e rasteve, xhelatët më linin të fotografoj vrasjet e tyre! Mund ta merrni me mend! Kështu donin të thonin se vrasjet e tyre ishin krejtësisht legjitime!".

Ka shumë gjak, lotë dhe çizme në fotografitë e tij. Sy të çakëritur para tytave. Ushtarë të harbuar para viktimave. I them se posaçërisht më intereson fati i një vendasi tim, të cilit për ironi, fati e kishte çuar në gurbet në Bosnje pikërisht pak muaj para konlfiktit. Kufoma e tij e gjetur në lumin Sava më 4

maj 1992, u identifikua vetëm me analizë të ADN-së. Fatkeqi është në një foto të Ron H.-kur paramilitarët serbe i hedhin ujë ta kthejnë në jetë pas maltretimeve. Quhej Hajrush Ziberi nga nga një fshat i rrethinës së Shkupit.

"Shumë nga viktimat që i kam fotografuar, ende i kam të gjallë në kujtesë. E kujtoj edhe Hajrushin. Për të ndjej keqardhje të veçantë, sepse sikur fatin e tij e pata në dorë dhe s'mund ta bëj asgjë. Ndonëse s'mundja të ndërmarr asgjë, ende ndjehem fajtor...".

Ofshan. Hajrushin e kishte takuar në Bjelinë të Bosnjës. S'kishte veç tre muaj që ishte martuar dhe punonte si kamarier kur e zunë dhe e çuan në drejtim të panjohur bashkë me dy shokë të tjerë me pretekst të shpifur të xhelatëve të tij. "E kam takuar në xhaminë e Bijelinës. Pasi që i vranë katër civilë, nga xhamia e nxorën Hajrushin dhe e dërguan drejt selisë së tyre. 'Tigrat e Arkanit' e përplasen për tokë dhe në atë moment unë e fotografova".

"Ajo foto që bëra në momentin kur kriminelët e kapën Hajrushin për ta çuar në vdekje. Ishte një pamje që s'më shqitet nga kujtesa. Janë duart e tij drejtuar nga unë, sikur donte të më thoshte, ja, po më marrin, më çojnë në vdekje, aman, më ndihmoni. Ai me shikim "Më ndihmoni!" e unë me aparat regjistroj fytyrën e njeriut të vetëdijshëm që shkon në vdekje. Lemeria dhe shpresa e humbur janë në atë fotografi që mungon në këtë ekspozitë".

"Dua të them se ndonjëherë vepra më e mirë e një shkrimtari është ajo që nuk është shkruar. Por unë e "shkrova", se isha bërë i zhdërvjelltë, nuk më ikte asgjë nga syri i fotoaparatit. E fotografova atë çast jetik të Hajrushit, ato duar të drejtuara kah unë duke më kërkuar ndihmën që s'mund t'ia ofroja, ato sy të frikësuar nga vdekja që e priste...tmerr. Por ajo mungon".

"Çka ndodhi me atë foto?"

"Çka do të ndodhte. Asgjë e veçantë. Në konflikte përherë është një palë që i pengon e vërteta. Pasi bëra foton, erdhi komandanti paramilitar Arkani, i cili ma kërkoi filmin me fotografitë e mia. Kisha arritur të fshihja disa, por jo dhe foton e Hajrushit. Pasi e morën filmin dhe vetë Hajrushin e çuan ku kishin për ta çuar. Më vonë shkova shkova në spital që të shoh në ishte aty. Nuk ishte. Fotografia edhe pamundësia ime që ta ndihmoja më brejnë edhe sot".

"Medoemos ndjeheni një profesionist i kënaqur dhe i plotësuar me dëshmitë tuaja?"

"Po çka se jam? Hë. Me fotot e para bëra ekzpozitë në Paris që t'i tregoj botës se ç'po ndodh që të ndërmarrë masa të pengojnë vrasjet dhe spastrimet etnike. Bota i la të dergjen dhe të vriten qindra mijë njerëz. Ky është mallkimi, ti flet të vërtetën për të penguar krimet, ndërkaq krimet nuk ndalen. Ndjehesh dhe bashkëfajtor. Zëri i ndërgjegjes nuk të lë".

Ron.H-në e kishin ftuar në disa gjykime të Tribunalit të Hagës që të dëshmojë për krime lufte. Ai kishte thënë se në konflikt kishte qenë vetëm regjistrues profesionist dhe nuk e sheh të udhës të paraqitet si dëshmitar.

Porse fondin e tij të fotografive Tribunali për Krime Lufte e shfrytëzoi si dëshmi materiale kundër shumë kriminelëve.

Në mesin e tyre mungonin shumë nga fotot që do të flisnin edhe më shumë për bishërimin njerëzor.

PËRMBAJTJA

TRENI PËR STAMBOLL
DHE TË KEQTË E NËNËS.....5
SY DRENUSHE.....17
DIKUSH TJETËR NË MES.....33
ERA E ASHPËR.....47
HOMO POLITICUS.....57
NEKROLOGU.....69
DASËM PA DHËNDËR.....73
GJYKIMI I PARTIZANES ROBËRESHË.....87
RRËFIMI PËR TREGIMIN.....111
FSHEHTËSIA E RAMUSHIT.....147
NATA NË ANIJE.....151
FOTOGRAFIA E MUNGUAR.....169